

1 E premte, 27 shkurt 2026

2 [Seancë e hapur]

3 [Deklaratat hyrëse]

4 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 10.02

6 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mirëmëngjes të gjithëve.

7 Përpara sesa të filloj, dëshiroj t'i jap fjalën -- t'i jap

8 mundësinë fotografëve që të bëjnë fotografi për një minutë.

9 Znj. Sekretare e seancës, ju lutem, paraqisni çështjen.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar

11 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2023-12, Prokurori i

12 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni

13 Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit.

14 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit, znj.

15 Sekretare.

16 Unë jam Christopher Gosnell, që jam Gjykatësi i Vetëm në

17 këtë çështje. Në këtë çështje unë do jem Gjykatës i Vetëm, në

18 pajtim me nenin 15(2) të Ligjit për Dhomat e Specializuara që

19 e lejon një gjë të tillë sa i takon krimeve që nuk

20 klasifikohen si krime të rënda në bazë të nenit 22 të Kodit

21 Penal të Kosovës. Në bazë të nenit 124(1) të Rregullores, e

22 deklaroj të hapur këtë proces gjyqësor dhe do ju kërkoja

23 palëve që të prezantohen vetë dhe ekipet përkatëse. Do filloj

24 pikësëpari me Prokurorinë.

25 Z. HAFETZ: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar Gjykatës.

1 Unë jam Josh Hafetz nga Zyra e Prokurorit të Specializuar,  
2 bashkë me mua është dhe Prokurorja e Specializuar Kimberly  
3 West, Matt Halling, Line Pedersen, Claire O'Connell, Brent  
4 Hicks dhe Earl Sullivan.

5 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit.

6 Tani sipas rendit të aktakuzës dëshiroj t'i jap fjalën  
7 Mbrojtjes së z. Thaçi.

8 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar Gjykatës.

9 Unë jam Sophie Menegon. Avokate e z. Thaçi. Së bashku me mua  
10 është Mischa Gureghian Hall dhe tre anëtarë të tjerë të ekipit  
11 të Mbrojtjes së z. Thaçi.

12 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit.

13 Z. Rees, fjala për ju.

14 Z. REES: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar Gjykatës. Unë  
15 jam Jonathan Elystan Rees. Unë jam përfaqësuesi i z. Smakaj.  
16 Z. Huw Bowden, është avokati tjetër. Dhe të pranishëm në sallë  
17 sot janë Steven Lack, Muharem Halilaj, Matilda Falchetta  
18 Hainsworth dhe një person tjetër.

19 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Edwards.

20 Z. EDWARDS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Në të majtën time  
21 është ekipi im. Z. Kilaj sot përfaqësohet dhe ndihmohet nga  
22 Admir Berisha, z. Soliman dhe Eva Kalb; bashkëmbrojtësi  
23 Alexandra Baer; unë jam Edwards edhe dy persona të tjerë të  
24 ekipit.

25 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit, z. Young,

1 fjala për ju.

2 Z. YOUNG: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar Gjykatës. Unë  
3 jam përfaqësuesi i z. Fazliu sot dhe ndihmohem nga znj.  
4 Yuqing, z. Beqiri dhe një anëtare tjetër e ekipit na ndjek  
5 përmes videolidhjes.

6 GJYKATËSI GOSNEL: [Përkthim] Faleminderit.

7 Z. Admiraal, fjala për ju.

8 Z. ADMIRAAL: [Mikrofoni çaktivizuar].

9 GJYKATËSI GOSNEL: [Përkthim] Znj. Administratore.

10 ADMINISTRATORJA: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar  
11 Gjykatës. Unë jam Fidelma Donlon, Administratore.

12 GJYKATËSI GOSNEL: [Përkthim] Akuzat për këtë çështje  
13 gjyqësore kanë filluar në vitin 2024, dhe ndërkohë me 29  
14 nëntor 2024, u lëshuan fletarrestet për z. Thaçi, Smakaj,  
15 Kilaj, Fazliu dhe Kuçi dhe një fletëthirrje për paraqitje për  
16 z. Kuçi.

17 Më datën 8 dhe 9 dhjetor 2024 u organizua seanca për  
18 paraqitjen e parë për të akuzuarit. Gjatë këtyre seancave të  
19 gjithë të akuzuarit u deklaruan jofajtorë për akuzat e  
20 ngritura kundër tyre.

21 Më 16 prill 2025, në vijim të vendimit Gjykatësi i  
22 Procedurës Paraprake autorizoi shtesën e formës së  
23 përgjegjësisë penale në lidhje me z. Thaçi vetëm, dhe  
24 Prokurori i Specializuar dorëzoi një aktakuzë të konfirmuar të  
25 ndryshuar, të cilën unë do ta përdor më poshtë në fjalën time

1 si "aktakuza".

2 Më 24 prill 2025, z. Thaçi u deklarua jofajtor për të  
3 gjitha aktakuzat e ngritura në aktakuzë.

4 Më 12 nëntor 2025, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e  
5 dorëzoi çështjen tek Gjykatësi i Vetëm.

6 Më 28 nëntor 2025, u organizua Konferenca për Përgatitjen  
7 e Procesit gjyqësor dhe Konferenca Përgatitore për Prokurorin  
8 e Specializuar në pajtim me rregullin 117 [Sipas  
9 përkthimit]dhe 118.

10 Më 4 dhjetor 2025 unë planifikova fillimin e gjyqimit për  
11 datën 24 shkurt 2026, të cilën më pas e shtyva me kërkesën e  
12 Mbrojtjes së z. Thaçi për sot, me datë 27 shkurt 2026.

13 Gjithashtu, dëshiroj të them për procesverbal që kam  
14 urdhëruar lirimin e përkohshëm të z. Kilaj me 3 dhjetor 2025,  
15 dhe lirimin e përkohshëm të z. Smakaj dhe z. Fazliu me 3  
16 shkurt 2026.

17 Në bazë të rregullës 124, 125, Prokurori i Specializuar  
18 do të ftohet sot që të lexojë një përmbledhje të aktakuzës.  
19 Vërej gjithashtu që ta akuzuarit kanë dhënë pëlqimin e tyre që  
20 të jepet një lexim i përmbledhjes së aktakuzës dhe jo aktakuza  
21 e plotë.

22 Më pas unë do pyes të akuzuarit në qoftë se e kuptojnë  
23 aktakuzën e ngritur ndaj tyre dhe do i kërkoj atyre të  
24 konfirmojnë atë çfarë kanë deklaruar fillimisht, pra, që ata  
25 nuk janë fajtorë për pikat e ngritura në aktakuzë.

1 Më pas në bazë të rregullës 126, do të ftoj Prokurorin që  
2 të paraqesë deklaratat hapëse dhe gjithashtu do i kërkoj  
3 ekipeve të Mbrojtjes të paraqesin deklaratat e tyre hapëse në  
4 qoftë se kanë.

5 Për shkak se filluam pak më vonë sot, ne do të vazhdojmë  
6 deri në 11.30, pastaj do bëjmë pushimin, dhe ndërkohë pushimin  
7 e drekës do e bëjmë si zakonisht në orën 1.00. Do shohim në  
8 qoftë se mund ta kapim kohën e humbur këtë gjysmë ore që  
9 filluam me vonesë gjatë ditës.

10 Prokuror, fjalën e keni ju që të lexoni një përmbledhje  
11 të aktakuzës. Do ju kërkoja që të flisnit ngadalë në mënyrë që  
12 t'ju ndjekin përkthyesit.

13 Z. HAFETZ: [Përkthim] Faleminderit, do t'i jap fjalën z.  
14 Hicks, kolegut tim, që do të lexojë përmbledhjen e aktakuzave.

15 Z. HICKS: [Përkthim] Atëherë i kuptuam komentet tuaj. Do  
16 mundohemi që të lexojmë dhe të flasim sa më ngadalë në mënyrë  
17 të tillë që të na ndjekin plotësisht përkthyesit.

18 Atëherë, neve -- dua të them që kur unë them Kodi i  
19 Procedurës Penale, e kam fjalën për Kodin e Procedurës Penale  
20 të Republikës së Kosovës, e kam fjalën pikërisht për Ligjin  
21 06/L-074 të vitit 2019. Dhe kur flas për Ligjin, e kam fjalën  
22 për Ligjin për Krijimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës  
23 dhe Zyrës së Specializuar të Prokurorit.

24 Hashim Thaçi mban përgjegjësi penale individuale për:

25 Pika 1: Tentativë për pengim të personave zyrtarë në

1 kryerjen e detyrave zyrtare me anë të pjesëmarrjes në veprimin  
2 e përbashkët të një grupi midis së paku 26 qershorit dhe 18  
3 korrikut 2023, vepër penale kundër rendit publik, e  
4 ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 21, 32(1), 35 dhe 401(2)  
5 dhe (3) dhe (5) të KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit;

6 Pika 2: Tentativë për pengim të personave zyrtarë në  
7 kryerjen edhe detyrave zyrtare me anë të pjesëmarrjes në  
8 veprimin e përbashkët të një grupi midis së paku 9 shtatorit  
9 dhe 30 tetorit 2023, vepër penale kundër rendit publik, e  
10 ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 21, 32(1) dhe (3), 35, dhe  
11 401(2) dhe (3) dhe (5), dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit;

12 Pika 3: Tentativë për pengim të personave zyrtarë në  
13 kryerjen e detyrave zyrtare me anë të pjesëmarrjes në veprimin  
14 e përbashkët të një grupi midis së paku 6 tetorit dhe 2  
15 nëntorit 2023, vepër penale kundër rendit publik, e  
16 ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 21, 32(1) dhe (3), 35, dhe  
17 401(2), (3) dhe (5) të KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të  
18 Ligjit;

19 Pika 4: Shkelje e fshehtësisë së procedurës përmes  
20 zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë midis së  
21 paku 26 qershorit dhe 18 korrikut 2023, vepër penale kundër  
22 administrimit të drejtësisë dhe administratës publike, e  
23 ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 21 dhe 392(1) të KPK-së,  
24 dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit;

25 Pika 5: Shkelje e fshehtësisë së procedurës përmes

1 zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë midis së  
2 paku 9 shtatorit dhe 30 tetorit 2023, vepër penale kundër  
3 administrimit të drejtësisë dhe administratës publike, e  
4 ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 21 dhe 392(1) të KPK-së,  
5 dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit;

6 Pika 6: Shkelje e fshehtësisë së procedurës përmes  
7 zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë midis së  
8 paku 6 tetorit dhe 2 nëntorit 2023, vepër penale kundër  
9 administrimit të drejtësisë dhe administratës publike, e  
10 ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 21 dhe 392(1) të KPK-së,  
11 dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit;

12 Pika 7: Shkelje e fshehtësisë së procedurës përmes  
13 zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe të dhënave  
14 personale të një dëshmitari të mbrojtur midis së paku 6  
15 tetorit dhe 2 nëntorit 2023, vepër penale kundër administrimit  
16 të drejtësisë dhe administratës publike, e ndëshkueshme në  
17 bazë të neneve 17, 21 dhe 392(2) të KPK-së, dhe neneve 15(2)  
18 dhe 16(3) të Ligjit;

19 Pika 8: Mosbindje ndaj Gjykatës midis së paku 26  
20 qershorit dhe 18 korrikut 2023, vepër penale kundër  
21 administrimit të drejtësisë dhe administratës publike, e  
22 ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 21 dhe 393 të KPK-së, dhe  
23 neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit;

24 Pika 9: Mosbindje ndaj Gjykatës midis së paku 1 dhe 13  
25 shtatorit 2023, vepër penale kundër administrimit të

1 drejtësisë dhe administratës publike, e ndëshkueshme në bazë  
2 të neneve 21, 35 dhe 393 të KPK-së, dhe neneve 15(2) dhe 16(3)  
3 të Ligjit;

4 Pika 10: Mosbindje ndaj Gjykatës midis së paku 9  
5 shtatorit dhe 30 tetorit 2023, vepër penale kundër  
6 administrimit të drejtësisë dhe administratës publike, e  
7 ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 21 dhe 393 të KPK-së, dhe  
8 neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit;

9 Pika 11: Mosbindje ndaj Gjykatës midis së paku 6 tetorit  
10 dhe 2 nëntorit 2023, vepër penale kundër administrimit të  
11 drejtësisë dhe administratës publike, e ndëshkueshme në bazë  
12 të neneve 17, 21 dhe 393 të KPK-së, dhe neneve 15(2) dhe 16(3)  
13 të Ligjit;

14 Bashkim Smakaj, mban përgjegjësi penale individuale për:

15 Pika 12: Tentativë për pengim të personave zyrtarë në  
16 kryerjen e detyrave zyrtare me anë të pjesëmarrjes në veprimin  
17 e përbashkët të një grupi midis së paku 9 shtatorit dhe 30  
18 tetorit 2023, vepër penale kundër rendit publik, e  
19 ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 21, 33, 35 dhe 401(2) dhe  
20 (5) dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit;

21 Pika 13: Mosbindje ndaj Gjykatës midis së paku 9  
22 shtatorit dhe 30 tetorit 2023, vepër penale kundër  
23 administrimit të drejtësisë dhe administratës publike, e  
24 ndëshkueshme në bazë të neneve 21, 33 dhe 393 të KPK-së, dhe  
25 neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.

1 Isni Kilaj, mban përgjegjësi penale individuale për:

2 Pika 14: Tentativë për pengim të personave zyrtarë në  
3 kryerjen e detyrave zyrtare me anë të pjesëmarrjes në veprimin  
4 e përbashkët të një grupi midis së paku 6 tetorit dhe 2  
5 nëntorit 2023, vepër penale kundër rendit publik, e  
6 ndëshkueshme sipas neneve 17, 21, 33, 35 dhe 401(2) dhe (5) të  
7 KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit;

8 Pika 15: Mosbindje ndaj Gjykatës midis së paku 6 tetorit  
9 dhe 2 nëntorit 2023, vepër penale kundër administrimit të  
10 drejtësisë dhe administratës publike, e ndëshkueshme në bazë  
11 të neneve 21, 33 dhe 393 të KPK-së, dhe neneve 15(2) dhe 16(3)  
12 të Ligjit.

13 Fadil Fazliu mban përgjegjësi penale individuale për:

14 Pika 16: Tentativë për pengim të personave zyrtarë në  
15 kryerjen e detyrave zyrtare me anë të pjesëmarrjes në veprimin  
16 e përbashkët të një grupi midis së paku 6 tetorit dhe 2  
17 nëntorit 2023, vepër penale kundër rendit publik, e  
18 ndëshkueshme sipas neneve 17, 21, 33, 35 dhe 401(2) dhe (5) të  
19 KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit;

20 Pika 17: Mosbindje ndaj Gjykatës midis së paku 26  
21 qershorit dhe 18 korrikut 2023, vepër penale kundër  
22 administrimit të drejtësisë dhe administratës publike, e  
23 ndëshkueshme në bazë të neneve 21, 33 dhe 393 të KPK-së, dhe  
24 neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.

25 Hajredin Kuçi mban përgjegjësi penale individuale për:

1 Pika 18: Mosbindje ndaj Gjykatës midis së paku 1 dhe 13  
2 shtatorit 2023, vepër penale kundër administrimit të  
3 drejtësisë dhe administratës publike, e ndëshkueshme në bazë  
4 të neneve 21, 35 [Sipas përkthimit] dhe 393 të KPK-së, dhe  
5 neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.

6 Pika 19: Mosbindje ndaj Gjykatës midis së paku 26  
7 qershorit dhe 18 korrikut 2023, vepër penale kundër  
8 administrimit të drejtësisë dhe administratës publike, e  
9 ndëshkueshme në bazë të neneve 21, 33 dhe 393 të KPK-së, dhe  
10 neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.

11 Ky është fundi i përmbledhjes së pikave të aktakuzës, i  
12 nderuar Gjykatës.

13 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Për procesverbal të gjithë  
14 të akuzuarit janë të pranishëm në sallën e gjyqit. Tani  
15 dëshiroj t'i jap fjalën secilit prej të akuzuarve, që në  
16 pajtim me rregullën 124(3), të thonë që në qoftë se e kuptojnë  
17 aktakuzën e ngritur kundër tyre dhe të konfirmojnë faktin që  
18 nuk janë fajtorë.

19 Z. Thaçi, ju lutem qëndroni në këmbë. z. Thaçi, a e  
20 kuptoni aktakuzën e ngritur kundër jush?

21 I AKUZUARI THAÇI: [Mikrofoni çaktivizuar]. Po.

22 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit, z. Thaçi.

23 Më 6 janar, ju thatë që nuk jeni fajtor për asnjë nga  
24 pikat e aktakuzës, dhe me 24 prill 2025, po ashtu thatë që nuk  
25 jeni fajtor për asnjë prej akuzave në aktakuzën e konfirmuar

1 të rishikuar. A e konfirmoni pafajësinë tuaj z. Thaçi?

2 I AKUZUARI THAÇI: Plotësisht i pafajshëm.

3 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit, z. Thaçi.

4 Mund të uleni.

5 Z. Smakaj, a mund të ngriheni, ju lutem. Z. Smakaj, a e  
6 kuptoni aktakuzën e ngritur kundër jush?

7 I AKUZUARI SMAKAJ: Po. Po, i nderuar z. Gjykatës.

8 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Më 6 janar ju u deklaruat  
9 jofajtor për të gjitha pikat e aktakuzës. A e konfirmoni këtë  
10 qëndrim tuaj për të gjitha aktakuzat e ngritura nga ju?

11 I AKUZUARI SMAKAJ: Po, e konfirmoj plotësisht, i  
12 pafajshëm në të dy pikat e aktakuzës.

13 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit, z. Smakaj.

14 Z. Kilaj, ju lutem, ngrihuni në këmbë. Z. Kilaj, a e  
15 kuptoni aktakuzën e ngritur ndaj jush?

16 I AKUZUARI KILAJ: Po.

17 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Gjatë Seancës Paraprake me  
18 9 dhjetor 2024, ju thatë që nuk jeni fajtor për asnjë nga  
19 pikat në aktakuzë. A e konfirmoni këtë deklaram jofajtor, z.  
20 Kilaj?

21 I AKUZUARI KILAJ: Po, e konfirmoj se nuk jam fajtor.

22 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit, z. Kilaj.

23 Z. Fazliu, ju lutem, ngrihuni në këmbë.

24 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Fazliu, a e kuptoni  
25 aktakuzën e ngritur kundër jush?

1 I AKUZUARI FAZLIU: Po, e kuptoj.

2 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Gjatë Seancës së Paraqitjes  
3 Fillestare më 8 dhjetor 2024, ju thatë që nuk jeni fajtor për  
4 asnjë prej pikave të aktakuzës. A e konfirmoni këtë gjë edhe  
5 sot për akuzat ndaj jush, z. Fazliu?

6 I AKUZUARI FAZLIU: E konfirmoj plotësisht, dhe  
7 krejtësisht i pafajshëm.

8 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit, z. Fazliu,  
9 mund të uleni.

10 Z. Kuçi, ju lutem, ngrihuni në këmbë. Z. Kuçi, a e  
11 kuptoni aktakuzën e ngritur ndaj jush?

12 I AKUZUARI KUÇI: Po, e kuptoj.

13 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Gjatë Seancës së Paraqitjes  
14 Paraprake më 9 dhjetor 2024, ju thatë që nuk jeni fajtor për  
15 asnjë prej pikave të aktakuzës. A e konfirmoni atë çfarë keni  
16 thënë në dhjetor, a e konfirmoni që nuk jeni fajtor për të  
17 gjitha pikat e ngritura ndaj jush?

18 I AKUZUARI KUÇI: Njëjtë e konfirmoj dhe sot që jam i  
19 pafajshëm.

20 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Shumë mirë, mund të uleni.

21 Z. Thaçi, Smakaj, Kilaj, Fazliu dhe Kuçi tani do t'ju  
22 informoj për disa të drejta tuaja të rëndësishme që keni  
23 përpara kësaj Gjykate në kuadër të bazës ligjore mbi të cilën  
24 funksionon Gjykata.

25 Ju keni të drejtën që të mos flisni dhe një heshtje e

1 tillë nuk do merret parasysh për sa i takon përcaktimit të  
2 fajësisë apo pafajësisë.

3 Ju keni të drejtën që të mos detyroheni që të pranoni  
4 fajësinë ose të jepni dëshmi.

5 Keni të drejtën që të mos inkriminoni veten apo të mos  
6 inkriminoni anëtarë të afërt të familjes.

7 Keni të drejtën që të përfaqësoheni nga një avokat.

8 Keni të drejtën që të keni kohë të mjaftueshme dhe  
9 ambiente të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes tuaj dhe  
10 të komunikoni me avokatët mbrojtës.

11 Keni të drejtën që të gjykoheni brenda një kohe të  
12 arsyeshme.

13 Keni të drejtën që të merrni në pyetje dëshmitarët kundër  
14 jush dhe të thërrisni dëshmitarë për mbrojtjen e çështjes  
15 tuaj.

16 Keni të drejtën gjithashtu që të bëni një deklaratë jo  
17 nën betim në pajtim me çështjen.

18 Po ashtu rregullat më bëjnë të nevojshëm që t'ju informoj  
19 ju për detyrimet dhe masat të cilat merren në pajtim me  
20 rregullën 161(2).

21 Si Gjykatës i Vetëm në këtë çështje unë jam përgjegjës  
22 për rendin në sallën e gjyqit dhe në galerinë publike, si dhe  
23 jam përgjegjës për sjelljen e të gjithë pjesëmarrësve.

24 Megjithëse jam i sigurt që kjo nuk do jetë e nevojshme,  
25 mund të më duhet që të urdhëroj heqjen e përkohshme të të

1 akuzuarit, të një të akuzuari në sallën e gjyqit dhe të  
2 vazhdoj me procesin gjyqësor në mungesën tuaj në qoftë se  
3 sjellja e atë akuzuarve është e tillë që e pengon punën në  
4 gjykatë. Në qoftë se do të largoheni nga salla nga gjyqit,  
5 interesat tuaja do të përfaqësohen nga avokatët përkatës, dhe  
6 do të bëhen organizimet e nevojshme në mënyrë të tillë që ju  
7 të mund të ndiqni punimet e Gjykatës.

8 Për të gjithë ata që janë këtu në sallë dhe që na ndjekin  
9 nga galeria, unë mund të marr masa të nevojshme për të  
10 siguruar dinjitetin dhe respektin e procesit gjyqësor ose për  
11 arsye sigurie për mbrojtjen e të drejtave të të akuzuarve për  
12 proces të drejtë dhe seancë publike, përfshirë këtu edhe  
13 urdhërimin e largimit ose kontrollit ndaj një personi.

14 Përpara sesa të fillojmë me deklaratat hapëse dëshiroj të  
15 them disa rregulla të përgjithshme.

16 Seancat në përgjithësi do të mbahen të hapura në  
17 kundërshtim -- ose me përjashtim të rasteve kur palët kërkojnë  
18 seanca të ndryshme. Do i kërkoja palëve që në qoftë se ka  
19 nevojë për seanca të mbyllura ose prive, ta kërkojnë një gjë  
20 të tillë. Unë e di që në këtë çështje mund të përfshihet  
21 informacion që është shumë i ndjeshëm, kështu që do i kërkoja  
22 palëve që të ushtrojnë kujdes të veçantë lidhur me moszbulimin  
23 e emrave të personave të dëshmitarëve të mbrojtur ose  
24 informacion konfidencial ose gjatë seancave këtu ose jashtë  
25 sallës së gjyqit.

1 Dëshiroj që të flas edhe për procedurën e redaktimeve  
2 brenda Gjykatës, të përcaktuar në paragrafin 10 të Vendimit  
3 për Zhvillimin e Procesit dhe dua që t'ju kujtoj të gjithëve  
4 që provat dhe materiali audioviziv që do të tregohet në gjyq,  
5 në sallën e gjyqit, përfshirë dhe çdo informacion i tillë i  
6 cili do përdoret gjatë seancave, gjatë deklaratave hapëse nuk  
7 do të paraqitet për publikun përveçse nëse urdhërohet prej  
8 meje.

9 Sipas rregullës 118(5) mua më kërkohet që të përcaktoj  
10 një datë për përfundimin e argumenteve të Prokurorisë së  
11 Specializuar. Duke marrë parasysh vlerësimet e palëve për  
12 pyetjet dhe kundërpjetet e dëshmitarëve të ZPS-së, të gjithë  
13 dëshmitarët e ZPS-së duhet që të përfundojnë deri të premten  
14 me datë 6 mars 2026. Përderisa mund të ketë mocione sa i takon  
15 pranimin të provave si dhe një mocion lidhur me Dëshmitarin 8,  
16 ato do të duhet që të trajtohen pas dëshmisë së tij, kështu që  
17 unë e caktoj si datën mbyllëse të argumenteve të ZPS-së të  
18 premten, datë 13 mars 2026. Dëshiroj t'ju them që kjo është  
19 një datë e synuar, ndërkohë që data përfundimtare për mbylljen  
20 e argumenteve të ZPS-së do përcaktohet pasi të dëgjohen  
21 parashtrimet e palëve.

22 Vërej që deklaratat hapëse nuk janë prova, janë  
23 parashtrime të fakteve që një palë përpigjet që të provojë. Unë  
24 nuk pres ndonjë kundërshtim sa i takon deklaratave hapëse të  
25 bëra prej të gjitha palëve. Në rast përjashtimor në qoftë se

1 ndonjë palë dëshiron që të bëjë një kundërshtim gjatë  
2 deklaratave hapëse, do kërkoja që diçka e tillë të bëhet në  
3 fund të deklaratës hapëse përkatëse.

4 Z. Prokuror, e keni ju fjalën. Keni një orë e gjysmë në  
5 dispozicion.

6 Shoh që z. Thaçi ka ngritur dorën dhe kërkon që të marrë  
7 fjalën.

8 Avokatja ka ndonjë ide se për çfarë bëhet fjalë?

9 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Jo, nuk jam në dijeni. A mund të  
10 konsultohem me të?

11 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Po, konsultohuni.

12 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

13 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar  
14 Gjykatës. mund të vazhdoni.

15 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Prokuror.

16 Z. HAFETZ: [Përkthim] Dy çështje logjistike. Njëra të  
17 cilën e ngritët ju dhe tjetra për sa i përket afateve kohore.

18 Të gjitha diapozitivët tonë do të duhet të transmetohen  
19 publikisht duke patur parasysh që i gjithë gjykimi është  
20 publik. Ato janë redaktuar nëse ka patur nevojë, kështu që nuk  
21 ka nevojë që ta mbahen në seancë private.

22 Dhe sa i përket kohës, afatit -- edhe një gjë tjetër, nuk  
23 ka nevojë që të përkthehet materiali audioviziv pasi e ka  
24 përkthimin aty, ose në provën materiale ose në ekran.

25 Ne kërkojmë pak më shumë se 90 minuta, ju lutem, gati dy

1 orë, dhe e kemi ndarë për arsye planifikimi në katër pjesë. Do  
2 t'ia kaloj fjalën Prokurores të Përgjithshme, të Specializuar  
3 për të bërë fjalën hyrëse, pastaj z. Hicks, O'Connell dhe unë  
4 do ta marrim fjalën me radhë.

5 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Dakord. Atëherë unë do të  
6 kërkoj që materialet audiovizuale të transmetohen të gjitha  
7 publikisht.

8 Z. HAFETZ: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

9 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Po i kërkoj Prokurorisë që  
10 keni deri në orën 11.30, në moment në të cilin do të marrim  
11 edhe pushimin e mëngjesit.

12 Z. HAFETZ: [Përkthim] Ju falënderoj, i nderuar Gjykatës,  
13 ju kuptoj.

14 ZNJ. WEST: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar Gjykatës,  
15 znj. Administratore, të gjithë të pranishëm në këtë sallë  
16 gjyqi.

17 I nderuar Gjykatës, jam e lumtur që kam mundësinë që të  
18 flas këtu.

19 Paraqitemi sot për folur sot lidhur me përpjekjet e  
20 Hashim Thaçit dhe të akuzuarve të tjerë për të minuar dhe  
21 manipuluar kuadrin e kësaj Gjykate. Ata në mënyrë të  
22 drejtpërdrejtë kanë dhunuar vendimet gjyqësore të cilat kanë  
23 pasur si synim që të bëjnë të mundur që dëshmitarët dhe  
24 viktimat të mund të japin dëshmi pa patur frikë dhe influencë,  
25 dhe që të kenë besimin që identiteti i tyre nuk do të -- do të

1 ishte konfidenciale.

2 Hashim Thaçi është i akuzuar se në mënyrë sistematike dhe  
3 të vazhduar ka vazhduar që të ndërhyjë më këtë dëshmi të  
4 dëshmitarëve dhe ka dhunuar të gjitha urdhrat e gjykatës të  
5 cilat kanë synuar mbrojtjen e informacionit konfidencial. Të  
6 bashkakuarit kanë marrë pjesë në mënyrë të paligjshme në  
7 këto krime.

8 Sjellja e akuzuarve është në thelb të shtetit të së  
9 drejtë dhe kësaj Gjykate e cila ekziston brenda sistemit  
10 gjyqësor të Kosovës me qëllim që procedurat të jenë të  
11 pavarura dhe të drejta dhe të sigurta. Prandaj ndodhemi këtu  
12 sot.

13 Nëse të akuzuarit kanë pasur sukses në përpjekjet e tyre  
14 për të ndikuar mbi dëshmitarët nuk ka rëndësi. Arsyeja se  
15 përse i kemi burime kësaj çështje është që të mbrojmë  
16 integritetin e procedimit në Çështjen 06, për të bërë të  
17 mundur që bota publiku i Kosovës ta kuptojmë se çdokush që  
18 përpiqet për të ndërhyrë dhe për të mos lejuar dëshminë e  
19 vërtetë të çdo dëshmitari që vjen përkrah këtij Trupi Gjykses  
20 do të japë llogari. Mbrojtja e shtetit të drejtës do të thotë  
21 që askush nuk është mbi këtë ligj. Ligji zbatohet në mënyrë të  
22 barabartë për të tërë.

23 Në e dimë që populli i Kosovës e merr seriozisht këtë  
24 aktakuzë dhe këto akuza për shkak se krijimi i kësaj Gjykate  
25 nuk kishte të bënte thjesht me krimet e luftës dhe krimet

1 kundër njerëzimit, por përfshinte në mënyrë specifike dhe  
2 krimet e parashikuara në këtë çështje gjyqësore: pengimi i një  
3 personi zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, dhunimi i  
4 sekretit të procesit dhe mosbindja ndaj gjykatës.

5 Në e dimë që populli i Kosovës dëshiron që të zbatohet  
6 shteti i së drejtës në gjykatat e veta, dhe këtë e pranojnë si  
7 diçka thelbësore. Dhe duke pasur parasysh se një grup i vogël  
8 por fuqishëm njerëzish në Kosovë vendosin interesat e tyre mbi  
9 ato të të tjerëve, do të paraqitet çështje në këtë -- fakte në  
10 këtë çështje të cilat do ta ekspozojnë dhe dënojnë këtë grup  
11 të vogël.

12 Siç e di Trupi Gjyqësor kjo çështje ka të bëjë me audio-  
13 incizime dhe dokumente të konfiskuara. Do dëgjoni të akuzuar  
14 duke folur me njëri-tjetrin dhe dokumentet që kanë shkëmbyer,  
15 dhe pjesë të rëndësishme e kësaj çështje e gjykatës -- të  
16 gjykime do të ishte dhe përcaktimi se çfarë kanë pasur  
17 parasysh me fjalët e tyre

18 Përpara se të flas më tej më këtë, do të theksoj  
19 fillimisht se për çfarë nuk bëhet fjalë. Kjo çështje nuk ka të  
20 bëjë më e mbrojtjen legjitime të Hashim Thaçit në gjyqin mbi  
21 krimet e luftës. Hashim Thaçi ka një ekip të madh mbrojtje në  
22 atë gjykim dhe ka patur qasje të papërcaktuar, të  
23 pakontrolluar me anëtarët e ekipit të tij përmes takimeve.  
24 Asnjë prej këtyre takimeve nuk janë regjistruar. Askush përveç  
25 Thaçit dhe Mbrojtjes së tij nuk e dinë se çfarë është në ato.

1 Të njëjtat takime dhe thirrje të cilat janë incizuar pas  
2 autorizimit gjyqësor janë ato të cilat janë të  
3 paprivilegjuara, dhe Thaçi e ka ditur paraprakisht se ato ato  
4 nuk duhet të shfrytëzoheshin për takime të paligjshme lidhur  
5 me dëshmitarët. Fakti që nuk janë incizuar thirrjet e  
6 privilegjuara reflekton rëndësinë që ne i kushtojmë këtu në  
7 DHSK dhe në ZPS përfaqësimit ligjor të të akuzuarit.

8 Ky proces penal nuk ka të bëjë me kontrollin e fjalëve,  
9 as me të drejtat e të akuzuarit për të folur lirisht. Në këtë  
10 rast nuk është për të drejtën e Thaçit për të kundërshtuar  
11 akuzat në Çështjen 06, apo për të luajtur rol aktiv në  
12 mbrojtjen e tij. Asnjë prej këtyre nuk përbën krim. Thaçi ka  
13 patur dhe vazhdon që t'i gëzojë të gjitha këto drejta të  
14 rëndësishme.

15 Ajo që është kriminale, sidoqoftë, është plani, udhëzimet  
16 dhe kontrolli i një plani të gjerësishëm nga ana e Thaçit për  
17 të ndikuar mbi dëshmitarët dhe për të ndërhyrë në  
18 administrimin e drejtë dhe të barabartë të drejtësisë.  
19 Kriminale është gjithashtu nxjerrja e informatave të  
20 dëshmitarëve të mbrojtur duke shkelur në mënyrë -- duke  
21 shkelur urdhrat e qarta të Gjykatës, urdhra të Gjykatës të  
22 cilat janë nxjerrë pikërisht për të për të bërë të mundur që  
23 dëshmitarët të ndihen të sigurt kur të vijnë për të dhënë  
24 dëshmi përpara këtij Trupi Gjykses.

25 Dhe pavarësisht se udhëzimet e incizuara të Thaçit ishin

1 -- kishin të bënin me minimin e dëshmime në Çështje 06 me  
2 qëllim që ato të ishin shfajësuese në përfitim të Thaçit, kjo  
3 çështje gjyqësore këtu nuk ka të bëjë me përgjegjësinë e tij  
4 penale në Çështjen 06. Është thjeshtë për të përcaktuar nëse  
5 udhëzimet e Thaçit për të ndikuar mbi dëshmitarët dhe nxjerrja  
6 e informacioneve konfidenciale të materialeve të Çështjes 06  
7 janë vepra penale në vetvete.

8 Thaçi ka pasur një audiencë të mirë në kuadrin e të  
9 bashkëakuzuarve. Incizimet do të tregojnë influencën e Hashim  
10 Thaçit mbi të bashkëakuzuarit e tij dhe gatishmërinë e tyre  
11 për të marrë pjesë në atë plan

12 Në rastin e Fadil Fazliut, Fazliu dha sugjerimet hetimi  
13 se çfarë duhet të thonin dëshmitarët dhe shfrytëzoi edhe  
14 djalin e tij për të ndihmuar për të arritur këtë qëllim.

15 Në rastin e të akuzuarit Isni Kilaj, Kilaj mori nga Thaçi  
16 dhe nga qendra e paraburgimit dhe kopje të deklaratave  
17 paraprake konfidenciale të dëshmitarëve me qëllim që të  
18 ndërhynte me dëshminë e tyre. Këto dokumente, siç do të  
19 dëgjoni më vonë, janë konfiskuar nga shtëpia nga shtëpia e  
20 Kilajt.

21 Në rastin e të akuzuarit Bashkim Smakaj, Smakaj u bashkua  
22 me përpjekjet e Thaçit për të përbuzur disa dëshmitarë dhe  
23 mori një dokumente të printuar dhjetë-faqesh i cili tregonte  
24 përgjegjësinë penale të Thaçit në Çështjen 06, dhe e cila  
25 ishte në përputhje me udhëzimet që kishte dhënë Thaçi për këtë

1 dëshmitar. Ky dokument, siç do të dëgjoni më vonë, është  
2 konfiskuar nga makina e Smakajt.

3 Në rastin e të akuzuarit Hajredin Kuçi, Kuçi ka dhënë në  
4 mënyrë të vazhdueshme sugjerimet e tij se çfarë duhet të  
5 thonin dëshmitarët e shënjestruar me qëllim që të ishte në  
6 përfitim të Thaçit. Në fakt, Kuçi ishte pozitën për t'i bërë  
7 këto sugjerime pasi në atë kohë ai ishte një nga personat që  
8 bashkëpërfaqësonte -- që përfaqësonte të bashkakuquarin e tij  
9 Kadri Veseli në Çështjen 06.

10 Incizimet e kësaj çështjeje nuk janë thjesht -- nuk  
11 përbëjnë thjesht pajtim mes të bashkëakuzuara për të kryer  
12 krime, por tregojnë edhe besnikërinë ndaj drejtuesit Hashim  
13 Thaçi, dhe një angazhim për të zbatuar dëshirat e tij. Të  
14 gjithë të akuzuarit kanë patur një synim të vetëm: pengimin e  
15 procedurës penale në përfitim të Hashim Thaçit.

16 Këto sjellje janë rrezik aktual ndaj shtetit të së  
17 drejtës, i cili kërkon që dëshmitarët të dalim para Trupit  
18 Gjykues për të treguar se ç'kanë përjetuar pa patur frikë,  
19 influencë apo ndërhyrje të çfarëdollojshme. Është e  
20 rëndësishme për të ardhmen e këtij institucioni që këto fakte  
21 të dëgjohen dhe të gjykohen në mënyrë publike me qëllim që t[  
22 krijohet dje një procesverbal i besueshëm dhe i vërtetë. Është  
23 e rëndësishme që ne të nderojmë angazhimin tonë ndaj publikut  
24 të Kosovës dhe botës për të bërë të mundur që të arrijmë në  
25 zbatimin e parimit që askush nuk është mbi ligjin.

1 Të nderuar Gjykatës, do të dëgjoni nga kolegët e mi  
2 çështje më të hollësishme lidhur me këtë çështje. Z. Hafetz do  
3 të japë një përmbledhje të dokumenteve dhe të dëshmisë  
4 dokumentare lidhur me këtë. Pastaj z. Hicks dhe znj. O'Connel  
5 do të flasin lidhur me ligjin e zbatueshëm dhe elementët që e  
6 përbëjnë atë

7 Faleminderit.

8 HAFETZ: "Thuaji atij, 'Thjeshtëzoje, mos e ngatërroni'".

9 "Thuaji, 'Shkurt, shkurt, shkurt. Shkurt'. Thuaji që të  
10 mos filozofojë."

11 "Do ja japin, por duhet t'i korrigojë. Kur vjen këtu  
12 para se të hyjë në sallë duhet t'i korrigojë."

13 "Thuaji që, 'S'i ke parë të dy ata që nga 1994 deri në  
14 1998. Mbylle."

15 Të gjitha këto janë udhëzimet që Hashim Thaçi u ka dhënë  
16 të bashkakupuarve të tij ndërkohë që ai që ai ishte i  
17 paraburgosur këtu në Hagë në vitin 2023. Komanda e  
18 drejtpërdrejtë e të akuzuarit ndaj të -- e Thaçit ndaj të  
19 bashkakupuarve ju tregon se për çfarë bëhet fjalë në këtë  
20 çështje gjyqësore. Këtu bëhet fjalë për përpjekjet e  
21 qëndrueshme dhe sistematike të z. Thaçi për të penguar punën e  
22 kësaj Gjykate duke u përpjekur për të ndikuar dhe për të  
23 ndërhyrë në dëshminë e dëshmitarëve, duke nxjerrë informacion  
24 konfidencial të dëshmitarëve, dhe duke mos marrë parasysh dhe  
25 duke mos iu bindur urdhrave të qarta të Gjykatës.

1 Prokuroria do të tregojë përmes argumenteve se të gjitha  
2 udhëzimet e Thaçit, dhe ka shumë të tjera të cilat janë prova,  
3 kanë patur një synim të qartë dhe një shënjestër të qartë.  
4 Shënjestra ishin dëshmitarët specifikë, dëshmia e të cilëve  
5 sipas Thaçit ishte -- përbënte kanosje për të. Synimi ishte që  
6 secili prej këtyre kërcënimeve të neutralizohet me qëllim që  
7 Thaçi t'i shmangej drejtësisë.

8 Secili e prej të bashkakuzuarve të Thaçit që ndodhen këtu  
9 sot ishin partnerët e tij për të arritur këtë synim të  
10 përbashkët. Tre prej tyre - z. Fazliu, z. Kilaj dhe z. Smakaj  
11 i zbatuan urdhrat e Thaçit si grupe.

12 I katërti, z. Kuçi, akuzohet për mosbindje ndaj Gjykatës  
13 pasi vetë ka rënë dakord për të ekzekutuar udhëzimet e Thaçit,  
14 dhe në mënyrë të veçantë për mosbindjen ndaj Gjykatës duke  
15 shkelur në mënyrë të drejtpërdrejtë një urdher të Gjykatës.  
16 Provat do të tregojnë që kur z. Thaçi [Sipas përkthimit] bëri  
17 plane me z. Thaçi për të ndërhyrë në dëshminë e dëshmitarëve  
18 ai i dinte rregullat pasi -- që po thyente, pasi ishte vetë  
19 avokat mbrojtës në ekipin e Kadri Veselit.

20 Të nderuar Gjykatës, faktet fillojnë këtu në Hagë dhe me  
21 disa fakte të cilat janë përtej dyshimit të arsyeshëm.

22 Me 5 nëntor 2020, z. Thaçi u arrestua dhe u akuzua së  
23 bashku me tre anëtarë të nivelit të lartë të Ushtrisë  
24 Çlirimtare të Kosovës me krime lufte dhe krime kundër  
25 njerëzimit, të cilat buronin nga lufta për lirinë për çlirimin

1 e Kosovës e vitit 1998-1999.

2 Siç e tha Prokurorja Specializuar, z. Thaçi nuk është në  
3 këtë sallë gjyqi sot për t'u gjykuar për ato vepra penale. Por  
4 është fakt që -- fakti që në qoftë se gjendet fajtor në atë  
5 çështje, z. Thaçi do të ketë një -- do të dënohet me një  
6 burgim të gjatë dhe i jep motiv atij për të shfrytëzuar të  
7 gjitha mjetet për të mos u shpallur fajtor. Dhe vizitat në  
8 qendrën e paraburgosjes nga të bashkakuzuarit u bënë -- ishin  
9 një nga mënyrat e shfrytëzuara.

10 Pas arrestimit të tij Thaçi u paraburgos dhe Gjykatësi i  
11 Procedurës Paraprake në nxjerrjen e këtij vendimi pranoi  
12 klimën e vazhdueshme dhe të përcaktuar tashmë të frikësimit të  
13 dëshmitarëve dhe ndërhyrjes me procesin penal kundër ushtarëve  
14 -- anëtarëve të UÇK-së. Dhe pikërisht në këtë klimë dhe kjo  
15 ndërhyrje është ajo që është në thelb të procedurave që po  
16 zhvillohen këtu në Hagë.

17 Ndërkohë që vazhdoi Çështja 06, Gjykata nxori urdhra  
18 gjyqësor të cilat synonin që të mos nxirrej identiteti dhe  
19 informata të tjera private të një numri të dëshmitarëve të  
20 Prokurorisë. Gjykata i nxori këto masa me qëllim që të  
21 mbroheshin dëshmitarët nga frikësimi i mundur dhe ndërhyrja.

22 Gjykata po kështu nxori edhe protokolle të rrepta për  
23 kontaktimin, që kishin të bënin me mundësinë e të akuzuarit të  
24 numrit 06, e para, numër një që kishte të bënte me kontaktimin  
25 e dëshmitarëve të Prokurorisë; e dyta, për të diskutuar

1 dëshminë e dëshmitarëve -- dëshminë lëndore të dëshmitarëve;  
2 dhe treta për të nxjerrë identitetin përtej anëtarëve të  
3 ekipeve të Mbrojtjes.

4 Dhe një prej këtyre ishte që të mos bëhej -- prej urdhrit  
5 -- e ndalonte Thaçin nga kontaktimi i dëshmitarëve të  
6 Çështjesh 06, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë pa  
7 urdhër të Gjykatës. Me fjalë të tjera ky urdhër nënkupton z.  
8 Thaçi nuk lejohej që të shfrytëzonte miqtë e tij apo  
9 bashkëpunëtorët që ta vizitonin në Hagë për të kontaktuar  
10 dëshmitarë të ZPS-së për t'u treguar atyre se çfarë dëshmie të  
11 japin.

12 Dhe më këto urdhra të nxjerra Prokuroria i nxori Thaçit  
13 dhe të akuzuarve të tjerë të Çështjes 06 identitetin e  
14 dëshmitarëve të mbrojtur, bashkë me deklaratat e tyre  
15 paraprake, provat materiale që do të shfrytëzoheshin me  
16 secilin prej tyre në sallën e gjyqit, dhe afërsisht edhe në  
17 çfarë rendi do të shfaqeshin ata për të dhënë dëshmi para  
18 Trupit Gjykues. Gjykata ishte e qartë: informacioni  
19 konfidencial mbi dëshmitarët që i ishte dhënë palës mbrojtëse  
20 që nuk kishte të bënte thjesht me emrin e dëshmitarëve por  
21 edhe statusin e tyre si dëshmitarë të ZPS-së, ishte  
22 informacion i cili do të duhej mbrojtur gjatë gjithë kohës.

23 Gjatë gjithë kësaj kohe dhe të gjithë periudhës së  
24 aktakuzës së kësaj çështje që është prilli deri në tetor 2023,  
25 Thaçi i paraburgosur ndërkohë që -- në objektin e paraburgimit

1 dhe së DHSK-së. Gjatë tij paraburgimi Thaçi ka pasur të drejtë  
2 dhe privilegje përfshirë dhe shfrytëzimin e kompjuterit të  
3 cilin nuk e -- qasje në të cilin nuk kanë pasur të tjerët.  
4 Thaçi mund ta shfrytëzonte këtë kompjuter për të përgatitur  
5 mbrojtjen e tij, dhe për të parë materiale konfidenciale që  
6 kishte nxjerrë ZPS-ja, përfshirë materiale sensitive për  
7 dëshmitarët. Ka patur mundësinë gjithashtu për të printuar  
8 dokumente, përfshirë materiale konfidenciale të dëshmitarëve  
9 që kishte ZPS-ja. Dhe përveç kontakteve me familjen, Thaçi ka  
10 pasur mundësinë që të kishte takime edhe me persona të tjerë,  
11 me miqtë dhe me bashkëpunëtorët.

12 Gjatë gjithë kësaj periudhe objekti i paraburgimit ka  
13 patur rregulla për të -- për këto vizita. Një prej këtyre  
14 rregullave ishte që të gjitha vizitat joprivilegjuara,  
15 përfshirë të gjitha vizitat që ka mbajtur z. Thaçi me të  
16 bashkakuzuarit e kësaj çështje, do të duhej të bëheshin në  
17 praninë e oficerëve të paraburgimit të cilët të mund të  
18 shikonin dhe të dëgjonin. Rregull tjetër ishte që të  
19 paraburgosurit dhe vizitorët e tyre nuk ishin të lejuar që të  
20 shkëmbenin asnjë material pa patur miratimin paraprak të  
21 qendrës, të objektit -- të shefit të objektit të paraburgimit.

22 Rregullat ishin të qarta, publike dhe Thaçi dhe të gjithë  
23 vizitorët e tij i kanë ditur ato përfshirë të bashkakuzuarit e  
24 kësaj çështjeje.

25 Të nderuar Gjykatës, ky është edhe konteksti faktik dhe

1 procedural i pikave të kësaj aktakuze, dhe në këtë kontekst  
2 filloi edhe gjykimi i Thaçit në Çështjen 06 në prill 2023.

3 Po të ishin ndjekur urdhrat e Gjykatës, masat mbrojtëse  
4 dhe vizitat në objektin e paraburgimit do të ishte parandaluar  
5 ndërhyrja ndaj dëshmitarëve dhe pengimi procesit gjyqësor për  
6 të cilin janë nxjerrë këto. Është shfrytëzuar kjo Gjykatë dhe  
7 është pikërisht për të ruajtur të drejtën e Thaçit për një  
8 gjykim të drejtë dhe të barabartë, për të drejtën e tij për të  
9 patur rol aktiv në mbrojtje, duke -- edhe me anë të printimit  
10 të materialeve sensitive.

11 Por nuk kanë ndodhur kështu.

12 Thaçi dhe të bashkakuzuarit e kësaj çështje vendoson që  
13 të mos i zbatonin urdhrat dhe rregullat e kësaj Gjykate.  
14 Dëshmi do të tregojnë se sapo filloi Çështja 06 dhe filluan të  
15 japim dëshmi dëshmitarët, z. Thaçi u përqendrua në pengimin e  
16 dëshmisë së dëshmitarëve të cilët mund të dëmtonin edhe  
17 mbrojtjen e tij. Ai u përqendrua në mënyrë të veçantë dhe në  
18 mënyrë të përqendruar ndaj asaj që do të thonin dëshmitarët  
19 për të, dhe çfarë rreziku përbënte dëshmia e tyre për të dhe  
20 për fajësinë e tij.

21 Dhe me qëllim që të siguronte atë përfundim që dëshironte  
22 dhe për t'i minimizuar dëshminë e cila mendohej se mund ta  
23 dëmtonte, Thaçi i shkeli të gjitha rregullat e paraburgimit  
24 dhe të konfidencialitetit të DHSK-së dhe e shfrytëzoi sistemin  
25 për veten e tij. Ai e ktheu objektin e paraburgimit, me anë të

1 vizitave të tij me bashkëpunëtorët, në një qendër të pengimit,  
2 dhe në mënyrë të vazhduar i ka shënjestruar gënjeshtar  
3 dëshmitar duke pëshpëritur urdhra për vizitorët e tij në  
4 mënyrën sesi duhet të jepnin dëshmi dëshmitarët për të  
5 ndihmuar atë.

6 Ai e ka abuzuar sistemin e nxjerrjes së materialeve të  
7 kësaj Gjykate me qëllim që të nxirrte dëshmitarin e --  
8 dëshminë dëshmitarëve, nganjëherë rresht për rresht, me qëllim  
9 që të shfrytëzonte -- që të -- me qëllim që të ndryshonin ata  
10 dëshmitë e tyre. Dhe më pas e ka shfrytëzuar kompjuterin e tij  
11 dhe qasjen që ka patur në printerin e objektit të paraburgimit  
12 për të bërë, për të realizuar planin e tij përmes të  
13 bashkakuzuarve.

14 Z. Thaçi kishte dy lloj dëshmitarësh. Të parët ishin të  
15 brendshmit e UÇK-së, të cilët në mënyrë të veçantë  
16 identifikojnë Thaçin, në thonjëza, në mënyrë -- të cilët i  
17 mendoi se ishin "vendimtarë" për fatin e tij, dhe të cilët do  
18 të duhej të jepnin dëshmi për strukturën dhe funksionimin e  
19 brendshëm të UÇK-së, përfshirë edhe rolin drejtues të Thaçit.  
20 Lloji i dytë apo tipi i dytë, ishin dëshmitë e viktimave --  
21 dëshmitarët viktimë të cilat mund të implikonin Thaçin në  
22 pikat e aktakuzës së Çështjes 06.

23 Thaçi ka studiuar dëshmitë paraprake, në mënyrë  
24 sistematike ka shfrytëzuar vizitat e paprivilegjuara për t'u  
25 thënë bashkëpunëtorëve, përfshirë bashkëpunëtorëve të tij që

1 ndodhen këtu, se çfarë duhej bërë. Se çfarë duhet të  
2 ndryshonte secili prej dëshmitarëve nga dëshmitë e tyre  
3 paraprahe dhe kur duhej ta bënë këtë ndryshim. Çfarë duhej të  
4 thoshte në gjykatë një dëshmitari caktuar dhe si ta thoshte,  
5 edhe duke arritur dhe në faktin se si duhej të vishej një  
6 dëshmitari caktuar.

7 Dhe për t'i ekzekutuar këto kërkesa Thaçi krijoi grupe të  
8 veçanta nga -- të bashkëpunëtorëve të tij që të shënjestronte  
9 dëshmitarët e posaçëm. Këta të bashkakuzuar, dhe anëtarët e  
10 tjerë të grupit për të cilët nuk janë ngritur aktakuza, kanë  
11 demonstruar marrëveshjen e tyre për të arritur synimin e  
12 përbashkët.

13 Për secilin prej këtyre pjesëve, Thaçi zgjodhi si  
14 instrumente të pengimit njerëz të cilët i njihnin dëshmitarët,  
15 që kishin kontakte me to dhe kishin marrëdhënie me to.

16 Në rastin e z. Kuçi, Thaçi nuk shfrytëzoi një grup  
17 njerëzish. Ai shfrytëzoi një vizitë të paprivilegjuar me një  
18 anëtar të ekipit të Mbrojtjes së një të akuzuari tjetër në  
19 Çështjen 06, me qëllim që të shënjestronte një numër  
20 dëshmitarësh, përfshirë dy të brendshëm të UÇK-së dhe një  
21 viktime të pretenduar të keqtrajtimit nga ana e anëtarëve të  
22 UÇK-së.

23 Me 2 korrik 2023 shihet sjellja penguese e z. Thaçi në  
24 rastin kur z. Fazliu i bëri një vizitë Thaçit në objektin e  
25 paraburgimit. Dhe kjo përbën edhe bazën e akuzës kundër

1 Fazliut në aktakuzë , akuzës së veprimit në grup.

2 Me 21 qershor 2023, ZPS-ja e informoi një -- të akuzuarit  
3 e Çështjes 06 se një i brendshëm i UÇK-së, Rrustem apo "Remi"  
4 Mustafa do të jepte dëshmi në korrik të 2023-shit. Ishte ky  
5 një dëshmitar i rëndësishëm i Prokurorisë, i cili do të jepte  
6 dëshmi për disa ditë. Thaçi i kishte nga materialet e nxjerra  
7 në Çështjen 06 gjitha dëshmitë e pritshme të Mustafës,  
8 përfshirë edhe rolin e tij si komandant i një zone gjatë  
9 luftës.

10 Pesë ditë pasi ZPS-ja njoftoi dëshmitarin dhe rendin në  
11 të cilin do të jepte dëshminë e tij më 26 qershor 2023, djali  
12 i Fazliut, Fahri Fazliu, kontaktoi Mustafën për të caktuar një  
13 takim mes Mustafës, Fahriut dhe Fadil Fazliut. Tre ditë më  
14 vonë më 29 qershor të tre u takuan në Kosovë dhe të nesërmen  
15 Fazliu shkoi dhe bëri një takim me Thaçin në objektin e  
16 paraburgimit që zgjati rreth dy orë. Dhe kjo vizitë u  
17 audioincizua në bazë të një urdhri gjyqësor.

18 Gjatë kësaj vizitem Thaçi u përqendrua në dëshminë e  
19 pritshme të Rrustem Mustafës. Thaçi iu referua dëshmitarit me  
20 me anë të nofkës së tij Remi. Thaçi identifikoi së dëshmia e  
21 Mustafës ishte vendimtare për mbrojtjen e tij, dhe Thaçi e  
22 shpjegoi se sa e rëndësishme ishte që Mustafa të vendoste  
23 precedentin të cilin do ta ndiqnin dëshmitarët e tjerë, duke  
24 thënë që dëshironte Thaçi.

25 Thaçi i tha Fazliut hollësisht se si donte ai që të ishte

1 dëshmia e Mustafës, çfarë duhej të thoshte Mustafa, si ta  
2 thoshte. Si do të ishte seanca përgatitore e këtij dëshmitari  
3 me ZPS-në, dhe si duhet të përballonte ai, me qëllim që z.  
4 Mustafa të kthehej në Kosovë ose si "hero" ose "si njeri i  
5 turpëruar" në varësi të dëshmisë që do të jepte.

6 Dhe Thaçi i dha urdhër Fazliut që këto udhëzime t'ja  
7 kalonte Mustafës përpara se ai të jepte dëshminë. Me qëllim,  
8 dhe citoj, "kjo gjë të bëhej në atë moment".

9 Audioincizimi i kësaj vizite tregon se Fazliu jo vetëm që  
10 ra dakord që të bënte atë që i tha Thaçi, por në mënyrë aktive  
11 kontribuoi se çfarë mendonte ai që duhej të thoshte në gjykatë  
12 Mustafa dhe mori hapa konkrete për ta zbatuar këtë ndërhyrje.  
13 Ata kanë patur një plan të përbashkët.

14 Z. Thaçi e vazhdoi këtë model me datën 8 -- 6 tetor 2023,  
15 kur z. Kilaj dhe një bashkëkryes tjetër, Fazli Kryeziu, ndaj  
16 të cilit nuk janë ngritur akuza, i bëri një vizitë Thaçit -- i  
17 bëri vizitë Thaçit në objektin e paraburgimit, siç kërkoi  
18 Thaçi në shtator. Të tre, Grupi Kilaj, siç thuhet në aktakuzë  
19 u takuan për disa orë në objektin e paraburgimi. Bisedat e  
20 tyre, në bazë të një urdhri gjyqësor, u incizuan.

21 Thaçi i shfrytëzoi vizitat për të shënjestuar dëshmitarë  
22 të caktuar të Çështjes 06.

23 Në këtë rast, objekti i ndërhyrjes nuk kishte një i  
24 brendshëm i UÇK-së por një viktimë e Çështjes 06, e një krimi  
25 të pretenduar. Në këtë rast ishte një viktimë e cila më parë e

1 kishte implikuar Thaçin në lidhje më keqtrajtimin e paligjshëm  
2 që i kishin bërë atij anëtarët e UÇK-së. Ishte dëshmia e këtij  
3 Dëshmitarit 4 e cila ishte parashikuar të ishte në nëntor  
4 2023. Thaçi kishte frikë se dëshmia e Dëshmitarit 4 mund ta  
5 dëmtonte atë rëndë, dhe kishte frikë se mund ta implikonte  
6 Thaçin në atë që i kishte ndodhur atij. Thaçi i tha Kilajt dhe  
7 Kryeziut se çfarë duhej bërë: Dëshmitari 4 duhej të ndryshonte  
8 një pjesë të posaçme të dëshmisë së tij të mëparshme me qëllim  
9 që të minohej identifikimi që i kishte bërë ai paraprakisht  
10 Thaçit si person i cili kishte marrë pjesë në keqtrajtimin.  
11 Kilaj dhe Kryeziu e kuptuan dhe ranë dakord me këtë dhe morën  
12 një rol aktiv në diskutimin me Dëshmitarin 04 dhe dëshmitarët  
13 e tjerë të Çështjes 06 gjatë gjithë kësaj vizite.

14 Megjithatë Thaçi nuk e ka nuk i tha thjesht Kilajt dhe  
15 Kryeziut se çfarë duhej të thoshte Dëshmitari 4, por madje ua  
16 tregoi, dhe Kilaj mori shënime. Përdori kopje të printuara të  
17 deklaratave të mëparshme të Dëshmitarit 4, që ishin  
18 konfidenciale, që ishin treguar në Çështjen 06, dhe Thaçi  
19 theksoi - biles e nënvizoi pjesën, faqen edhe rreshtin -  
20 saktësisht se çfarë duhet të ndryshonte dëshmitari.

21 Madje nuk ndaloi këtu. Kaq i merakosur ishte për  
22 udhëzimet e tij, dhe kishte merak që të respektoheshin  
23 udhëzimet për Dëshmitarin 4, sa iu dha dhe një kopje të  
24 deklaratës së Dëshmitarit 4 të cilën e morën nga njësia e  
25 paraburgimit. Jo vetëm është kjo një shkelje e rregullores së

1 paraburgimit, por është një krim në vetvete.

2 Në të njëjtën vizitë, Thaçi dha informacione  
3 konfidenciale për dëshmitarë të tjerë të Prokurorisë, të  
4 gjitha këto janë bërë në kundërshtim me urdhrat e Gjykatës.  
5 Për shembull, pasi përshkoi dëshminë e një dëshmitari të  
6 mbrojtur, për cilin nuk i pëlqeu dëshmi, Thaçi i tha Kilajt  
7 dhe Kryeziut se dëshmitari kishte "njollosur familjen e tij"  
8 dhe "kishte prishur nderin e familjes". Kilaj u pajtua dhe i  
9 tha Thaçit në mënyrë të vazhdueshme, po citoj, "një idiot".

10 Pasi ra dakord me Kilajn se ky dëshmitar ishte tërësisht  
11 "budalla", Thaçi menjëherë dha identitetin e një dëshmitari  
12 tjetër të mbrojtur, dhe kësaj here ai lëvdoi dëshminë e këtij  
13 dëshmitari dhe e quajti një "burrë të vërtetë" dhe konfirmoi  
14 prejardhjen e dëshmitarit.

15 Të nesërmen, më 7 tetor 2023, z. Thaçi vazhdoi praktikën  
16 e tij për të ndikuar në Ëështjen numër 06. Këtë herë vizitorët  
17 ishin z. Smakaj dhe Artan Behrami, një bashkëkryes tjetër në  
18 këtë çështje për të cilin nuk janë ngritur akuza. Kjo ishte  
19 vizita e dytë e z. Smakaj në më pak se një muaj, që vijonte  
20 nga një vizitë e mëparshme e 9 shtatorit, edhe kështu krijohet  
21 grupi Smakaj siç ngrihen aktakuzat në aktakuzë.

22 Gjatë dy vizitave të Smakajt, Thaçi dha informacione  
23 konfidenciale të Çështjes 06, përfshirë hollësi për dëshmitarë  
24 të ndryshëm të mbrojtur të cilët kishin folur në seanca  
25 private. Thaçi madje haptazi u tall me dëshmitarët, një e

1 quajti kurvë, dhe u tall me një tjetër sepse kishte aftësi të  
2 kufizuara. Kur i tha këto, Thaçi qeshi dhe vizitorët po ashtu  
3 qeshën me të.

4 Por fokusi i tij kryesor si në vizitën e shtatorit dhe në  
5 të tetorit të Smakajt ishte veçanërisht për një dëshmitar të  
6 ZPS-së: Bislam Zyrapi. Zyrapi ishte një dëshmitar i ZPS-së, i  
7 cili, njësoj si Rustem Mustafa, pritej të jepte dëshmi për  
8 shumë ditë sa i takon rolit të tij si pjesëtar i UÇK-së, dhe  
9 njësoj si me rastin e Mustafës më 2 korrik, në bisedën e 2  
10 korrikut Thaçi e identifikoi Zyrapi me emër edhe tha që  
11 dëshmia e tij ishte vendimtare për këtë çështje. Më pas Thaçi  
12 vijoi dhe tha se çfarë donte ai që të thoshte Zyrapi dhe si  
13 duhet ta thoshte.

14 Sipas provave që do të shohim do të kuptojmë që Thaçi ka  
15 dhënë një narrativë të hollësuar për Zyrapi se si duhej ta  
16 ndihmonte ai Thaçin në Çështjen numër 06. Kjo narrativë, kjo  
17 përmbledhje ishte një dokument me djetë faqe, që u sekuestrua  
18 nga vetura e z. Smakaj javë pas vizitës së 7 tetorit, një fakt  
19 që do ta trajtoj pak më pas.

20 Sikurse bëri dhe me Mustafën në korrik, Thaçi po ashtu u  
21 fokusua në mënyrën se si Zyrapi duhet të jepte dëshmi, dha  
22 udhëzime se ai duhej të ishte konciz dhe "të mos e zgjidhte  
23 shumë gojën" dhe "të mos jepte opinione", dhe të thoshte më  
24 shumë "nuk e di", ose "nuk më kujtohet".

25 Edhe një herë, udhëzimet që i dha Thaçit z. Smakaj kishin

1 qëllim të përbashkët që ndanë të gjithë anëtarët e grupit: të  
2 minimizohej roli i Thaçit edhe të zbuteshin akuzat në Çështjen  
3 numër 06, në mënyrë që të mos shpallet fajtor.

4 Sërish, gjatë vizitës së shtatorit dhe të tetorit, Smakaj  
5 bashkë me anëtarë të tjerë të grupit të tij, me dëshirë u  
6 pajtuan të ndiqnin udhëzimet e Thaçit dhe madje dhanë edhe ata  
7 udhëzimet e tyre shtesë për mënyrë se si duhet të jepte dëshmi  
8 Zyrapit.

9 Tani flasim për z. Kuçi. Në rastin e z. Kuçi, Thaçi  
10 tregoi që ishte kaq i vendosur sa të ndërhynte në procesin  
11 numër 06 sa që arriti të shkonte të kontaktonte një nga  
12 avokatët e bashkakuzuarve që ta ndihmonte atë.

13 Dhe kjo kuptohet në vizitën që i ka bërë z. Kuçi Thaçit  
14 më 3 shtator 2023, siç ngrihen akuzat në aktakuzë. Atë ditë  
15 Kuçi u takua vetëm me Thaçin në qendrën e paraburgimit për tri  
16 orë. Në këtë periudhë kohore Kuçi kishte qenë anëtar i ekipit  
17 të Mbrojtjes së Kadri Veseli për thuajse dy vjet.

18 Sigurisht ishte një shok i vjetër i Thaçit edhe kishte  
19 qasje --

20 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Përkthyesit ju kërkojnë, ju  
21 lutem, të ngadalësoni pak me fjalën tuaj.

22 Z. HAFETZ: [Përkthim] Më falni.

23 Atëherë, e kuptuam në bisedën që i bëri Kuçi Thaçit më 3  
24 shtator 2023, siç ngrihen akuzat në aktakuzë.

25 Atë ditë Kuçi u takua vetëm me Thaçin në qendrën e

1 paraburgimit për tre orë. Pra, në këtë periudhë kohore, Kuçi  
2 ishte anëtar i ekipit të Mbrojtjes së Kadri Veselit dhe kishte  
3 gati dy vjet që punonte në këtë ekip. Dhe ishte një shok i  
4 vjetër i Thaçit dhe kishte qasje të pakufishme në të gjitha  
5 informacionet lidhur me dëshmitarët në Çështjen 06, dhe z.  
6 Kuçi ishte një mjet perfekt që mund të shfrytëzohej për të  
7 ndërhyrë ndaj dëshmitarëve dhe mos t'i bindej Gjykatës.

8 Vizita e shtatori tregon se Thaçi u angazhua me njëjtën  
9 mënyrë sa i takon dëshmitarëve sikurse rastet që citova më  
10 herët. Së pari folën për gjëra të përditshme, më pas Thaçi dhe  
11 Kuçi fillojnë të pëshpëritin lidhur me atë që ishte vërtetë e  
12 rëndësishme për Thaçin: pra, që dëshmitarët e Çështjes 06 të  
13 jepnin dëshmi në mënyrën siç donte ai.

14 Ai i dha Kuçit udhëzime të hollësishme për të paktën tre  
15 dëshmitarë të ndryshëm. Dy ishin anëtarë të brendshëm të UÇK-  
16 së, përfshirë sërish këtu Bislime Zyrapi, dhe dëshmitari i  
17 tretë ishte dëshmitar krimi i cili pritej të jepte dëshmi  
18 lidhur me keqtrajtimin e pretenduar të paligjshëm prej  
19 anëtarëve të UÇK-së.

20 Njësoj si me të bashkëkuzuarit e tjerë në këtë rast, Kuçi  
21 ra dakord të realizonte këtë ndërhyrje, dhe dha dhe këshilla  
22 vetë ai se çfarë duhet të thoshin dëshmitarët për ta ndihmuar  
23 sa më shumë Thaçin në çështjen e tij. Që të sigurohej që  
24 s'kishte paqartësi dhe se udhëzimet e tij do të ndiqeshin siç  
25 duhet, Thaçi i tha Kuçit t'i shkruante udhëzimet, t'i

1 shkruante ato që po i thoshte Thaçi. Kuçi u pajtua.

2 Dhe në rastin e dëshmitarëve viktima, në këtë rast  
3 Dëshmitari 6, Thaçi këmbënguli që Kuçi të vepronte  
4 urgjentisht, sepse pritej që dëshmitari në fjalë të fillonte  
5 shumë shpejt dëshminë e vet. Thaçi ishte shumë i shqetësuar  
6 për kohën, sa që i tha Kuçit të fillonte të punonte sa më  
7 shpjet me këtë dëshmitar sapo të mbërrinte në Kosovë në  
8 mesnatën e 6 shtatorit. Kuçi u pajtua, dhe këtë mund ta shohim  
9 nga të dhënat e telefonit të tij, pra që ai bëri çfarë i tha.

10 Veç kësaj, veç faktit që nuk respektoi urdhrat e Gjykatës  
11 duke kontaktuar në mënyrë të paligjshme dëshmitarët, Kuçi po  
12 ashtu akuzohet për mosbindje të Gjykatës, për faktin se ka  
13 kontaktuar Rustem Mustafën në prill 2023 në momentin që po  
14 fillonte Çështja 06. Ky kontakt ka qenë shkelje e protokollit  
15 të Çështjes 06 sa i takon dëshmitarëve. Në mesazhin e tij,  
16 Kuçi i përcolli Mustafës përgëzimet të një personi pa emër  
17 për, citoj, "idetë e qarta, për vendin dhe për luftën". Ide të  
18 cilat harmonizohen -- që janë në përputhje me udhëzimet që i  
19 ka dhënë z. Thaçi z. Fazliu gjatë vizitës së korrikut.

20 I nderuar Gjykatës, përpjekjet e Thaçit për të ndërhyrë  
21 ndaj dëshmitarëve nuk janë të kufizuara vetëm në pesë vizitat  
22 që unë ju tregova.

23 Siç duket nga aktakuza, dhe siç e kemi dhe në prova, z.  
24 Thaçi përdori edhe shumë vizita të tjera për të nxjerrë  
25 informacione konfidenciale dhe për të dhënë udhëzime për

1 dëshmitarët. Motivi për këtë ndërhyrje mbetet i njëjti: që  
2 dëshmitarët të ndryshonin deklaratat e mëhershme ose të  
3 dëshmonin në një mënyrë të atillë që ta ndihmonin çështjen e  
4 z. Thaçi. E vetmja gjë që ndryshoi ishte data e kalendarit,  
5 bashkëkryesi në dhomë, edhe dëshmitari i cili shënjestrohej.

6 Tani pyetja është si do ta vërtetojë Prokuroria të gjithë  
7 këtë përtej dyshimit të arsyeshëm. Përgjigja është e thjeshtë,  
8 ne kemi prova të shumta të cilat pothuajse janë pranuar të  
9 gjitha në këtë çështje gjyqësore.

10 Ndër prova përfshihen incizime të bisedave audio të z.  
11 Thaçi me të bashkakuzuarit të cilat janë autorizuar nga  
12 Gjykata, si dhe me vizitorë të tjerë në ditë të tjera, ku u  
13 fokusua në shenjtërimin e dëshmitarëve të ZPS-së për  
14 ndërhyrje, dhe ka nxjerrë informacion konfidencial lidhur me  
15 dëshmitarët. Në bazë të incizimeve duket se në rastin e Thaçit  
16 dhe të tjerëve ne dëgjojmë fjalët, dëgjojmë pëshpërime, që  
17 është qartazi përpjekje për të ndërhyrë ndaj dëshmitarëve,  
18 mosrespektimin e Gjykatës dhe mosrespektimin e sundimit të  
19 ligjit.

20 Në prova, po ashtu, kemi incizime të qendrës së  
21 paraburgimit ku konfirmohet prania e secilit prej të akuzuarve  
22 në vizitat në fjalë, thirrjet telefonike të qendrës së  
23 paraburgimit, urdhra të Gjykatës, vendime dhe rregullore që  
24 tregojnë rregullat dhe urdhërojnë dhe tregojnë se çfarë  
25 rregullash dhe urdhrash ka shkelur Thaçi dhe të

1 bashkakuzuarit, edhe kur kanë ndodhur këto, në mënyrë që të  
2 shtojmë kontekstin sa i takon pengimit të drejtësisë.

3 Po ashtu përfshihen provat gjyqësore të Çështjes 06, ato  
4 që i janë dhënë Thaçit në rastin e Çështjes numër 06, që më  
5 pas Thaçi i përdori për të shënjestruar disa dëshmitarë dhe  
6 për të nxjerrë informacion konfidencial, në kundërshtim me  
7 urdhrat e Gjykatës. Provat fizike që janë marrë nga të  
8 akuzuarit në bazë të urdhrave për sekuestrim, përfshirë  
9 dokumente që ishin printuar nga qendra e paraburgimit, më pas  
10 ishin përdorur nga Thaçi dhe të bashkakuzuarit për të  
11 shënjestruar dëshmitarët gjatë vizitave të tyre, dhe më pas  
12 janë sekuestruar prej të bashkakuzuarve në ambientet e tyre në  
13 Kosovë.

14 Po ashtu, kemi dëshmi që janë prova që janë marrë nga  
15 thirrjet telefonike dhe pajisje të tjera elektronike,  
16 përfshirë komunikimet të cilat konfirmojnë çfarë është  
17 diskutuar gjatë vizitës së z. Thaçi.

18 Po ashtu, janë të dhëna që janë marrë nga kompjuterat në  
19 qendrën e paraburgimit dhe printerat që ka përdorur Thaçi,  
20 përfshirë të dhëna që tregojnë, që kanë gjurmimin e dokumente  
21 që janë printuar që janë përdorur më pas për të shënjestruar  
22 dëshmitarët.

23 Dhe më pas kemi akt-ekspertiza që tregojnë më tej se disa  
24 dokumente lidhur me dëshmitarët që janë sekuestruar prej të  
25 akuzuarve, në fakt, ishin printuar nga i vetmi printer në

1 qendrën e paraburgimit, që ishte në dispozicion të z. Thaçi.

2 I nderuar Gjykatës, këto prova plotësojnë njëra-tjetrën  
3 dhe përforcojnë më tej faktin, dhe tregojnë përtej dyshimit të  
4 arsyeshëm se i akuzuari ka kryer secilën prej veprave penale  
5 për të cilat akuzohet.

6 Tani të flasim më në hollësi për llojet e provave dhe si  
7 lidhen këto prova me njëra-tjetrën.

8 Pjesë e provave gjyqësore janë nëntë audioincizime të  
9 vizitave të Thaçit në qendrën e paraburgimit.

10 Në lidhje me këto incizime, siç e keni lexuar në  
11 parashtrimet e protokolluara publike, dhe sikurse e përmenda,  
12 këto incizime u miratuan me urdhër të Gjykatës. Këto  
13 autorizime ishin vetëm për disa muaj të paraburgimit të z.  
14 Thaçi dhe sigurisht që ishin objekt i mbikëqyrjes gjyqësore.

15 Z. Thaçi është personi që shënjestronte dëshmitarët dhe  
16 ka nxjerrë informacion të mbrojtur në këto incizime, kjo është  
17 e padiskutueshme dhe është shumë e qartë. Ai dallohet shumë  
18 thjesht jo vetëm nga zëri, që është zbardhur në incizimet  
19 tona, por dhe nga përmbajtja e asaj që thotë, përfshirë fakte  
20 të shumta që lidhen veç me atë. Ai është i njëjti zë që  
21 dëgjohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë këtyre vizitave që ne  
22 kemi incizuar. Të gjitha këto janë marrë nga Zyra  
23 Administrative në përputhje me Rregulloren e Dhomave të  
24 Specializuara.

25 Z. Thaçi, po ashtu, dallohet nga praktika e përbashkët e

1 ndërhyrjes së dëshmitarëve, mënyra se si jep udhëzimet dhe  
2 informacionet konfidencial që ka dhënë gjatë vizitave të  
3 shumta. Pra, bëhet fjalë për të njëjtën përmbajtje: udhëzime  
4 dhe informacione që përputhen me faktet që janë grumbulluar  
5 dhe janë mbledhur jashtë dhomave të vizitave.

6 Të bashkakuzuarit këtu janë personat me të cilët ka folur  
7 Thaçi dhe i kemi incizimet, dhe i kemi pjesë të provave  
8 gjyqësore dhe kjo është e padiskutueshme, nuk le hapësirë për  
9 gabime. Fakti që secili prej këtyre personave e ka vizituar  
10 Thaçin është e dokumentuar nga materiale të ndryshme,  
11 përfshirë thirrjet telefonike në qendrën e burgimit që tregon  
12 faktin që ata kanë qenë të pranishëm ditën përkatëse, dhe që  
13 kanë nënshkruar listëprezencën. Më pas në incizimet audio,  
14 Thaçi u drejtohet me emër këtyre personave, dhe ata të gjithë  
15 thonë fakte për veten që përputhen me provat e jashtme,  
16 përfshirë të dhënat e tyre telefonike.

17 Tani, disa pjesë të këtyre incizimeve janë të vështira të  
18 dëgjohen krahasuar me pjesë të tjera. I nderuar Gjykatës, ju  
19 këtë do ta shihni vetë. Kjo ishte e qëllimshme. Ishte krejt e  
20 qëllimshme, e synuar. Thaçi dhe të bashkakuzuarit e dinin, e  
21 dinin bazuar në rregulloret e Dhomave të Specializuara edhe  
22 dinin dhe për faktin se ishin fizikisht atje, që gjithçka që  
23 thuhej gjatë këtyre vizitave duhej të ishte e dëgjueshme për  
24 oficerët e qendrës së paraburgimit që ndodheshin jashtë dhomës  
25 së vizitave.

1 Në periudha të caktuara, Thaçi dhe të bashkakuzuarit, në  
2 fakt, e respektuan rregulloren. Madje flisnin me zëra normale,  
3 me volum normal, zakonisht kur flisnin për politikën, kur  
4 tregonin për familjen, apo kur ndanin opinione se si po  
5 performonte ekipi ligjor i Thaçit në Çështjen 06.

6 Por, për gjërat e rëndësishme, pra kur donte të fliste  
7 për punën apo për mënyrën si duhej të ndërhyhej me  
8 dëshmitarët, kur donte të jepte udhëzime të hollësishme për  
9 vizitorët e tij, Thaçi ndryshonte menjëherë tonin. E ulte  
10 zërin, fillonte pëshpëriste, dhe të bashkakuzuarit bënë të  
11 njëjtën gjë.

12 Këtë mund ta shihni vetë në incizimet që janë pranuar në  
13 këtë çështje gjyqësore. Nuk ka qenë aksidentale. Ishte e  
14 qëllimshme. Kjo është e qartë edhe nga një fragment i shkurtër  
15 audio i vizitës së Fazliut në korrik, që unë do ta transmetoj  
16 tani. Incizimi dhe transkriptet për këtë dokument janë pranuar  
17 tashmë dhe kanë marrë numrin P105\_ET dhe 105\_AT.

18 Ju do të dëgjoni këtu që pasi Thaçi përshëndetet me z.  
19 Fazliu i tregon atij se çfarë duhet të bëjë lidhur me dëshminë  
20 e pritshme të Rrustem Mustafës, dhe këtu e ndryshon zërin.  
21 Thaçi fillon të pëshpërisë në mënyrë që t'i mbulojë udhëzimet  
22 e veta dhe të mos dëgjohet, dhe volumi i zërit ulet gjithnjë e  
23 më shumë në momentin që fillon jep udhëzimet.

24 Ky klip është thjesht tre minuta dhe do ta ndjekim tani.

25 [Luhet videoincizimi]

1           Z. HAFETZ: [Përkthim] Pra, ky ishte thjesht një shembull  
2 për të parë elementët e përpjekjes për të cilën ngrihen akuza  
3 në aktakuzë. Pra, Thaçi i jep udhëzime Fazliu se si duhet të  
4 japë dëshmi Mustafa në mënyrë që të minimizojë përgjegjësinë  
5 dhe fajin e Thaçit. Pastaj Fazliu jep komentet e veta se çfarë  
6 duhet të thotë Mustafa dhe i raporton Thaçit se ka filluar të  
7 japë mesazhe, të jetë ndërmjetës, pra, për mesazhet, korrier  
8 përmes Thaçit dhe Mustafës dhe ka përdorur djalin e tij  
9 Fahriun për këtë.

10           Pra, kjo është e zbardhur në të gjitha incizimet dhe kjo  
11 mjafton për të përligjur të gjitha akuzat. I nderuar Gjykatës,  
12 ne kemi transkripte, kemi incizime por kemi dhe dokumente të  
13 tjera, sepse për secilën prej akuzave ka prova të tjera jashtë  
14 që nuk kanë lidhje me incizimet, që konfirmojnë, në fakt,  
15 përmbajtjen e transkripteve dhe përforcojnë më tej fajësinë e  
16 të akuzuarve.

17           Të flasim konkretisht për këtë që sapo pamë. Të dhënat e  
18 paraburgimit konfirmojnë vizitën e z. Fazliu në 2 korrik. Veç  
19 faktit që Thaçi dhe Fazliu e përmendin Remin me emër kur  
20 fillojnë ta diskutojnë, të dhënat e Gjykatës që i janë dhënë  
21 Thaçit në Çështjen 06 përmbajnë faktorë të ndryshëm  
22 identifikues që vërtetojnë se Thaçi, në fakt, po shënjestronte  
23 Rrustem Mustafën në vizitën e 2 korrikut. Këto dokumente janë  
24 pranuar si prova gjyqësore. Mesazhet dhe të dhëna të tjera  
25 telefonike tregojnë se hollësitë e asaj që ka diskutuar Thaçi

1 dhe Fazliu, çfarë kanë diskutuar, planifikuar dhe për të cilat  
2 kanë rënë dakord në takimin e korrikut është pikërisht çfarë  
3 ndodhi më pas jashtë qendrës së paraburgimit.

4 Për shembull, Fazliu i raportoi Thaçit se e kishte takuar  
5 Mustafën tek Route 66, tek ky restoranti Route 66 ditën e  
6 enjte menjëherë para se Fazliu të vinte në Hagë për të takuar  
7 z. Thaçi. Këtë e kishit në fragmentin që sapo dëgjuam.

8 Mesazhet që janë sekuestruar nga telefoni i z. Mustafa  
9 konfirmojnë pikërisht këtë. Së pari, e shihni këtu, është një  
10 provë e ZPS-së që ka numrin SPOE398224, pra, në këtë provë do  
11 të shihni që më 26 qershor 2023, Fahri Fazliu fillimisht  
12 kontaktoi Mustafën në emër të babait të tij, Fadilit, dhe u  
13 përpoq të organizonte një takim. Siç duket nga mesazhet,  
14 takimi nuk mbajti më 26 se Mustafa nuk ishte në qytet. Mesazhet  
15 e z. Mustafa më pas tregojnë se pas tre ditësh, të enjten, më  
16 29 qershor Fahriu e organizoi takimin me z. Mustafa tek  
17 restoranti Route 66 në Prishtinë, pikërisht siç raportoi Fadil  
18 Fazliu gjatë vizitës së korrikut tek z. Thaçi.

19 I nderuar Gjykatës, më lejoni të kaloj dy minuta pas  
20 orarit në mënyrë që ta përfundoj argumentin. Fazliu po ashtu i  
21 tha Thaçit se ai dhe Mustafa kishin rënë dakord të takoheshin  
22 sërish pasi Fazliu të kthehej nga Haga, dhe Fazliu ishte i  
23 gatshëm të transmetonte çdo mesazh për Mustafën nga qendra e  
24 paraburgimit. Fazliu po ashtu i tha Thaçit se do të përdorte  
25 djalin e tij, Fahriun, që të organizonte takimin tjetër me

1 Mustafën, dhe Fazliu kur të kthehej nga Haga do të takohej me  
2 Mustafën pikërisht të nesërmen, që i takon data 3 korrik.

3       Thaçi dhe Fazliu diskutuan secilin prej këtyre planeve  
4 konkrete në fragmentin që ne sapo dëgjuam, siç mund ta shihni  
5 aktualisht në diapozitiv. Dhe më pas, këtu e shikoni në  
6 transkript, Fazliu konfirmon se do të kthehej në Kosovë -- kur  
7 të kthehej në Kosovë do të takohej menjëherë të nesërmen me  
8 Mustafën. Dhe këtu, në këtë diapozitiv, Fazliu konfirmon se do  
9 të takohej me Mustafën sapo që të kthehej. Këtu tek  
10 diapozitivi tjetër, Fazliu konfirmon sërish se do të përdorte  
11 djalin e tij, Fahriun, që të organizonte takimin me Mustafën.

12       Prapë, provat që janë marrë jashtë qendrës së  
13 paraburgimit përputhen.

14       Pikësëpari, të dhënat telefonike të Fazliut që mund t'i  
15 shihni këtu, që ka numrin e provës 120 tani, tregojnë që  
16 Fazliu, në fakt, vërtetë u kthye në Kosovë më 3 korrik siç i  
17 kishte premtuar z. Thaçi.

18       Këtu mesazhet që janë marrë nga telefoni i Rrustem  
19 Mustafës, mund ta shihni në ekran, tregojnë që pak orë, pra -  
20 thjesht orë - pasi Fazliu kishte mbërritur në Kosovë më 3  
21 korrik, kësaj here ai kishte marrë dhe të gjitha udhëzimet e  
22 hollësishme nga z. Thaçi, pra z. Fazliu i kërkoi Fahriut,  
23 djalit të tij, që të organizonte një takim tjetër me Mustafën.

24       Nuk ka asgjë të keqe në telefonin e z. Fadil, sepse ai di  
25 ta përdorë telefonin.

1 Por, më 4 korrik, thjesht një ditë pasi u takua me  
2 familjen Fazliu, Mustafa erdhi në Hagë për t'u përgatitur për  
3 dëshminë e tij, saktësisht siç e kishin diskutuar Thaçi dhe  
4 Fazliu.

5 I nderuar Gjykatës, këto janë disa nga provat në këtë  
6 çështje gjyqësore. Përpyekjet e Thaçit dhe të bashkakuzuarve  
7 për të fshehur sjelljen e tyre të paligjshme dështuan.  
8 Dështuan sepse provat që janë marrë jashtë qendrës së  
9 paraburgimit përforcojnë dhe konfirmojnë atë ç'ka kishin  
10 planifikuar Thaçi dhe të bashkakuzuarit, për të cilat kishin  
11 biseduar dhe pëshpëritur brenda dhomave të vizitave.

12 Mendoj se tani është momenti i përshtatshëm për të bërë  
13 pushimin e par.

14 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit. do bëjmë një  
15 pushim tani deri në orën 12.00.

16 Ju lutem, orën 12.00 fiks të jeni këtu.

17 --- Pauza fillon në orën 11.31

18 --- Seanca rifillon në orën 12.00

19 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Do bëjmë një ndryshim të  
20 shkurtër, sepse u pajtuam që pushimin e drekës ta shkurtojmë  
21 sepse filluam më vonë sot. Kështu që pushimin e drekës do e  
22 bëjmë nga ora 1.30 deri në 2.30 dhe pastaj do e bëjmë seancën  
23 e radhës nga 2.30 deri në orën 4.00.

24 Prokuror, e keni fjalën ju.

25 Z. HAFETZ: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

1 Të marrim një tjetër shembull të mënyrës se si paraqiten  
2 provat e Prokurorisë në këtë çështje gjyqësore.

3 Përpara disa minutash unë po flisja lidhur me vizitën e  
4 Grupit të Kilajt në 6 tetor 2023. Në atë vizitë, Thaçi  
5 shenjëstroji Dëshmitarin 4 për të ndërhyrë, dhe përdori  
6 gjithashtu deklaratat e mëparshme të dëshmitarit si manual për  
7 udhëzime për t'i treguar z. Kilaj dhe z. Kryeziu ekzaktësisht  
8 se çfarë duhet të bënin ata, përfshirë këtu ekzaktësisht se  
9 cilat pjesë të dëshmisë së Dëshmitarit 4 duhet që të  
10 ndryshoheshin në favor të tij dhe si duhet të ndryshoheshin  
11 ato.

12 Në incizimin e kësaj vizite tregohet se si kanë vepruar  
13 Thaçi dhe të bashkakuzuarit e tjerë. Në fillim të vizitës,  
14 Thaçi, Kilaj dhe Kryeziu flasin me zë normal të plotë, ata  
15 flasin normalisht, ata pyesin njëri-tjetrin se si janë dhe  
16 pyesin për zhvillimet e përditshmërisë. Një shembull të kësaj  
17 mund ta dëgjoni nga një fragment i shkurtër nga fillimi i  
18 vizitës që mund ta gjeni në versionin e vetë

19 të plotë në provën materiale të ZPS-së P00109, P00109\_ET  
20 dhe \_AT.

21 Do i kërkoja Sekretares tani që të transmetojë pjesën e  
22 plotë prej 20 sekondash.

23 [Luhet videoincizimi]

24 Z. HAFETZ: [Përkthim] Ajo çfarë dëgjuam është ajo çfarë  
25 ka ndodhur kur Thaçi dhe vizitorët e vet dhe çfarë -- si

1 flisnin ata kur nuk kishin asnjë arsye për të fshehur gjërat,  
2 pra, flisnin me zë normal, me ton normal për të diskutuar  
3 çështje të jetë së përditshme.

4 Por më vonë në të njëjtën vizitë, kur ata fillojnë që të  
5 përqendrohen tek ndërhyrja ndaj Dëshmitarit 4, Thaçi dhe  
6 vizitorët e vet e ndryshojnë volumin e zërit dhe fillojnë të  
7 pëshpëritin sërish.

8 Fragmenti në vijim, që është tre minuta, ju demonstroi  
9 saktësisht këtë që sapo thashë. Do i kërkoja Sekretares që të  
10 transmetojë fragmentin dhe të përfundojë në sekondën e 00:25  
11 për momentin.

12 [Luhet videoincizimi]

13 Z. HAFETZ: [Përkthim] Pavarësisht pëshpëritjes dhe përveç  
14 insistimit që bashkëbiseduesit të mos e thonin me emër  
15 personin për të cilin po flisnin, provat do të tregojnë që  
16 mënyra se si diskutohet tregohet që, në fakt, bashkëbiseduesit  
17 po diskutojnë për Dëshmitarin 4, një dëshmitar i mbrojtur dhe  
18 konfidencial në Çështjen 06. Dhe, veçanërisht, ata po  
19 diskutojnë për një pjesë të veçantë të dëshmisë që pritej që  
20 të jepte ky dëshmitar që Thaçi donte të ndryshohej.

21 Tani do të vazhdojmë me pjesën tjetër të këtij fragmenti  
22 deri në sekondën 00:52.

23 [Luhet videoincizimi]

24 Z. HAFETZ: [Përkthim] Në këtë fragment, z. Thaçi  
25 përshkruan procedurën e konsoliduar të Çështjes 06 që lidhet

1 me udhëtimin e dëshmitarëve drejt Hagës dhe rishikimin e  
2 deklaratave të tyre paraprake para se të jepnin dëshmi në  
3 sallën e gjyqit. Z. Kilaj iu ofruan që të merrte deklaratat  
4 konfidenciale të Dëshmitarit 4 për të cilin fliste Thaçi dhe  
5 t'ia dërgonte ato Dëshmitarit 4 për t'i transmetuar udhëzimet  
6 e Thaçit.

7 Por z. Thaçi dinte më shumë. Sikurse i shpjegoi Kilajt,  
8 nuk ishte e nevojshme që Kilaj t'i dërgonte të gjitha  
9 deklaratat e mëparshme Dëshmitarit 4 dhe t'i merrte të gjitha  
10 këto fletë të deklaratës nga objekti i paraburgimit, sepse  
11 ZPS-ja do ia jepte këtij dëshmitari dëshmitë e plota të tij.  
12 Më pas Thaçi vazhdon dhe shpjegon që ai kishte udhëzime më  
13 konkrete në mendje, kishte një plan më konkret në mendje.

14 Tani do kërkoj Sekretares që të transmetojë fragmentin  
15 deri në minutën 01:27.

16 [Luhet videoincizimi]

17 Z. HAFETZ: [Përkthim] Edhe pse me zë të ulët, urdhri i  
18 Thaçit është i qartë: Dëshmitari 4 duhet dhe këtu citoj "të  
19 korigjohë" dëshminë e tij të mëparshme, çka do të thotë që  
20 duhet të ndryshojë dëshminë e tij të mëparshme në favor të z.  
21 Thaçi, më konkretisht ai i referohet Pjesës 6, faqes 7 të  
22 intervistës konfidenciale me ZPS-në, dhe që dëshmitari duhej  
23 që ta bënte këtë ndryshim këtu në Hagë në seancën për  
24 përgatitjen e dëshmitarit me ZPS-në, përpara sesa të ulej në  
25 bankën e dëshmitarëve në këtë sallë gjyqi. Thaçi urdhëroi dhe

1 tha që kjo është faqja dhe pjesa që vizitorët e tij duhet të  
2 merrnin me vete në mënyrë të tillë që ta bënë punën që ju  
3 kishte kërkuar.

4 Dhe më pas duhej që të siguronin që nuk kishte asnjë lloj  
5 dyshimi për urdhrat e vet dhe nuk kishte asnjë hapësirë për  
6 gabim. Thaçi i bëri edhe më të qarta udhëzimet e veta.

7 I kërkoj Sekretares që të paraqesë klipin deri në minutën  
8 02:07.

9 [Luhet videoincizimi]

10 Z. HAFETZ: [Përkthim] Pjesa 6, faqja 7, deri tek rreshti  
11 konkret, specifik.

12 I nderuar Gjykatës, besoj se mund të dëgjoni shumë qartë,  
13 zhurmën e letrës që sapo e dëgjuam në këtë fragment. Pra,  
14 thuhet që Dëshmitari 4 duhet me e përmirësu dëshminë e tij.

15 Dhe në pjesën përfundimtare të këtij fragmenti që sapo  
16 dëgjuam, Thaçi e tha shumë qartë se çfarë mesazhi kishte  
17 lidhur me këtë dëshmitar.

18 Do i kërkoj Sekretares që të vazhdojë me pjesën tjetër të  
19 këtij klipi.

20 [Luhet videoincizimi]

21 Z. HAFETZ: [Përkthim] Thaçi dhe parashikon që çfarë,  
22 cilat janë pyetjet që do i bëjnë dëshmitarit gjykatësit.

23 Dhe nuk ka pikë dyshimi që pjesa e fundit e këtij  
24 fragmenti të incizuar është më e vështirë që të dëgjohet sepse  
25 z. Thaçi po flet me zë shumë të ulët. Por pavarësisht

1 përpjekjes për të fshehur atë që po thoshte, ai nuk ia arrin  
2 këtij qëllimi. Këtë do ta shikojmë gjithashtu edhe përmes  
3 provave që tregojnë që në pjesë të veçanta të deklaratave të  
4 mëparshme të Dëshmitarit 4 që Thaçi në mënyrë të vazhdueshme i  
5 ka përsëritur - përkatësisht pjesa 6, faqja 7 - ishin pjesët  
6 konkrete ku dëshmitarit i bëhen pyetje lidhur me përfshirjen e  
7 Thaçit në keqtrajtimet e pretenduara nga anëtarë të UÇK-së.

8 Me fjalë të tjera, ajo çfarë dëshironte Thaçi lidhur me  
9 Pjesën 6, faqen 7, ishte që të eliminoheshin provat  
10 përfshirjen personale të Thaçit në keqtrajtimin e pretenduar  
11 të dëshmitarëve.

12 Dhe, sërish edhe kësaj here, bëhet fjalë për dëshmi të  
13 cilat janë mbledhur jashtë objektit të paraburgimit që e  
14 provon këtë gjë përtej dyshimit të arsyeshëm.

15 Në këtë kuadër, në qoftë se do i referohemi datës 2  
16 nëntor 2023, më pak sesa një muaj pas vizitës së Kryeziut dhe  
17 të Kilajt për z. Thaçi, ZPS-ja zhvilloi një kontroll të  
18 autorizuar me urdhër gjyqësor në banesën e Kilajt në Kosovë.  
19 Gjatë këtij kontrolli, ZPS-ja sekuestroi copa letre të grisura  
20 nga një qese mbeturinash që ishte lënë në hyrje të banesës së  
21 z. Kilaj. Mund ta shikojmë këtë në provën materiale të ZPS-së  
22 P00123, pra, sikurse e shikoni, kjo qese është e mbushur me  
23 letra të grisura.

24 Ekspertët forensikë i kanë bashkuar këto copat e grisura  
25 të letrës dhe rezultatet tregojnë që Kilaj kishte grisur dhe

1 kishte hedhur në kosh mbeturinash jo copa letrash rastësore  
2 por letra të grisura të dy deklaratave të mëparshme  
3 konfidenciale të Dëshmitarit 4.

4 Një prej letrave të grisura mund ta shikoni në ekran dhe  
5 kjo ka numrin P3 të provës materiale të ZPS-së. Kjo është  
6 pikërisht Pjesa 6, faqja 7 e dëshmisë paraprake të Dëshmitarit  
7 4 dhe ndërkohë e kemi dhënë të paqartë, nuk mund ta lexoni  
8 sepse mbetet një dokument konfidencial. Ndërkohë që versioni i  
9 plotë i deklaratës së Dëshmitarit 4 të ZPS-së i është nxjerrë  
10 Thaçit në Çështjen 06 përpara vizitës së 6 tetorit.

11 Pjesë e dokumentit të sekuestruar nga Kilaj është  
12 ekzaktësisht e njëjta pjesë dhe i njëjti numër faqeje që Thaçi  
13 tha që dëshmitari duhet ta ndryshonte, pra, që ia kërkoi  
14 Kilajt gjatë vizitës që ky i fundit i bëri z. Thaçi. Dokumenti  
15 i grisur i sekuestruar nga Kilaj ka madje edhe pjesë të  
16 nënvijëzuara, ka edhe shënime me dorë në pjesët konkrete për  
17 të cilat Thaçi kërkoi në mënyrë të vazhdueshme që Dëshmitari 4  
18 duhej që të ndryshonte dëshminë e vet. I nderuar Gjykatës,  
19 këtu përfshihet dhe një kuti e bërë me shkrim dore lidhur me  
20 pyetjet dhe përgjigjet që fillojnë në rreshtin 9, Pjesa 6,  
21 faqja 7. Kjo është pjesa që ka të bëjë me identifikimin  
22 paraprak të dëshmitarit të z. Thaçi, pra, identifikimin që i  
23 ka bërë dëshmitari z. Thaçi.

24 Dhe kjo nuk është e gjitha, sepse ZPS-ja ka marrë  
25 gjithashtu, përmes urdhrorit gjyqësor, incizime dhe të dhëna nga

1 qendra e paraburgimit dhe nga printimet dhe kompjuteri i z.  
2 Thaçi. Të gjithë këto dokumente janë shqyrtuar nga një  
3 eksperte e pavarur përpara sesa t'i jepeshin ZPS-së. Asnjë  
4 prej këtyre dokumenteve nuk është i mbuluar nga privilegji  
5 ligjor. Dhe këto dokumente tregojnë se Thaçi ka printuar të  
6 njëjtën pjesë konfidenciale të deklaratës së Dëshmitarit 4  
7 vetëm dy ditë përpara sesa të përdorte atë gjatë vizitës me z.  
8 Kilaj dhe z. Kryeziu. Këtë mund ta shikoni në provën materiale  
9 të ZPS-së P00128.

10 Provat tregojnë gjithashtu që Thaçi ka printuar edhe  
11 dokumente të tjera të lidhura me Dëshmitarin 4 menjëherë  
12 përpara vizitës së 6 tetorit me Kilajn dhe Kryeziun, përfshirë  
13 këtu edhe një dokument tjetër që është gjetur i grisur në  
14 qesen e mbeturinave të Kilajt. Për referencë të mëtejshme mund  
15 t'i referohemi provës P00133 të ZPS-së.

16 Me fjalë të tjera, i nderuar Gjykatës, provat mblidhen me  
17 njëra-tjetrën për të treguar që pëshpërimat e Thaçit në  
18 audioincizim pra, nuk janë të vetme si prova po janë prova të  
19 cilat mbështeten dhe konfirmohen nga prova të tjera fizike dhe  
20 elektronike. Kjo tregon organizimin, planifikimin dhe hapat  
21 konkretë që i akuzuari ka ndërmarrë në përpjekje për të  
22 penguar procedurat dhe për të ndërhyrë me dëshmitarë që  
23 dëshmonin, në mënyrë të tillë, që dëshmitë e tyre të  
24 ndryshoheshin për t'i shërbyer z. Thaçi.

25 Do marr një tjetër shembull për t'ju treguar se si

1 funksiononte ky plan.

2 Sikurse thuhet në aktakuzë, Grupi i Smakajt i akuzuar në  
3 këtë çështje gjyqësore kanë bërë dy vizita, një të vizitë e  
4 kanë bërë në shtator dhe një në tetor të 2023. Gjatë të dyja  
5 vizitave, Thaçi ka përmendur në mënyrë të vazhdueshme Bislam  
6 Zyrapin për ndërhyrje. Këtë e trajtova pak më herët. Këtu  
7 përfshihej recitimi i gjatë i Thaçit lidhur me pika specifike  
8 të Zyrapit dhe sqarimet që ai kërkonte që të bënte Zyrapin në  
9 mënyrë të tillë që të minimizonte rolin dhe llogaridhënie,  
10 përgjegjësinë e z. Thaçi. Kjo përfshinte faktin që Shtabi i  
11 Përgjithshëm përbëhej vetëm prej gjashtë personave deri në  
12 nëntor të 1998-s, duke përjashtuar Thaçin, që Thaçi kishte  
13 qenë jashtë Kosove në periudhën nga nëntori i 1998-s deri në  
14 mars të 1999-s dhe, që në përgjithësi, ai të përqendrohej tek  
15 komandantët e zonave dhe Adem Demaçin.

16 Gjatë vizitës së 7 tetorit, Thaçi dhe vizituesit e tij  
17 kanë përdorur një taktikë tjetër, përveç pëshpëritjes së  
18 zakonshme, në mënyrë të tillë që të mos merrej vesh se çfarë  
19 po diskutonin dhe çfarë udhëzimesh jepeshin për dëshmitarët.  
20 Kësaj here, përpara sesa të fillonim që të flisnim me Smakajn  
21 lidhur me Zyrapin, Thaçi i tregoi Artan Behramit që "të fliste  
22 më me zë të lartë" në mënyrë të tillë që të mos diktohej dhe  
23 të mos merrej vesh se çfarë po pëshpëriste z. Thaçi. Behrami e  
24 bëri këtë gjë, ndërkohë që filloi që të fliste në zë  
25 natyrshëm. Smakaj i raportoi Thaçit që ai kishte qenë në

1 kontakt me Zyrapin, e tha "përshëndetje". Këto mund t'i  
2 shihni, pra, të gjitha këto që unë sapo ju shpjegova mund t'i  
3 shikoni në këtë fragment të video-incizimit.

4 [Luhet videoincizimi]

5 Z. HAFETZ: [Përkthim] Edhe këtu, provat e mbledhura  
6 jashtë objektit të paraburgimit përkojnë me atë se çfarë është  
7 thënë në pëshpëritje brenda objektit të paraburgimit. Më  
8 konkretisht, prova materiale e ZPS-së me numër ERN 125731, që  
9 e patë, përmban informacione të cilat janë marrë prej  
10 telefonit celular të Smakajt. Dokumentacioni tregon që më  
11 datën 2 dhe 3 tetor 2023, Smakaj dhe Zyrapin kanë qenë në  
12 kontakt, ashtu sikurse Smakaj do i thoshte Thaçit disa ditë më  
13 pas.

14 Dhe në fragmentin e shkurtër që do të dëgjojmë tani të  
15 vizitës së 7 tetorit, sikurse bëri dhe në rastin e grupit të  
16 Kilajt kur e vizituan atëherë, Thaçi përdori dokumente për t'u  
17 siguruar që udhëzimet për ndërhyrjen ndaj dëshmitarëve të  
18 ndiqeshin nga vizitorët.

19 Atëherë, vazhdojmë me klipin e radhës të cilin e kam  
20 marrë nga prova materiale e ZPS-së P00110.

21 [Luhet videoincizimi]

22 Z. HAFETZ: [Përkthim] Vetëm tri javë pasi Smakaj dhe  
23 Thaçi diskutojnë, duke shkëmbyer letra në shkelje të  
24 rregullores së objektit të paraburgimit, një prej personave  
25 për të cilin ata flasin është Bislim Zyrapin. Ndërkohë që

1 dokumenti për të cilin diskutohet është dokumenti që është  
2 sekuestruar nga makina, automjeti i z. Smakaj.

3 Dy faqet e dokumentit mund t'i shikoni edhe këtu që janë  
4 dokumenti P00125, që është provë e pranuar e ZPS-së.

5 Pra, në këtë dokument janë të nënvijëzuara aspektet të  
6 cilat përmbajnë një narrativë që ulin rolin ose minimizojnë  
7 rolin e lidërshipt të z. Thaçi në UÇK, ndërkohë që i kalohet  
8 përgjegjësia aktorëve të tjerë në mënyrë të tillë që të  
9 eliminohet dhe minimizohet përgjegjësia e z. Thaçi për krimet  
10 e ngritura në aktakuzë në Çështjen 06. Narrativa nga ky  
11 dokument i cili është marrë nga automjeti i z. Smakaj është  
12 synuar që të shërbente për të ndërhyrë me dëshmitarët me  
13 persona me dëshmitarë të brendshëm të UÇK-së, duke përfshirë  
14 këtu edhe Bislim Zyrabin.

15 I nderuar Gjykatës, ndërmjet të tjerash edhe kjo është e  
16 qartë se këto "B" që janë të shkruara me shkrim dore i  
17 referohen konkretisht z. Zyrapit dhe dëshmisë që pritej prej  
18 tij.

19 Është gjithashtu e qartë nga fakti që disa prej pjesëve  
20 të dokumenteve përkojnë me udhëzimet e dhëna me gojë nga z.  
21 Thaçi për "Bisën" dhe me "Bis", ai i referohet Bislim Zyrapit  
22 gjatë vizitës së incizuar të 7 tetorit. Për shembull, këtë  
23 mund ta vini re dhe duke krahasuar transkriptin e kësaj vizite  
24 me tekstin e dokumentit që i është sekuestruar Smakajt sikurse  
25 mund ta shikonit këtu dhe që është i regjistruar si prova

1 materiale e ZPS-së me numër P00110\_AT dhe \_ET dhe prova  
2 materiale e ZPS-së P00125.

3 Vetëm kjo faqe e dokumentit të Smakajt, që e shikoni në  
4 diapozitiv, përmban shumë gjëra të ngjashme me udhëzimet e  
5 dhëna nga z. Thaçi për grupin e Smakajt se si duhej që të  
6 jepte dëshmi Zyrapi, përfshirë faktin që Shtabi i Përgjithshëm  
7 përbëhej vetëm nga gjashtë persona - tri anëtarë në Kosovë,  
8 duke përfshirë dy studentë letërsie dhe tre anëtarë që ishin  
9 jashtë Kosove.

10 Ka edhe shumë përkime të tjera të cilat janë dokumente të  
11 pranuar në prova dhe disa prej këtyre përkimeve janë fjalë  
12 për fjalë të njëjta.

13 Provat do të tregojnë gjithashtu se i njëjti dokument i  
14 sekuestruar nga Smakaj pa këto *highlighting* dhe pa shkrimin  
15 me dorë është gjetur në kompjuterin e z. Thaçi në objektin e  
16 paraburgimit me titullin "për avokatët". Pra, është e njëjta  
17 dosje, i njëjti dokument i cili është printuar në objektin e  
18 paraburgimit vetëm disa orë përpara sesa Smakaj dhe Behrami të  
19 vizitonin Thaçin më datën 7 tetor. Këtu mund të shikoni provën  
20 e Prokurorisë P00128, ku bëhet fjalë për dokumentin që unë  
21 sapo shpjegova.

22 Për të qenë të qartë, z. Smakaj nuk është - nuk ka qenë  
23 asnjëherë - avokat i Çështjes 06 apo anëtar i ekipit mbrojtës  
24 të z. Thaçi në Çështjen 06. Të marra së bashku, këto prova  
25 tregojnë që Thaçi ishte organizuar dhe i përgatitur për

1 vizitën e 7 tetorit në mënyrë të tillë që ai të jepte udhëzime  
2 sa i takon dëshmisë së z. Zyrapit, dhe t'i kërkonte grupit të  
3 Smakajt që t'i transmetonin këto komente të z. Zyrapit.

4 Dhe, së fundi, printeri i përdorur për të printuar  
5 dokumentin e sekuestruar nga automjeti i z. Smakaj është i  
6 njëjti i përdorur nga z. Thaçi për të printuar dokumentet  
7 konfidenciale që z. Thaçi ka përdorur me vizitorët e tij sa i  
8 takon Dëshmitarit 4. Këtë mund ta shikoni në provën 128.

9 Provat në këtë çështje gjyqësore, i nderuar Gjykatës,  
10 janë të shumta dhe janë konfirmuese ndaj njëra-tjetrës. Ato  
11 janë pjesë të së njëjtit qëndrim që z. Thaçi ishte drejtuesi  
12 dhe organizatori i disa përpjekjeve për të penguar dhe për të  
13 ndërhyrë me dëshmitarët në Çështjen 06.

14 Të marra së bashku, provat do të provojnë që z. Thaçi,  
15 z. Kilaj, z. Smakaj, Fazliu dhe z. Kuqi janë secili prej tyre  
16 fajtorë përtej dyshimit të arsyeshëm për veprat e ngritura në  
17 aktakuzë ndaj tyre.

18 Z. Hicks, kolegu im, O'Connell do të flasë lidhur me  
19 bazën ligjore të zbatueshme në këtë rast.

20 Z. HICKS: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës.  
21 Mirëdita, të nderuar kolegë.

22 Tani besoj që e dëgjuam të gjithë se cili ishte historiku  
23 i procesit gjyqësor dhe, në veçanti, se cila ishte baza  
24 ligjore për sa i takon ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve. Ne të  
25 gjithë e dëgjuam se cila është baza e kësaj çështjeje

1 gjyqësore, se si z. Thaçi përzgjedhi persona për ta ndihmuar  
2 ata për të ndërhyrë me dëshmitarë në Çështjen 06. Dhe juve po  
3 ashtu keni parë dhe dëgjuat në përmbledhjen se disa prej  
4 provave janë të mbivendosura me njëra-tjetrën dhe konfirmojnë  
5 njëra-tjetrën dhe këto prova gjithashtu kanë të bëjnë jo vetëm  
6 me qendrën e paraburgimit, por edhe në vende të tjera.

7 Unë tani do merrem me bazën ligjore që shërben si  
8 justifikim për akuzat e ngritura në aktakuzë. Veprat penale  
9 dhe forma e përgjegjësisë penale lidhen individualisht me  
10 veprimet dhe rrethanat e secilit prej të akuzuarve. Të gjitha  
11 akuzat bien në tri kategori veprash penale. Së pari, pengim i  
12 personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, së dyti,  
13 shkelje e sekretit të procedurave dhe, së treti, kundërshtimi  
14 i Gjykatës.

15 Katër nga të akuzuarit - përkatësisht Thaçi, Smakaj,  
16 Kilaj dhe Fazliu - janë akuzuar me pengim të drejtësisë. Thaçi  
17 është i vetmi i akuzuar që është akuzuar për shkelje të  
18 sekretit të procedurës. Së fundi, të pestë të akuzuarit janë  
19 akuzuar për kundërshtim të Gjykatës.

20 Atëherë do filloj së pari me pengimin e drejtësisë. Kjo  
21 vepër penale buron nga neni 401, paragrafi 2 i Kodit Penal të  
22 Kosovës, që parashikon që çdo person që merr pjesë në një grup  
23 personash të cilët përmes veprimit të përbashkët pengojnë ose  
24 mundohen të pengojnë një person zyrtar që të kryejë vepra  
25 zyrtare dënohet. Në këtë rast, baza e akuzave për pengim nën

1 nenin 401(2) del prej tre grupeve të veçanta.

2 Sikurse është shpjeguar, së pari kemi Grupin e Fazliut që  
3 përfshin Thaçin si liderin e grupit, Fazliun dhe djalën e tij  
4 Fahriun, së dyti, Grupi i Smakaj që përfshin Thaçin si lider i  
5 grupit, Smakajn, Blerim Shalën dhe Artan Behramin dhe, së  
6 fundi, Grupin e Kilajt, përsëri duke përfshirë Thaçin si  
7 liderin e grupit, Kilajn dhe Vllaznim Kryeziun.

8 Secili prej këtyre grupeve ka një pikë në aktakuzë për të  
9 akuzuarit që ka të bëjë me pengimin e drejtësisë në Çështjen  
10 06 duke u përpjekur që të ndërhyjnë ndaj dëshmitarëve të  
11 Prokurorisë.

12 Neni 401 ka dy dispozita të tjera që lidhen me akuzat në  
13 këtë çështje konkrete. Dhe këto janë nënparagrafët 3 dhe 5.  
14 Këto dy dispozita janë të përqendruara në aspekte të cilat  
15 rëndojnë ose zgjerojnë pretendimin për pengim të një personi  
16 të akuzuar.

17 Më konkretisht, neni 401(3) deklaron se një drejtues ose  
18 organizator i një grupi që kryen pengim të synuar është i  
19 dënueshëm me burgim nga një deri në pesë vjet. Kjo dispozitë  
20 zbatohet për Thaçin dhe ai akuzohet me një pikë për secilën  
21 prej tre grupeve ku ka marrë pjesë dhe drejtues i të cilëve ka  
22 qenë.

23 Përveç kësaj dhe për nenin 401(5), kur bëhet fjalë për  
24 pengim dhe kur pengimi i synuar kryhet ndaj një gjyqtari,  
25 prokurori ose një zyrtari të gjykatës, prokurori ose një

1 personi të autorizuar nga gjykata ose zyra e prokurorisë,  
2 gjatë ushtrimit të funksionit të tyre zyrtare, autori i veprës  
3 duhet të dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

4 Ky faktor rëndues zbatohet për secilin prej anëtarëve të  
5 akuzuar të tri grupeve - domethënë, për Taçin, Smakajn, Kilajn  
6 dhe Fazliun - sepse veprimet e tyre synoheshin që të  
7 komprometonin aftësinë e DHSK-së dhe të ZPS-së për të hetuar  
8 në mënyrë efektive dhe për ndjekur penalisht krime, në  
9 veçanti, për të siguruar dhe për të marrë dëshmitë relevante  
10 dh të vërteta të dëshmitarëve.

11 Thelbi i këtyre akuzave, që të gjithë kanë edhe masa  
12 dënimi më të mëdha, është se fajësia në një pikë të aktakuzës  
13 për secilin prej të akuzuarve parashikon një masë dënimi prej  
14 një viti minimum dhe pesë maksimum.

15 Që veprimet e tre grupeve të akuzuara janë përpjekur që  
16 të pengojnë një person zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare  
17 është i qartë, siç është afirmuar edhe në vendimin e  
18 konfirmimit të kësaj çështjeje, përpjekjet për të ndikuar në  
19 mënyrë të paligjshme mbi dëshminë e dëshmitarëve të ZPS-së  
20 mund të komprometojnë dëshmi e cila mund të mos shfrytëzohet  
21 më në gjykim, mund të çojë në shkarkimin apo në dëmtimin e  
22 dëshmitarëve dhe mund të ndikojë në integritetin e procesit  
23 para DHSK-së. Që të gjitha këto përfundime pengojnë punën e  
24 personelit të ZPS-së, përfshirë të hetuesve dhe prokurorëve,  
25 si dhe të gjykatësve të DHSK-së.

1 Veprimet e ndërmarra nga anëtarët e grupit, të cilat  
2 vërtetohen përmes provave të kësaj çështjeje gjyqësore, ishin  
3 thelbësore, konkrete dhe specifike.

4 Nuk ka nevojë që të arrihet sukses në kontaktimin dhe  
5 ndikimin me dëshmitarët. Të akuzuarit nuk janë akuzuar për  
6 këtë çështje. Ajo për të cilën janë akuzuar janë përpjekjet  
7 dhe përpjekjet janë kriminale. Ky është ligji, synimi i të  
8 cilit është që të mbrojë funksionimin e një sistemi të  
9 efektshëm ligjor duke mos penguar zyrtarët në kryerjen e  
10 detyrave zyrtare dhe duke i mbrojtur ata nga përpjekjet për të  
11 minuar drejtësinë. Neni 401(2) shprehimisht e kriminalizon  
12 përpjekjen për pengim në të njëjtën mënyrë si pengimin në  
13 vetvete, si pengimin e realizuar apo të ekzekutuar për shkak  
14 se kështu është parashikuar me ligjin e shkruar.

15 Megjithëkëtë, është e rëndësishme të nënvijëzohet që ka  
16 patur kontakte mes disa anëtarëve të grupeve dhe dëshmitarëve  
17 të shënjestruar para dhe pas vizitave të përmendura në  
18 aktakuzë. Dhe deduksioni i arsyeshëm, që nuk është i  
19 domosdoshëm për të vërtetuar fajësinë lidhur me përpjekjet për  
20 pengim, është se këto kontakte, në fakt, ishin në vijimësi të  
21 realizimit të planit të përbashkët. Kolegu im ka dhënë shembuj  
22 mbi këtë tashmë.

23 Provat në tërësi tregojnë se anëtarët e secilit prej  
24 grupeve të Fazliut, Smakajt dhe Kilajt - që të gjithë të  
25 udhëhequr apo të drejtuar nga Thaçi - morën pjesë në mënyrë të

1 qëllimshme në një grup, synimi i të cilit ishte përpjekja për  
2 të penguar dëshmitarët e shënjestrur të Çështjes 06. Në fakt,  
3 nuk ka asnjë dyshim se të akuzuarit kanë pasur dijeni mbi atë  
4 që po bënin dhe e dinin që bëhej fjalë për vepre penale. Për  
5 shembull, shihni paralajmërimin që Thaçi i dha Fazliut  
6 shprehimisht për shfrytëzuar një ndërmjetës për të kontaktuar  
7 Rrustem Mustafën dhe zbatimin e këtij udhëzimi nga ana e  
8 Fazliut. Analizoni vizitën e 6 tetorit, kur Thaçi e këshilloi  
9 Kilajn dhe Kryeziun se, në qoftë se nuk tregohen të  
10 kujdesshëm, "do t'ju sjellin edhe juve këtu që të jeni bashkë  
11 me mua". Dhe Kilaj përgjigjet, "Nuk ka rëndësi edhe mund të  
12 qëndroj këtu për nja dy vjet, nja dy vjet". Analizoni vizitën  
13 e 7 tetorit, kur Behrami lexoi rregulloren e paraburgimit me  
14 zë të lartë dhe në praninë e Smakajt, e cila përcakton që  
15 vizitorëve nuk u lejohet që të shkëmbejnë artikuj me të  
16 paraburgosurit ndërkohë që prisnin arritjen e Thaçit.

17 Dhe, përfundimisht, anëtarët e grupit që të gjithë  
18 ndërmorën veprime të cilat i kanë kontribuar synimit të  
19 pengimit të zyrtarëve të DHSK-së dhe ZPS-së në proceset  
20 gjyqësore para kësaj Gjykate. Kërkesat ligjore për pikat e  
21 aktakuzës që kanë të bëjnë me pengimin realizohen në rastin  
22 Thaçit, Fazliut, Smakajt dhe Kilajt.

23 Këtu përfundon pjesa që ka të bëjë me përpjekjet për  
24 pengesë, dhe kolegja ime tani do të flasë lidhur me pikat e  
25 tjera të aktakuzës.

1 ZNJ. O'CONNELL: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës,  
2 kolegë në këtë sallë gjyqi. Jam Claire O'Connell në emër të  
3 ZPS-së po flas.

4 Po kaloj tek vepra penale e dhunimit të sekretit të  
5 procesit në bazë të neneve 392(1) dhe 392(2) të KPK-së. Vetëm  
6 Thaçi është i akuzuar me këtë vepër penale në pikat 4, 5, 6  
7 dhe 7 të aktakuzës.

8 Sipas nenit 392 të KPK-së, kushdo që pa autorizim zbulon  
9 informata për të cilat është i njoftuar në procedurën zyrtare  
10 që sipas ligjit nuk mund të zbulohen apo informatat që janë  
11 shpallur si fshehtësi me vendim të Gjykatës apo të organeve  
12 kompetente dënohet. Përndryshe, 392(2) i KPK-së thotë një  
13 person i cili, pa autorizim, zbulon të dhëna për identitetin  
14 apo të dhënat personale të personit të mbrojtur në procedurë  
15 penale dënohet. Nxjerrja e paligjshme e informacionit mund të  
16 përfshijë shpërndarjen e materialit në origjinal apo të  
17 kopjuar, citimin, përshkrimin apo referencën ndaj përmbajtjes  
18 së një materiali dhe dhënien e këtij materiali personave të  
19 tjerë me qëllim që t'u lejohet atyre që ta lexojnë apo ta  
20 kopjojnë materialin me qëllim që të shfrytëzojnë përmbajtjen e  
21 tij.

22 Katër pikat e shkeljes së sekretit të procesit me të  
23 cilat akuzohet Thaçi burojnë nga nxjerrja e informacionit  
24 konfidencial dhe identitetit të të dhënave personale të një  
25 personi të mbrojtur, i cili nuk ishte i autorizuar dhe kjo i

1 është dhënë anëtarëve të grupeve gjatë 2 korrikut, 9  
2 shtatorit, gjatë vizitave të 2 korrikut, 9 shtatorit, 6  
3 tetorit dhe 7 tetorit.

4 Informacioni që i ka dhënë Thaçi gjatë vizitave të këtyre  
5 grupeve ishte i klasifikuar si konfidencial në parashtrimet e  
6 protokolluara të DHSK-së. Këto dokumente përfshijnë dëshmitarë  
7 të ZPS-së në Çështjen 06 dhe masat mbrojtëse të lëshuara sipas  
8 vendimit të Trupit Gjykses të Çështjes 06. Thaçi, po kështu,  
9 mori dhe nxori në mënyrë të paligjshme dhe përmbajtjen e  
10 provave konfidenciale siç ishte nxjerrë nga ZPS-ja për këto  
11 grupe, për këto vizita të grupeve.

12 Siç është diskutuar më herët, informacioni konfidencial  
13 që i është nxjerrë Thaçit përfshinte emrat dhe dëshminë e  
14 pritshme të dëshmitarëve të Çështjes 06, kohën e paraqitjes së  
15 tyre për të dhënë dëshmi para Trupit Gjykses, hollësitë e  
16 provave që ishin dhënë në seancat private para DHSK-së,  
17 informacione personale biografike të dëshmitarëve që nuk ishte  
18 i publikuar dhe më shumë informacionet e tjera.

19 Thaçi nuk është autorizuar nga ZPS-ja apo kuadri ligjor i  
20 DHSK-së për t'u nxjerrë dëshmitarëve informacion sekret, pikë.  
21 Që e bëri një gjë të tillë Thaçi me synimin e pengimit të  
22 dëshmisë së dëshmitarëve në Çështjen 06 për të minimizuar  
23 përgjegjësinë e tij penale në atë proces gjyqësor duhet të  
24 shfrytëzohet si faktor rëndues. Shkelja e sekretit të procesit  
25 të Çështjes 06 nuk ishte aksidentale apo një shkarje

1 rastësore. Në fakt, nxjerrjet nga ana e Thaçit ishin të  
2 përsëritura dhe të synimshme dhe të bërë me dijeninë e plotë  
3 se veprimet e tija ishin tejet të paligjshme.

4 Si palë e procesit të Çështjes 06, Thaçi ka patur dijeni  
5 mbi detyrimet që i ka patur për t'i trajtuar informacionet  
6 konfidenciale dhe statusin e dëshmitarëve të mbrojtur me  
7 kujdes dhe me kujdes të madh. Thaçit iu kujtua ky detyrim jo  
8 vetëm përmes parashtrimeve të protokolluara dhe klasifikimit  
9 të provave që kishte marrë, por edhe, për shembull, në fillim  
10 të paraqitjes së çështjes së ZPS-së në Çështjen gjyqësore 06  
11 më 11 prill 2023, kur Kryegjykatësi e nënvijëzojë këtë detyrim  
12 dhe deklaroi si më poshtë:

13 "Trupi Gjygues ju kujton palëve dhe pjesëmarrësve lidhur  
14 me detyrimin që kanë, që gjatë gjithë kohës që paraqesin  
15 prova, të marrin parasysh masat mbrojtëse të urdhëruara."

16 Dhe vazhdoi:

17 "Për më tej, Trupi Gjygues vëren se lista e dëshmitarëve  
18 të ZPS-së aktualisht është e klasifikuar si konfidenciale. Për  
19 rrjedhojë, fakti që një individ është një dëshmitar i mundshëm  
20 i ZPS-së është informacion konfidencial edhe nëse një individ  
21 i tillë nuk është dëshmitar i mbrojtur."

22 Megjithëkëtë, pavarësisht se ky kuadër ligjor është i  
23 qartë dhe ndalon nxjerrjen e informacionit konfidencial, Thaçi  
24 në mënyrë të përsëritur dhe të synimshme e ka shkelur sekretin  
25 e procesit të Çështjes 06. Sjellja e Thaçit përmbush në këtë

1 mënyrë standardin ligjor për tre pikat e aktakuzës sipas nenit  
2 392(1) të KPK-së dhe për një prej pikave të aktakuzës sipas  
3 Nenit 392(2).

4 Në fund, mosbindja ndaj gjykatës.

5 Të pestë të akuzuarit akuzohen me mosbindje ndaj  
6 gjykatës, Thaçi sipas pikave 8 deri në 11, Smakaj sipas pikës  
7 13, Kilaj sipas pikës 15, Fazliu sipas pikës 17 dhe Kuçi sipas  
8 pikave 18 dhe 19.

9 Neni 393 i KPK-së parashikon se kushdo që nuk i bindet  
10 ndonjë urdhri, vendimi apo aktgjykimi të ndonjë gjykate  
11 dënohet.

12 Për Thaçin dhe Kuçin, akuzat e mosbindjes në këtë çështje  
13 gjyqësore burojnë nga protokoll i Çështjes 06, vendim i  
14 nxjerrë nga Trupi Gjykses i Çështjes 06 që ka të bëjë lidhur  
15 me trajtimin e informacionit konfidencial nga ana e palëve dhe  
16 pjesëmarrësve të asaj çështjeje gjyqësore. Gjatë të gjithë  
17 kohës Thaçi ishte i akuzuar në Çështjen gjyqësore 06, ndërkohë  
18 që Kuçi ishte anëtar i ekipit mbrojtës të Veselit. Vlen të  
19 shënohet, se ky protokoll zbatohet për të gjitha kontaktet me  
20 dëshmitarët e një pale kundërshtare, përfshirë edhe pas  
21 dhënies së dëshmisë nga ana e tyre. Ky protokoll, i cili është  
22 apeluar dhe është mbështetur, ky mbetet dhe një vendim  
23 përfundimtar i formës së rreptë. Dhe protokoll i Çështjes 06  
24 i ka ndaluar një pale apo pjesëmarrës të Çështjes 06, që t'i  
25 japë informacion konfidencial palëve të treta, me përjashtim

1 të rastit kur kjo ishte rreptësishtë e domosdoshme dhe kur  
2 përmbusheshin kushte të rrepta, nxjerrjen për palë të treta të  
3 përfshirjes së ndonjë dëshmitari të mbrojtur të DHSK-së apo  
4 ZPS-së dhe, që të kontaktojnë dëshmitarët e palës kundërshtare  
5 jashtë kuadrit të zbatueshëm.

6 Sa i përket Thaçit, ai ka kryer mosbindjen e gjykatës në  
7 pikat 8, 10 dhe 11 duke shkelur protokollin e Çështjes 06.  
8 Këtë e ka bërë duke i dhënë detyra të bashkakuzuarve që të  
9 kontaktonin dëshmitarët jashtë këtij protokolli dhe duke  
10 nxjerrë në mënyrë të vazhdueshme informacion konfidencial  
11 lidhur me dëshmitarët për vizitorët e tij gjatë vizitave të 2  
12 korrikut, 9 shtatorit, 6 tetorit dhe 7 tetorit. Dhe ky model i  
13 moszbatimit të protokollit të Çështjes 06 nuk ishte i  
14 domosdoshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e argumenteve të  
15 Thaçit atje. Por, mosbindjen ndaj gjykatës ishte pjesë e një  
16 skeme nga ana e të akuzuarve për të ndërhyrë në Çështjen 6  
17 përfshirë edhe përmes udhëzimeve të qarta dhe të përsëritura  
18 që Thaçi iu dha anëtarëve të grupeve që të kontaktonin  
19 dëshmitarët duke i shfrytëzuar ata si ndërmjetës për  
20 përpjekjen e tij për pengim.

21 Ngjashëm, siç parashikohet në pikën 9, Thaçi ra dakord me  
22 Kuçin që të mosbindeshin ndaj gjykatës, kur me udhëzimi e  
23 Thaçit, ata ranë dakord që Kuçi do takonte dëshmitarët e ZPS-  
24 së jashtë kuadrit të protokollit të Çështjes 06 dhe Kuçi mori  
25 masa thelbësore për ta zbatuar këtë marrëveshje të arritur.

1 Siç është e vërtetë me të gjitha krimet e aktakuzës,  
2 synimi i Thaçit është i qartë edhe nga veprimet edhe nga  
3 mënyra si i kanë ndërmarrë ato veprime dhe ia vlen të shënohet  
4 që pëshpëritjet dhe zëri i ulët i vazhdueshëm kur ata  
5 diskutonin informacione konfidenciale, përbën shkelje të  
6 drejtpërdrejtë të protokollit të Çështjes 06. Synimi i  
7 mosbindjes duket qartë edhe në përpjekjen për t'i kontaktuar  
8 dëshmitarët në mënyrë sekrete dhe kjo është në shkelje të  
9 protokollit të Çështjes 06 dhe kjo bëhej me shpresën që të mos  
10 kapeshin.

11 Në të njëjtët kohë, sipas pikës 18, Kuçi ra dakord me  
12 Thaçin që të kryenin shkelje, mosbindje ndaj gjykatës përmes  
13 marrëveshjes së pajtimit të tyre për të kontaktuar dëshmitarët  
14 jashtë kuadrit të protokollit të Çështjes 06 dhe kjo  
15 marrëveshje përfshinte akte për të zbatuar si, për shembull,  
16 nismën e Kuçit me qëllim që të takonte të paktën një dëshmitar  
17 të shënjestruar pas kthimit të tij në Kosovë dhe kjo u ra  
18 dakord pas vizitës së 3 shtatorit. Më tej, Kuçi ra dakord që  
19 t'i shkruante udhëzimet e Thaçit gjatë vizitës së tyre, dha  
20 sugjerimet e tij se çfarë duhet të thonin dëshmitarët e  
21 shënjestruar të Çështjes 06 dhe shkoi deri atje sa të thoshte  
22 që e kishte biseduar me një a më shumë dëshmitarë.

23 Edhe në këtë rast, si dhe në pikat e krimeve të  
24 aktakuzës, përpjekjet e Kuçit dhe të Thaçit për të fshehur  
25 marrëveshjen për të mos iu bindur gjykatës përmes

1 pëshpëritjeve gjatë vizitës së 3 shtatorit përcakton apo  
2 vërteton se e dinin që bëhej fjalë për sjellje të ndaluar  
3 sipas protokollit të Çështjes 06.

4 Në mënyrë të ngjashme Kuçi kreu veprimin e mosbindjes  
5 ndaj gjykatës përmes shkeljes së qartë dhe të synimshme të  
6 protokollit të Çështjes 06, siç parashikohet në pikën 19. Në  
7 mënyrë specifike, kontakti i drejtpërdrejtë i Kuçit me një  
8 dëshmitar të Çështjes 06 më 12 prill të 2023, në shkelje të  
9 protokollit të Çështjes 06 çoi në kryerjen e veprës penale të  
10 mosbindjes. Dhe ky kontakt është i qartë dhe i padiskutueshëm.  
11 Më tej, fakti se Kuçi, avokat i trajnuar dhe në atë kohë edhe  
12 anëtar i ekipit mbrojtës të Çështjes 06 e dinte se kjo  
13 sjellje, nuk mund të dyshohet se kjo sjellje ishte bërë në  
14 dijeni se ishte shkelje e protokollit të Çështjes 06.

15 Në fund, sa i përket pikave 13, 15 dhe 17 të aktakuzës me  
16 cilën akuzohen me mosbindje ndaj gjykatës Smakaj, Kilaj dhe  
17 Fazliu. Moda e përgjegjësisë për këto është ndihmesa, që të  
18 tre këta të akuzuar i kanë dhënë ndihmesën e tij Thaçit për  
19 kryerjen e veprës për mosbindje ndaj gjykatës. Neni 33 i KPK-  
20 së parashikon që ndihma për kryerjen e një vepre penale  
21 përfshin krijimin e kushteve apo heqjen e pengesave për  
22 kryerjen e një vepre penale.

23 Është e rëndësishme të theksohet, se Smakaj, Kilaj dhe  
24 Fazliu që të gjithë nënshkruan një marrëveshje si vizitorë me  
25 të cilën ranë dakord që të mos nxjerrin asnjë informacion i

1 cili mund të komprometonte administrimin e drejtësisë ose  
2 përndryshe të minonte autoritetin dhe mandatin e DHSK-së. Ky  
3 fakt vërteton se ata kanë pasur dijeni të plotë lidhur me  
4 llojin e sjelljes që ndalohej në objektin e paraburgimit të  
5 DHSK-së.

6 Për pasojë dhe ndërkohë që Smakaj, Kilaj dhe Fazliu nuk  
7 ishin pjesë apo palë apo pjesëmarrës në Çështjen gjyqësore 06,  
8 ata kanë pasur dijeni padyshim se nuk mund të nxjerrin  
9 informacion konfidencial lidhur me dëshmitarë të ZPS-së. Në  
10 fakt, atë dijeni atyre se sjellja e tyre ka qenë e paligjshme  
11 është e qartë nga mënyra e sjelljes gjatë vizitave, në mënyrë  
12 të veçantë përmes pëshpëritjeve dhe zërit të ulët kur  
13 diskutimet kishin të bënin me dëshmitarë konfidencialë të  
14 Çështjes gjyqësore 06.

15 Një shembull tjetër i kësaj dijenie është edhe grisja nga  
16 ana e Kilajt e pjesëve të deklaratave të dëshmitarëve  
17 konfidencialë - material i cili ishte i mbrojtur nga  
18 protokollin e Çështjes 06 - material që ai mori nga Thaçi gjatë  
19 vizitës së 6 tetorit edhe kjo me shpresë që të mos kapeshin.  
20 Gjatë intervistës me ZPS-në, Kilaj e pranoi që e ka patur në  
21 posedim këtë material, gënjeu sesi e kishte marrë, siguruar  
22 këtë material dhe e pranoi që ishte material të cilin nuk  
23 duhet ta kishte pasur në posedim pasi nuk ishte "çështje me të  
24 cilin unë duhet të merresha".

25 Që të gjitha këto janë tregues të qartë të synimit të tij

1 për të mbuluar ndihmesën që i ka dhënë Thaçit në kryerjen e  
2 mosbindjes ndaj gjykatës.

3 Që të gjithë këta faktorë përcaktojnë që Smakaj, Kilaj  
4 dhe Fazliu e dinin që e kishin të ndaluar të vepronin si  
5 ndërmjetës mes Thaçit dhe dëshmitarëve të Çështjes 06. Në vija  
6 të përgjithshme, Smakaj, Kilaj dhe Fazliu, roli aktiv i  
7 Smakaj, Kilajt dhe Fazliut gjatë vizitave përkatëse që i kanë  
8 bërë Thaçit përfshirë këshillën, *feedback* dhe mbështetjen  
9 morale, dakordësinë për të shkruar ekzaktësisht se çfarë ka  
10 thënë Thaçi me qëllim që të mund të zbatoheshin qartë  
11 udhëzimet e tij për ndërhyrje dhe, si dhe marrja e materialeve  
12 konfidenciale, kanë krijuar kushtet dhe kanë hequr pengesën  
13 ndaj Thaçit për shkeljen e protokollit të Çështjes 06 dhe për  
14 kryerjen e veprës penale të mosbindjes. Personi i cili jep  
15 ndihmën nuk ka nevojë që ta kryejë veprën penale të mos  
16 bindjes. Ata duhet thjesht që të japin ndihmë kryesit në  
17 mënyrë të synimshme dhe me dijeni të plotë.

18 Dhe, për rrjedhojë, aktet dhe sjelljet e Smakajt, Kilajt  
19 dhe Fazliut gjatë vizitave përkatëse e kanë mundësuar, e kanë  
20 inkurajuar dhe e kanë lejuar Thaçin në kryerjen e veprës  
21 penale të mosbindjes ndaj gjykatës. Dhe për pasojë ata janë  
22 fajtorë për ndihmesën për kryerjen e kësaj vepre penale.

23 Provat e ZPS-së në këtë çështje gjyqësore janë bindëse  
24 dhe të gjithanshme dhe reflektojnë përpjekje të vazhdueshme  
25 nga ana e të akuzuarve dhe përbëjnë pikërisht atë që quhet

1 përkufizimi i veprës penale të mosbindjes ndaj gjykatës. Në  
2 fakt, nuk ka mbrojtje për sjelljen penale të akuzuarve. Provat  
3 do të tregojnë se të akuzuarit i kanë bërë krimet e aktakuzës  
4 në mënyrë të vazhdueshëm me synim dhe me dijeni të plotë.

5 Dhe pas paraqitjes së të gjitha provave, ne do t'u  
6 kthehemi juve, i nderuar Gjykatës dhe do të kërkojmë që të  
7 përcaktoni që dëshmitarët të shpallen përgjegjës në përputhje  
8 me ligjin.

9 Ju falënderojmë për vëmendjen, i nderuar Gjykatës, këtu  
10 përfundon edhe deklarata hapëse e ZPS-së.

11 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit, znj.  
12 O'Connell.

13 Z. Rees, unë besoj se ju doni të mbani një fjalë hyrëse  
14 në emër të z. Smakaj.

15 Z. REES: [Përkthim] Po, do të filloj, i nderuar Gjykatës.

16 Në fillim të çdo gjykimi është një numër çështjes që janë  
17 aq të rëndësishme sa duhet të përsëriten pavarësisht sesa  
18 kompetentë janë gjykatësit. Dhe, në fakt, disa prej tyre ju i  
19 keni përsëritur gjatë kësaj seance të mëngjesit.

20 I nderuar Gjykatës, e para është që barra e provës i  
21 takon Prokurorisë. I akuzuari nuk ka nevojë që ta provojë  
22 pafajësinë e tij. Prokuroria e provon fajësinë duke bërë të  
23 mundur që Trupi Gjykses të konkludojë që fajësia është përtej  
24 dyshimit të arsyeshëm dhe kjo pas paraqitjes së provave nga  
25 Prokuroria gjatë fjalimit hapës dhe gjatë gjyqimit vetë dhe

1 vetëm e vetëm bazuar mbi provat e paraqitura gjatë kësaj faze  
2 nga Prokuroria.

3 Gjykatat e faktit, në të gjithë botën kujtohen në mënyrë  
4 të arsyeshme se ajo që thotë në fjalën hyrëse Prokuroria apo  
5 në çdo fazë tjetër, nuk është provë gjyqësore dhe me të  
6 drejtë, i nderuar Gjykatës, ju na kujtuat lidhur me këtë  
7 parim.

8 Një gjykatës, si juria, duhet ta dinë se procesi i  
9 gjykimit kërkon që ato kenë ta mbajnë të hapur opsionet derisa  
10 të kenë dëgjuar të gjitha provat dhe t'i kenë dëgjuar të  
11 gjitha fjalimet, përfshirë deklaratën fillestare dhe  
12 përfundimtare dhe pas peshimit të provave materiale.

13 Të gjitha hamendësimeve që mund apo supozimeve që  
14 paraqiten në sallë të gjykimit duhet të anashkalohe me  
15 fillimin e gjykimit. Dhe i vetmi prezumim është prezumimi i  
16 pafajësisë, siç e parashikon edhe Ligji 21(3) i Ligjit mbi  
17 Dhomat e Specializuara. I dyshuari apo i akuzuari nuk ka për  
18 detyrë t'i përgjigjet pyetjeve nga Prokuroria gjatë hetimeve.  
19 Në qoftë se atij i bëhen pyetje, ai ka të drejtë që të ruajë  
20 heshtjen dhe kjo nuk duhet interpretuar si përcaktim i  
21 fajësisë apo pafajësisë, siç parashihet nga Neni 38(3) i  
22 Ligjit mbi Dhomat e Specializuara.

23 Në fazën përgatitore, ligji përcakton se asnjë prej të  
24 akuzuarve para Dhomave të Specializuara nuk ka për detyrë që  
25 të tregojë sesi do të mbrohet apo lidhur me akuzat që

1 pretendohen nga Prokuroria dhe të cilat i akuzuari i  
2 kundërshton dhe arsyet përse i kundërshton.

3 Siç iu kujtua secilit prej të akuzuarve sot në mëngjes, i  
4 nderuar Gjykatës, i akuzuari ka të drejtën që të ruajë, që të  
5 rrijë i heshtur gjatë kohës së gjyqit dhe asnjë të akuzuari  
6 nuk i kërkohet që të japë dëshmi dhe kjo heshtje nuk mund të  
7 merret parasysh në përcaktimin e fajësisë apo pafajësisë.

8 Që të gjithë këto janë elementë thelbësorë që ia vlen të  
9 përsëriten.

10 Në rastin konkret, z. Smakaj nuk është marrë në pyetje  
11 nga ZPS-ja lidhur me hetimin e tij përpara ngritjes së  
12 aktakuzës. Megjithëkëtë, ai ka zgjedhur që të përcaktojë se si  
13 do ta mbrojë veten, arsyet se përse i kundërshton pretendimet  
14 e Prokurorisë dhe këtë e ka bërë përmes dosjes së 19 tetorit  
15 2025.

16 Ai është, po kështu, ai ka kundërshtuar disa pjesë të  
17 transkriptimeve dhe të audioincizimeve që kanë të bëjnë me dy  
18 data specifike që kanë lidhje me të. Dhe e them se këtë e ka  
19 bërë në mënyrë "të drejtë" pasi, siç e di vetë ZPS-ja,  
20 ndërkohë që i ka përgatitur argumentet deri kësaj jave dhe  
21 sapo ka paraqitur për Trupin Gjykses dhe për publikun një  
22 transkript në të cilin sugjerohet se z. Thaçi i ishte kërkuar  
23 më datën 7 tetor nëse mund të merreshin dokumente gjatë një  
24 vizite, në fakt, bëhet fjalë për një gabim interpretimi nga  
25 ana e ZPS-së të cilën Shërbimet Gjuhësore të kësaj gjykate

1 kanë konfirmuar se ishe gabim dhe se, në fakt, folësi tha  
2 pyeti nëse mund të sillte me vete dokumente në të ardhmen.

3 Çdo supozim që ZPS-ja duhet, ka gjithnjë të drejtë jo  
4 vetëm që është e papërshtatshme, e padrejtë, por edhe, në fakt  
5 edhe hutuese dhe çorientuese.

6 Z. Smakaj ka zgjedhur që t'i tregojë Prokurorisë se si do  
7 ta mbrojë veten e vet në këtë gjykim, që pavarësisht se ai ka  
8 qenë mik me Bislime Zyrapin dhe e ka takuar atë rregullisht,  
9 nuk ka mbajtur diskutime me z. Zyrapin lidhur me dëshminë e tij  
10 në Çështjen 06 dhe nuk i ka treguar asnjë dokument lidhur me  
11 të. Ju do të dëgjoni dëshmi gjatë këtij gjykimi se Bislime  
12 Zyrapin ka folur me ZPS-në dhe ka dhënë betim se do të japë, do  
13 të thotë të vërtetën dhe, siç ju thashë, që z. Smakaj ishte  
14 shok me z. Bislime Zyrapin, janë takuar rregullisht. Por nuk e  
15 ka kontaktuar për të diskutuar dëshminë e tij me z. Smakaj,  
16 nuk ka diskutuar aspekte që lidhen me dëshminë e tij me z.  
17 Smakaj apo me askënd tjetër për atë punë dhe z. Smakaj as nuk  
18 i ka treguar ndonjëherë ndonjë dokument dhe, në fakt, as ia ka  
19 ofruar dhe as ia ka treguar ndonjë dokument.

20 Z. Smakaj zgjodhi ta njoftonte Prokurorinë lidhur me  
21 argumentet e vet në këtë gjykim dhe në dosjen paraprake, që  
22 nuk kishte pse ta bënte, për të treguar se ai nuk ishte në  
23 dijeni për ndonjë protokoll për dëshmitarët në Çështjen 06 apo  
24 ndonjë urdhër për konfidencialitetin për Çështjen 06 apo që të  
25 ketë pasur ndonjë urdhër nga gjykata për dëshmitarët apo për

1 urdhrat mbrojtës gjithmonë për Çështjen 06, apo çfarëdo lloj  
2 emërtimi t'u japim këtyre dokumenteve që pretendon tani  
3 Prokuroria se janë si bazë. Dhe, rrjedhimisht, ai nuk ka qenë  
4 në dijeni që nuk po respektonte urdhrat e gjykatës, nuk është  
5 në dijeni që e ka bërë këtë gjë dhe ZPS-ja nuk ka bërë asnjë  
6 njoftim se çfarë provash do të përdorin këta në gjykim për të  
7 treguar se ai ka qenë në dijeni të urdhrave në fjalë. Nuk do  
8 të dëgjoni asgjë. Nuk ka prova se ai ka qenë në dijeni të  
9 ekzistencës së këtij protokolli apo urdhrave përkatës të  
10 Çështjes 06.

11 Z. Smakaj, sidoqoftë e njoftoi paraprakisht Prokurorinë  
12 lidhur me provat e veta paraprake, që nuk kishte pse ta bënte,  
13 për të treguar se ai nuk e ka parë dokumentin që pretendon  
14 Prokuroria, dokumentin që Prokuroria e quan "dokumenti  
15 Smakaj". Pra, ky i ashtuquajtur dokument Smakaj, e tregoi  
16 publikisht Prokuroria këtë dokument edhe, ishte pa redaktime,  
17 kështu që, afërmendsh ky dokument s'ka pasur të dhëna  
18 konfidenciale. Sidoqoftë z. Smakaj ka thënë që nuk e ka parë  
19 ndonjëherë këtë dokument më përpara por, sidoqoftë, ZPS-ja ne  
20 nuk na ka njoftuar se çfarë provash do të nxjerrin në këtë  
21 gjykim lidhur me dokumentin në fjalë, kur e mori Prokuroria  
22 për herë të parë dokumentin në fjalë.

23 Ju nuk do dëgjoni asgjë në lidhje me këtë, nuk ka prova  
24 për këtë se dokumenti është sekuestruar prej ZPS-së nga  
25 automjeti i z. Smakaj. Po thjesht do t'ju tregoj një fotografi

1 të një dokumenti të ngjashëm në një veturë që pretendohet se  
2 është e z. Smakaj pa dhënë asnjë kontekst në lidhje me  
3 dokumentin në fjalë.

4 Z. Smakaj sidoqoftë e njoftoi paraprakisht Prokurorinë  
5 lidhur me provat që do të ketë në këtë gjykim përmes dosjes  
6 paraprake dhe një nga aspektet që është trajtuar është mungesa  
7 e shenjave të gishtave apo analizës kriminalistike të të  
8 ashtuquajturit dokumenti Smakaj, siç e quan Prokuroria.

9 Dhe, në fakt, ju do të dëgjoni dëshmi apo do të shikoni  
10 prova që më 6 dhjetor 2023, Prokuroria informoi firmën e  
11 forensikës që po bënte punën në këtë rast se nuk kërkohej  
12 asnjë vërtetim i shenjave të gishtave apo të ADN-së për  
13 dokumentin të ashtuquajturin dokumentin Smakaj.

14 ZPS-ja, ndonëse e njoftoi paraprakisht ZPS-në, që nuk e  
15 kishte parë këtë dokument më përpara, ZPS-ja nuk bëri asnjë  
16 kërkesë të mëvonshme më së së paku që të bëjë një shqyrtim i  
17 shenjës së gishtave apo të ADN-së të këtij dokumenti sepse i  
18 kërkuan firmës kriminalistike që të mos e bënte një shqyrtim  
19 të tillë, pra, që në fillim të këtij hetimi Prokuroria e bëri  
20 të qartë që nuk kishte nevojë as për ADN as për shenjat e  
21 gishtave të dokumentit në fjalë, që duan t'ia atribuojnë z.  
22 Smakaj, nuk është bërë asnjë punë edhe pasi z. Smakaj u tha që  
23 nuk kishte dijeni për dokumentin në fjalë. Po pse?

24 Prezumimet e ZPS-së lidhur me dokumentin Smakaj burojnë  
25 pikërisht nga pretendimet e vetë Prokurorisë, siç e dëgjuam

1 dhe sot paradite, që jo vetëm janë të papërshtatshme, të  
2 pasakta dhe të padrejta, po janë dhe keqorientuese.

3 Nëse Prokuroria mund ta vërtetojë se prejardhja e këtij  
4 dokumenti ka qenë një dosje elektronike në njësinë e  
5 paraburgimit për të cilën z. Smakaj s'ka asnjë lloj dijenie,  
6 atëherë duhet ta shohim nga provat, provat duhet të tregojnë  
7 që kjo dosje elektronike nuk mund të printohej pa kaluar në  
8 duart e oficerit të paraburgimit.

9 Nuk po fajësoj askënd, ta kemi të qartë. Por argumentet e  
10 Mbrojtjes janë këto. Kemi nevojë për një shpjegim alternativ  
11 si përfundoi dokumenti në duart e ZPS-së, si arriti sepse  
12 dokumentin e ka marrë vetë ZPS-ja prej një oficeri të  
13 paraburgimit dhe nëse ka qenë në automjetin e z. Smakaj,  
14 atëherë e ka vendosur qëllimisht ZPS-ja në automjet vetëm që  
15 t'i atribuojë dokumentin z. Smakaj. Ky është një shpjegim  
16 alternativ sepse i leverdis ZPS-së, e kishin përmendur këtë  
17 dhe në dosjen paraprake, ndonëse ne e njoftuam paraprakisht,  
18 z. Smakaj e njoftoi Prokurorinë dhe i tha përmes dosjes  
19 paraprake që këtë dokument nuk e kishte parë më përpara. Por,  
20 sidogoftë, Prokuroria nuk na njofton se çfarë provash ka vetë  
21 Prokuroria, a do të kemi ndonjë oficer të paraburgimit këtu që  
22 ta trajtojmë këtë aspekt.

23 Nuk do të shohim asnjë provë, pra, asnjë provë të vetme  
24 nga Prokuroria që të identifikojë personin që ka printuar  
25 dokumentin që ka emrin "për avokatët". Por e vetmja provë që

1 do të shohim ne është pikërisht prova që ka marrë tashmë  
2 numrin P00128, siç e përmendi Prokuroria paraprakisht, vetëm,  
3 është e vetmja provë që është dëshmia e një personi anonim,  
4 pra, është dëshmia e një personi anonim në këtë rast. Dhe ju  
5 po ashtu do të dëgjoni që llogaria apo profili që u përdor për  
6 të printuar dokumentet ishte një profil që e ndanin dhe  
7 personat në paraburgim dhe oficerët e paraburgimit. Nuk ka  
8 asnjë provë që të vërtetojë kush e ka printuar dokumentin "për  
9 avokatët", nëse ky dokument ka ndonjë farë relevance në këtë  
10 rast.

11 Por në vend që të merremi me provat, sepse barra e provës  
12 e ZPS-së është, ZPS-ja me besim thotë që kaq mjafton -- po  
13 filloj dhe një herë më falni. Pra, Prokuroria i kërkon  
14 gjykatësit të marrë për të mirëqena fjalët e Prokurorisë dhe  
15 të mos respektojë detyrimin e Prokurorisë për të vërtetuar  
16 çështjen e vet bazuar në provat që janë paraqitur pas  
17 deklaratave hyrëse dhe synon të mos e pranojë prezumimin e  
18 pafajësisë dhe thotë ju, i nderuar Gjykatës mund ta bëni këtë  
19 dhe Prokuroria zgjedhë një mënyrë tjetër, pra, ZPS-ja  
20 pretendon se ka gjithmonë të drejtë edhe se duhet të merret e  
21 mirëqenë ajo që thotë Prokuroria.

22 Ne, sidoqoftë, po ashtu kemi besim nga kjo anë e sallës  
23 së gjyqit që ju do ta zhgënjoni ZPS-në në lidhje me këtë, i  
24 nderuar Gjykatës, dhe do t'i shikoni provat me kujdes dhe të  
25 dëgjoni të gjitha dëshmitë, të merrni të gjitha provat nga të

1 gjitha palët dhe t'i kushtoni rëndësi faktit që z. Smakaj  
2 është i pafajshëm, përveç nëse Prokuroria provon të kundërtën  
3 në bazë të provave. Për këtë kërkojmë që ju të keni vëmendjen  
4 e duhur, i nderuar Gjykatës.

5 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

6 Z. Edwards, na kanë ngelur 19 minuta përpara pushimit.

7 Jeni në gjendje të përfundoni?

8 Z. EDWARDS: [Përkthim] Unë do filloj dhe do përpiqem të  
9 mbaroj brenda orarit. Edhe për përkthyesit do përpiqem të flas  
10 ngadalë.

11 Më shumë se 27 muaj pasi është bërë arrestimi i parë i z.  
12 Kilaj në shtëpinë e tij në Malishevë, në qytetin ku ka qenë dy  
13 herë i zgjedhur si kryekomunar, më në fund - më në fund -  
14 fillon ky gjykim.

15 Për më shumë se 27 muaj, 18 muaj të cilave i kaloi në  
16 paraburgim, jeta e z. Kilaj ka qenë pezull. Është e vështirë  
17 të parashikosh dhe të thuash se me sa padurim e kanë pritur  
18 këtë moment familja e tij dhe ai sepse më në fund në një  
19 gjykim publik bota do ta kuptojë sa e dobët është çështja e  
20 Prokurorisë kundër tij.

21 Ky rast, kjo çështje përfshin pesë të akuzuar, janë 19  
22 pika në aktakuzë. Çka do të thotë që është një çështje e  
23 ndërlikuar.

24 Por të fokusohemi, siç do të bëj unë, në argumentet  
25 kundër z. Kilaj konkretisht, është shumë e thjeshtë dhe nuk

1 është aspak e komplikuar nga pikëpamja faktike ky rast para  
2 një gjykate ndërkombëtare.

3 Argumentet e Prokurorisë kundër tij mbështeten në një  
4 takim të vetëm në njësinë e paraburgimit të Dhomave të  
5 Specializuara më 6 tetor 2023. Z. Kilaj dhe shoku i tij prej  
6 shumë vitesh, Vllaznim Kryeziu, vizituan z. Thaçi për disa  
7 orë. Qeshën, biseduan, kujtuan ditët e vjetra, folën për  
8 luftën ku luftuan për të mbrojtur Kosovën e tyre të dashur.  
9 Ata folën për personat që i kishin njohur prej shumë vitesh.

10 Siç e dëgjuat sot paradite, Prokuroria pretendon se z.  
11 Thaçi i ka dhënë z. Kilaj udhëzime që të takohej me  
12 dëshmitarët që do të dëshmonin në rastin e tij dhe t'u thoshte  
13 se çfarë duhet të thonin në sallën e gjyqit dhe si duhet t'i  
14 thonin.

15 Dua ta bëj të qartë, unë nuk do të trajtoj aspak se çfarë  
16 ka thënë apo nuk ka thënë z. Thaçi me z. Kilaj. Z. Kilaj nuk  
17 pranon asgjë sa i takon udhëzimeve të pretenduara. Si në çdo  
18 gjykatë penale në botë, qoftë kjo në Kosovë, në Britani, në  
19 Kanada, kudo, Prokuroria i paraqet provat dhe Prokuroria duhet  
20 të provojë provat e veta, të vërtetojë që z. Kilaj është  
21 fajtor për akuzat. Nuk është detyrim i z. Kilaj të vërtetojë  
22 pafajësinë e tij.

23 Dhe nuk dua të përsëris atë që tha z. Rees në fjalën e  
24 tij para pak çastesh, po theksoj dhe një herë se sa e  
25 rëndësishme është barra e provës, standardi i barrës së

1 provës, sepse është jashtëzakonisht e rëndësishme.

2 Por edhe nëse Prokuroria arrin të vërtetojë atë që është  
3 diskutuar në vizitën e 6 tetorit, nuk asnjë provë të vetme që  
4 z. Kilaj të ketë kontaktuar dëshmitarët e Çështjes 06 më pas,  
5 edhe më pak të ketë ndonjë provë që z. Kilaj të ketë takuar  
6 ndonjë prej këtyre dëshmitarëve më pas edhe më pak prova madje  
7 që z. Kilaj t'u ketë thënë dëshmitarëve se çfarë duhet e nuk  
8 duhet të thonë kur vijnë të japin dëshmi përpara këtij Trupi  
9 Gjykues në Çështjen 06.

10 I nderuar Gjykatës, gati katër javë mes takimit të 6  
11 tetorit 2023 dhe arrestimit të z. Kilaj më 2 nëntor 2023, nuk  
12 ka asnjë provë të vetme për këtë periudhë kohore që z. Kilaj  
13 të ketë bërë ndonjë gjë në bazë të vizitës që ka pasur në  
14 vizitën e paraburgimit. Asnjë të vetme. U largua nga  
15 paraburgimi të premtën pasdite dhe vazhdoi jetën e tij në  
16 Kosovë 27 ditët më pas, derisa ia kthyen jetën përmbys.

17 Jo vetëm që nuk ka prova që z. Kilaj të ketë bërë diçka  
18 pas takimit të 6 tetorit por nuk ka asnjë provë për relevancën  
19 e veprimeve që ka ndërmarrë z. Kilaj para takimit të 6 tetorit  
20 që të çon në deduksionin se ka pasur synim kriminal nga ana e  
21 tij.

22 Pasi pamë provat e vogla, të pakta që ka Prokuroria  
23 kundër z. Kilaj, ju, i nderuar Gjykatës, duhet të kuptoni që  
24 thelbi është këtu, synimi i z. Kilaj sa u takon dy akuzave që  
25 janë ngritur për të në pikat 14 dhe 15, e thënë ndryshe në

1 gjuhën juridike mens rea.

2 Pasi të paraqesë ato pak prova kundër z. Kilaj,  
3 Prokuroria do ju kërkoj ju, i nderuar Gjykatës, që të  
4 deduktoni synimin e z. Kilaj, të dilni në përfundime lidhur me  
5 sjelljen e tij sa i takon dyshimit të që ka pasur ai lidhur me  
6 pikat për të cilat janë ngritur akuzat. Po unë po ua them që  
7 tani, i nderuar Gjykatës, Prokuroria nuk do t'ju paraqesë  
8 asgjë, asnjë gjë të vetme që t'ju ndihmojë ju të dilni në  
9 përfundimin që ata duan.

10 Kanë prova, i nderuar Gjykatës, që ju mund të dëgjoni nga  
11 Prokuroria që lidhen me barrën e provës, barrë e rëndë, barrë  
12 që i kërkon Prokurorisë të vërtetojë provat e veta përtej  
13 dyshimit të arsyeshëm, por kjo dëshmi, këto prova, në këtë  
14 rast janë shumë të dobëta ose inekzistente. Nuk do të shikoni  
15 asnjë provë për ndonjë ndërmarrje kriminale të përbashkët apo  
16 përpjekje për ndërmarrje kriminale të përbashkët që lidhet me  
17 z. Thaçi në aktakuzë, ata thjesht njihen, pra, z. Kilaj dhe z.  
18 Thaçi thjesht njihen me njëri-tjetrin, nuk janë pjesë e  
19 ndërmarrjeje të përbashkët kriminale të përbashkët, nuk ka  
20 asnjë provë që të ketë ndërhyrë ndaj dëshmitarëve.

21 Ky nuk është thjesht një argument i Mbrojtjes. Është  
22 realiteti. Secili prej të akuzuarve, e dëgjuam, paska pasur  
23 grupin e vet sipas aktakuzës. Nuk pretendohet që z. Kilaj të  
24 ketë vepruar në mënyrë të bashkërenduar me z. Smakaj apo  
25 Fazliun, apo Kuçin që të ndërhyjë ndaj dëshmitarëve.

1 Gjithashtu nuk do të shikoni asnjë provë të vetme nga  
2 Dëshmitarët 3 apo 4 që të jenë kontaktuar nga z. Kilaj pas  
3 vizitës së 6 tetorit apo nga çdo dëshmitar tjetër para vizitës  
4 së 6 tetorit. Prokuroria do të sugjerojë se z. Kilaj gjatë  
5 vizitës me z. Thaçi ka thënë se ka folur me një dëshmitar të  
6 Prokurorisë përpara kësaj vizitës. Nuk është ngritur si akuzë,  
7 po unë dua ta trajtoj dhe këtë pikë sepse është diçka e  
8 rëndësishme këtu edhe sikur të marrim fjalë për fjalë atë që  
9 ka thënë z. Kilaj, ai ka thënë që është takuar me një  
10 dëshmitar një javë para vizitës së 6 tetorit, që ka qenë shumë  
11 kohë pasi ky dëshmitar e kishte dhënë dëshminë në Çështjen 06,  
12 kështu që s'ka si të ketë ndërhyrë z. Kilaj në dëshminë e tij.

13 Tani të flasim për Dëshmitarin 4 dhe akuzat në aktakuzë,  
14 jo vetëm që nuk ka prova që z. Kilaj ta ketë kontaktuar para  
15 ose pas 6 tetorit, po ka prova pozitive, pra, në favor të z.  
16 Kilaj, që ky dëshmitar nuk është kontaktuar asnjëherë nga z.  
17 Kilaj. Në një shënim të janarit 2024, Dëshmitari 4 tha që për  
18 herë të fundit ka kontaktuar me z. Kilaj nga viti 2017, 2018.  
19 Ai nuk pranoi që ndonjë person kohët e fundit, pra, janar  
20 2024, ta ketë kontaktuar për të diskutuar përvojën e tij gjatë  
21 luftës apo që të ketë ndërhyrë ndaj dëshmisë së tij. Dhe ky  
22 person e ka mohuar sërish përmes një shënimi në maj dhe sërish  
23 në qershor të 2025.

24 Kjo është provë, provë e krijuar nga Prokuroria dhe janë  
25 fakte për të cilat jemi pajtuar ne si Mbrojtje me Prokurorinë.

1 Ju lutem, shikoni parashtrimin numër 4 sa u takon fakteve të  
2 miratuara që u dorëzuan dje.

3 Prokuroria nuk ka asnjë provë për të kundërshtuar atë çka  
4 është thënë në këto shënime dhe kjo është realisht në  
5 përputhje me argumentet e ZPS-së.

6 11 muaj më parë, 21 mars 2025, parashtrimi 234, kur bëmë  
7 një parashtrim lidhur me lirimin e përkohshëm, Prokuroria tha  
8 kështu sa i takon argumenteve të veta për Dëshmitarin 4. Është  
9 paragrafi 10 i dokumentit dhe thonë:

10 "Sidoqoftë, kur dorëzua materialet e fundit pamë që  
11 Kilaj nuk është takuar me Dëshmitarin 4 dhe kjo nga ana tjetër  
12 tregon se Kilaj nuk ka marrë pjesë në përpjekje të përbashkët  
13 për të ndikuar në dëshminë e Dëshmitarit 4. Kilaj ka treguar  
14 një keqkuptim të qartë të aktakuzës dhe vendim të konfirmimit  
15 të cilat nuk janë bazuar në faktin që z. Kilaj është takuar me  
16 Dëshmitarin 4. Rëndësia e kësaj prove do të diskutohet në këtë  
17 gjykim sepse ZPS-ja ka pikëpamje tjetër nga ajo që ka z.  
18 Kilaj.

19 Ja ku jemi tani, është e premtë, 27 shkurt 2026 dhe i  
20 lutemi Prokurorisë të na ndriçojë tani, siç na premtoi, kush,  
21 cila është kjo rëndësi dhe relevancë e provave të tyre kundër  
22 z. Kilaj dhe më konkretisht cila është rëndësia e mungesës së  
23 provave që ai të ketë kontaktuar Dëshmitarët 3 apo 4.

24 E kemi dëgjuar me kujdes Prokurorinë sot paradite. Dhe  
25 dua të them, unë nuk jam më i qartë tani sa i takon rëndësisë

1 së mungesës së provave në këtë rast. Pra, nuk jam më i qartë  
2 tani nga ç'kam qenë një vit më parë. Mezi po pres në fakt të  
3 dëgjoj se çfarë provash ka Prokuroria kundër z. Kilaj, si do  
4 ta demonstrojnë këtë argument apo këto prova të forta kundër  
5 tij.

6 Nuk është detyra ime, por ju lutem, i nderuar Gjykatës,  
7 të jeni i vëmendshëm gjatë këtij gjykimi të shkurtër sa i  
8 takon diskutimit të 6 tetorit ku diskutohet që janë dhënë  
9 udhëzime për të manipuluar dëshminë e dëshmitarëve. Unë nuk po  
10 diskutoj çfarë është thënë e çfarë nuk është thënë në atë  
11 takim. Por nuk ka asnjë provë të vetme që ndonjë person të  
12 ketë ndërmarrë hapa për të ndryshuar dëshmitë e dëshmitarëve,  
13 as hapa përgatitorë, e jo më tej hapa konkretë, që janë të  
14 nevojshëm për të vërtetuar përgjegjësinë penale.

15 Tani kaloj tek kategoria e tretë e provave që po ashtu  
16 mungojnë dhe është kjo: Prokuroria ka marrë këtë vendim -  
17 vendim strategjik, pa dyshim - të mos thërrasë asnjë dëshmitar  
18 nga Çështja 06. I vetmi dëshmitar që do të dëgjojmë ne në këtë  
19 këto ditë, që është planifikuar në pak se një javë nga  
20 gjykimi, është një dëshmitar profesionist, kështu e përshkruaj  
21 unë këtë. Dhe duket si shaka në fakt. [REDAKTUAR]

22 një ekspert forensike, një fotograf do hyjnë në sallën e  
23 gjyqit. Po të mos ishte kaq tragjike për mua kjo do të ishte  
24 një komedi, po tragjike për z. Kilaj dhe familjen e tij.

25 Po kështu është kjo çështje. Këtë formë ka kjo çështje

1 gjyqësore dhe këtë emërtim meriton kjo çështje gjyqësore, nuk  
2 ka asnjë dëshmi të vetme nga Prokuroria dhe Prokuroria -  
3 qëllimisht - nuk ka thirrur dëshmitarë të rëndësishëm.

4 I nderuar Gjykatës, ju do të dilni në përfundimin në fund  
5 të javës se arsyeja përse nuk thërrasin dëshmitarë me rëndësi  
6 është se nëse do të thërrisnin këta dëshmitarë, atëherë do të  
7 dilte e vërteta në pah. Që s'ka asnjë provë. Një provë e  
8 bazuar në pretendime që janë thjesht analiza individuale të  
9 Prokurorisë madje-madje për mua thashetheme.

10 Kam folur për mungesën e provave deri tani, po dhe po  
11 shoh orën në fakt. Unë po shpresoja që do të mbaroja, po nuk  
12 do të përfundoj. Kështu, në qoftë se më jepni leje, i nderuar  
13 Gjykatës, do të doja të vazhdoja pas pushimit të drekës.

14 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Patjetër, z. Edwards, mund  
15 të vazhdoni pas drekës.

16 Në rregull. Do të bëjmë pushim tani deri në orën 2.30.  
17 Dhe pas pushimit do të përfundoni ju me deklaratën hyrëse. Dhe  
18 të përgatitet Dëshmitari 7 për të filluar me dëshminë e tij.

19 Z. HAFETZ: [Përkthim] Po. Dëshmitari është gati. Do të na  
20 duhet një pushim i shkurtër thjesht për masat mbrojtëse.

21 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Në rregull. Tani do të  
22 bëjmë pushim.

23 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.28

24 --- Seanca rifillon në orën 14.30

25 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mirëdita.

1 Z. Edwards, mund vazhdoni.

2 Z. EDWARDS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

3 Përpara sesa të shkonin për pushimin e drekës isha gati  
4 për filluar me një pikë tjetër në fjalën time, dhe po thoja që  
5 unë kam folur për sa i takon mungesës së provave lidhur me  
6 kontaktin e z. Kilaj me dëshmitarët e Prokurorisë, e aq më pak  
7 mungesës së pengimit të drejtësisë prej tij. Ne parashtrojmë  
8 që ky është një element i rëndësishëm sepse edhe në qoftë se  
9 do të merret parasysh edhe versioni më i mirë i mundshëm i  
10 argumenteve të Prokurorisë ajo nuk sugjeron që z. Kilaj ka  
11 synuar të pengojë apo ka penguar apo ka ndihmuar apo pajtuar  
12 që të pengojë zyrtarët për ushtrimin e detyrave të veta  
13 zyrtare, sikurse pretendohet në pikën 14 të aktakuzës.

14 Përpara pushimit të drekës unë thashë çështja ndaj z.  
15 Kilaj është e drejtpërdrejtë, por nga ana tjetër kjo  
16 thjeshtësi është tërësisht në kundërshtim me kompleksitetin e  
17 stisur të pikës 14 në aktakuzë, mënyra se si është inkuadruar  
18 ajo dhe mënyrën se si është paraqitur ajo.

19 Në dosjen paraprake ne kemi parashtuar kompleksitetin,  
20 gjithashtu edhe qasjen tërësisht të re, në qoftë se jo, diçka  
21 jo normale fare, të Pikës 14 të ngritur nga Prokuroria. Dhe  
22 Prokuroria duket sikur arrin objektivin në pamje të parë të  
23 paarritshëm për përfshirjen e të gjitha formave të  
24 përgjegjësisë penale ndërkohë që nuk pretendon asgjë  
25 materialisht.

1 I nderuar Gjykatës, besoj që ju e dini procesin  
2 përsëritës të konfirmimit të aktakuzës nga Prokuroria, kështu  
3 që nuk është se do ju marr shumë kohë tani për t'ju kujtuar  
4 për kronologjinë sepse e gjithë kronologjia për aktakuzën e  
5 konfirmuar përmbahet në vendimin e pararendësit tuaj.

6 Megjithatë, në paragrafin 192 të Vendimit për Konfirmimin e  
7 aktakuzës, dhe kjo është publike, më duhet të them që:

8 "... nuk demonstrohet që ekziston një dyshim i arsyeshëm  
9 për deklaratë ose veprimet e z. Thaçi, Fazliu dhe Smakaj, dhe  
10 Kilajt që ata të kenë penguar ushtrimin e detyrave zyrtare të  
11 zyrtarëve të ZPS-së, sikurse pretendohet prej ZPS-së."

12 Z. Kilaj ka 27 muaj që pret për një gjykim që ka të bëjë  
13 me pengimin e drejtësisë dhe ndërhyrjen e drejtësisë, por  
14 ndërkohë tashmë ne e dimë që nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm  
15 që ka ndodhur pengimi i administrimit të drejtësisë. Po ashtu  
16 ne dëgjuam më herët gjatë paradites gjatë hapjes së çështjes  
17 nga Prokurori, dhe këtu parafrazoj "që nuk është e rëndësishme  
18 në qoftë se të akuzuarit ja kanë dalë apo jo në përpjekjet e  
19 tyre për të ndërhyrë ndaj dëshmitarëve", por si çështje  
20 ligjore kjo mund të jetë e drejtë, megjithatë më duhet të them  
21 që kjo është një deklaratë shumë e guximshme dhe ne  
22 parashtrojmë që kjo ka si qëllim kryesor që të formësojë  
23 mendimin tuaj lidhur me atë çfarë ka ndodhur realisht.

24 Por kjo nuk është aktakuza që Prokurorja e Specializuar  
25 dëshironte që të kishte fillimisht. Aktakuza nuk ishte

1 versioni i parë, nuk ishte as versioni i dytë, por ishte  
2 aktakuza operative, ajo e cila në fund u miratua dhe u kërkua  
3 për miratim prej Prokurorisë. Kështu që Prokurorisë iu desh të  
4 kthehej përsëri në tabelën e skicime të planeve të veta pasi  
5 secila prej versioneve paraprahe të veta iu nënshtrua  
6 kontrolleve gjyqësore, dhe ajo çfarë kemi ne tani, kemi një  
7 Pikë 14 në aktakuzë e cila pretendon një shtresëzim kompleks  
8 që nuk ka kuptim. Është e çuditshme. Është pa sens, është pa  
9 kuptimin.

10 Nga njëra anë e kemi pengimin e personave zyrtarë, që  
11 është krimi bazë, ose përbërësi bazë që parashikohet në nenin  
12 401. Më tej kemi pjesëmarrjen në veprimin e përbashkët të një  
13 grupi, ky është niveli i parë ose shtresa e parë e formës së  
14 përgjegjësisë penale dhe kjo parashikohet në paragrafin 2 të  
15 nenit 401. Ose orvatjen ose përpjekjen që është niveli i dytë  
16 i mënyrë së përgjegjësisë penale dhe sikurse konstatohet në  
17 vendime të mëparshme, pra, domethënë është e rëndësishme që të  
18 kemi vërtetësi në prova. Ndërkohë që kemi, pra, alternativa të  
19 ndryshme që parashtrohen nga Prokuroria dhe këto alternativa  
20 janë kryerja, marrëveshja, pajtimi ose ndihmimi. Dhe këto  
21 mënyra alternative nuk janë asgjë tjetër por janë një  
22 përsëritje e versionit të pakonfirmuar të aktakuzë.

23 Pra, thjesht thashë që kjo është një shtresëzim i  
24 çuditshëm i një forme të përgjegjësisë penale e cila  
25 mbivendoset mbi një formë tjetër të mënyrës së përgjegjësisë

1 penale dhe, i nderuar Gjykatës, kjo nuk ka të bëjë fare me një  
2 argument, ose me argumentet e Prokurorisë të cilat të  
3 drejtpërdrejta të pakomplikuara dhe nuk është fare ky rasti  
4 dhe aq më pak është rasti i një çështje të shumë të plotë.

5 Por, nga ana tjetër ne parashtrojmë që nuk ka fare prova  
6 për përfshirjen në kriminalitet të z. Kilaj, pra në vepra  
7 penale të z. Kilaj.

8 I nderuar Gjykatës, ju do të duhet që t'i përgjigjeni  
9 pyetjeve të tilla si për shembull, në qoftë se një i akuzuar  
10 mund të ndihmojë në një përpjekje krahasimisht me ndihmimin e  
11 kryerjes së një veprë penale. Ku qëndron dallimi ndërmjet të  
12 dyjave dhe -- pra cili duhet të jetë qëllimi i synuar i  
13 ndihmuesit të pretenduar. Një pyetje tjetër që do të duhet t'i  
14 përgjigjeni është kjo: Si mund të pajtohesh me përpjekjen për  
15 të bërë diçka?

16 Ne mendojmë që juve nuk do ju duhet shumë kohë për të  
17 arritur në përfundime lidhur me këtë pyetje, i nderuar  
18 Gjykatës, duke marrë parasysh mënyrën se si është formuluar  
19 Pika 4, dhe ne parashtrojmë që Pika 14 në vetvete nuk bën  
20 asgjë tjetër vetëm se zbulon pabazueshmërinë e pretendimit  
21 ndaj z. Kilaj.

22 Sikurse e themi në dosjen paraprake, kreativiteti i  
23 Prokurorisë i tillë në nivelin që ne shikojmë këtu,  
24 përgjithësisht është tregues i brishtësisë së provave, dhe ne  
25 parashtrojmë që kjo çështje këtu është një shembull i

1 shkëlqyer i këtij fenomeni.

2 Thuajse se kam mbërritur në fund të prezantimit tim. Deri  
3 tani po flisja për Pikën 14, por dua që të trajtoj  
4 shkurtimisht Pikën 15, që është mosbindje ndaj Gjykatës duke  
5 ndihmuar Presidentin Thaçi për mos t'ju bindur urdhrave të  
6 Gjykatës. Përsëri ky është pretendim. Edhe kësaj radhe ne nuk  
7 kemi të bëjmë me asgjë tjetër përveçse me kreativitet të  
8 Prokurorisë që shkon përtej së imagjinuarës.

9 Prokuroria pra, deklaron se z. Kilaj mendohet ose  
10 pretendohet që të ketë ndihmuar Presidentin Thaçi për të kryer  
11 mosbindje ndaj Gjykatës duke, së pari, e vizituar atë,  
12 ndërkohë që nuk shqetësohet fare Prokuroria të shpjegojë se  
13 nga mund ta dinte z. Kilaj se çfarë do të diskutohej në atë  
14 takim, sikur të kishte ndonjë shkop magjik z. Kilaj. Prokurori  
15 mbështetet te fakti se materiali konfidencial është diskutuar  
16 gjatë kësaj vizite ndërkohë që nuk shpjegon fare se si z.  
17 Kilaj mund të dinte që materiali në fjalë ishte apo jo  
18 konfidencial, ose pa sugjeruar se si z. Kilaj shmangu  
19 përgjegjësinë penale të ndihmuar në rrethana të tilla. Pyetje  
20 retorike është çfarë duhej të kishte bërë z. Kilaj, duhet të  
21 kishte vënë gishtat në vesh edhe thjesht të mos kishte lejuar  
22 veten që të dëgjonte, të mos ishte pjesëmarrës fare në një  
23 bisedë të tillë?

24 Po ashtu, Prokuroria thotë që z. Kilaj ka bërë vepër  
25 penale dhe është i përfshirë në formë të përgjegjësisë penale

1 pa marrë -- duke marrë dhe duke mbajtur informacion  
2 konfidencial, pa shpjeguar fare se çfarë ka ndodhur realisht  
3 dhe se si është realizuar pretendimi për mosbindje ndaj  
4 Gjykatës.

5 Pra, duket sikur situata e z. Kilaj sipas Prokurorisë  
6 është e tillë që çfarëdo që të bënte ai, prapë ai do të ishte  
7 fajtor dhe Prokuroria çështjen e vet e mbështete tek deklarata  
8 të rreme të dëshmitarëve dhe dëshmia e Prokurorisë është që ka  
9 gjetur disa copa letrash të grisura diku dhe kaq, asgjë  
10 tjetër. Në fakt, është shumë e guximshme nga Prokuroria për të  
11 thënë që: fakti që z. Kilaj i ka grisur këto letra, atëherë po  
12 heq dorë, ose po mundohet që të fshehë përfshirjen e tij në  
13 përgjegjësinë penale. Po nga ana tjetër e gjithë kjo nuk ka  
14 pikë kuptimi dhe është tërësisht e pabazuar.

15 Dua të theksoj dhe një herë tjetër diçka që e ngriti z.  
16 Rees, dhe diçka që e ngrita dhe unë gjatë paradites, është  
17 detyrë e Prokurorisë që të provojë përtej dyshimit të  
18 arsyeshëm akuzat e ngritura ndaj z. Kilaj. Ne - z. Kilaj dhe  
19 ekipi i vet ligjor - është besimplotë që në fund të këtij  
20 procesi gjyqësor të shkurtër ju do të mbërrimi në përfundimin  
21 që Prokuroria as nuk i është afruar plotësisht të këtij  
22 standardi e jo më ta ketë plotësuar atë sa i takon z. Kilaj.  
23 Faleminderit.

24 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit, z. Edwards.

25 Atëherë duhen pothuajse 15 minuta pak a shumë, në mos

1 gabohem, në mënyrë të tillë që të vihen në zbatim masat  
2 mbrojtëse për dëshmitar. Kështu që do bëjmë pushim deri në  
3 orën 3.00 pa pesë. Do ju kërkoja që të qëndroni afër sallës së  
4 gjyqit në mënyrë të tillë që të fillojmë pa vonesë.

5 --- Seanca ndërpritet në orën 14.42

6 --- Seanca rifillon në orën 14.55

7 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Sa i takon planifikimit  
8 presim që të vazhdojmë me dëshmitarin deri në orën 3.55,  
9 pastaj kemi disa çështje logjistike që duhet të trajtojmë, si  
10 dhe palët do kenë mundësinë të trajtojnë ndonjë aspekt që mund  
11 ta mendojnë të arsyeshëm.

12 Ju lutem sillni dëshmitarin në sallë.

13 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

14 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mirëdita, Dëshmitar, më  
15 dëgjoni?

16 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëdita. Po, ju dëgjoj.

17 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Dëshmitar, jeni thirrur  
18 të jepni dëshmi përpara Dhomave të Specializuara në çështjen  
19 Prokurori i Specializuar kundër Thaçit, Smakajt, Kilajt,  
20 Fazliut dhe Kuçit. Sikurse mund ta dini ju janë caktuar masa  
21 mbrojtëse për këtë çështje gjyqësore. Juve ju është caktuar  
22 një pseudonim, çfarë do të thotë që ne nuk do të përdorim  
23 emrin tuaj, por do ju referohemi si "Dëshmitar 07" ose "Z.  
24 Dëshmitar", në mënyrë të tillë që publiku të mos e marrë vesh  
25 se kush jeni ju. Po ashtu është shtrembëruar zëri dhe fytyra,

1 çfarë do të thotë që askush tjetër përveç atyre të cilët janë  
2 të pranishëm në sallën e gjyqit mund t'ju shohin fytyrën ose  
3 që të dallojnë zërin tuaj.

4 Kur t'ju bëjnë pyetje ne nuk do e zbulojmë identitetin  
5 tuaj, dhe çfarë do të thotë që dëshminë tuaj do e bëjmë në  
6 seanca publike. Por në qoftë se do ju kërkojmë që të thoni  
7 diçka që nxjerr identitetin tuaj ose që do jepni ndonjë  
8 informacion lidhur me veten tuaj atëherë seancën do ta kalojmë  
9 në private.

10 Dëshmia juaj do transmetohet me vonesë kështu që ndonjë  
11 informacion që mund të rrjedhë mund ta heqim për shkak të  
12 vonesës.

13 Z. Dëshmitar, a i kuptoni masat që janë ndërmarrë në  
14 mënyrë të tillë që të mbrohet identiteti juaj?

15 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës, ju kuptoj  
16 plotësisht.

17 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Pasi të lexoni deklaratën  
18 solemne për të thënë të vërtetën do ju bëjmë pyetje së pasi  
19 Prokuroria dhe pastaj ekipet e Mbrojtjes. Pas dëshmisë tuaj  
20 edhe unë mund të kem disa pyetje për ju pasi të kenë mbaruar  
21 palët.

22 Do ju ftoja të dëgjoni me vëmendje pyetjet që do t'ju  
23 bëhen. Juve duhet të tregoni të vërtetën dhe nëse një pyetje  
24 nuk e kuptoni lirish mund të na kërkonit që të shpjegojmë më  
25 tej pyetjen përkatëse.

1 Tani do ju kërkoj që të lexoni deklaratën solemne,  
2 Dëshmitar, lidhur me tregimin e të vërtetës.

3 DËSHMITARI: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për rëndësinë e  
4 dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj  
5 solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe  
6 vetëm të vërtetën, dhe nuk do të mbaj të fshehur asgjë për të  
7 cilën kam dijeni.

8 DËSHMITARI: DËSHMITARI 7

9 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit]

10 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Është vepër penale sipas  
11 juridiksionit të Gjykatës Speciale për të dhënë dëshmi të  
12 rreme? E kuptoj?

13 DËSHMITARI: [Përkthim] E kuptoj.

14 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit, z. Dëshmitar,  
15 keni bërë betim për të treguar të vërtetën.

16 Tani ja jap fjalë Prokurorit, z. Halling.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Mirëdita. Faleminderit, i nderuar  
18 Gjykatës.

19 Mirëdita, Dëshmitar.

20 I nderuar Gjykatës, për ta identifikuar dëshmitarin do të  
21 kërkoja që për pyetjet fillestare të kalojmë në seancë  
22 private.

23 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Sigurisht, kalojmë në një  
24 seancë private.

25 [Seancë private]

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7 [Seancë e hapur]

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës,

9 kemi kaluar në seancë të hapur.

10 Z. HALLING: [Përkthim]

11 PY. Dëshmitar, a i ke dhënë tre deklaratatë të mëparshme ZPS-së

12 lidhur me këtë çështje?

13 PË. Po.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe, sipas rregullit të zakonshëm,

15 ju lutem, të vendosim faqen e parë të deklaratës së parë në

16 ekran dhe të mos transmetohet publikisht.

17 PY. Dëshmitar, prisni një çast që të vendoset në ekran ky

18 material.

19 Dëshmitar, në të majtë është versioni në anglisht, është

20 kjo deklaratatë juaj e parë?

21 PË. Po.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë, a mund të vendosim faqen

23 e parë të deklaratës së dytë?

24 PY. Dëshmitar, materiali që shihet në ekran tani, a është

25 deklaratatë juaj e dytë?

1 PË. Po.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë të vendosim në ekran faqen  
3 e parë të deklaratës së tretë.

4 PY. Dëshmitar, materiali që është në ekran është deklarata  
5 juaj e tretë?

6 PË. Po.

7 PY. A keni patur mundësi kohët e fundit që t'ju kujtohet kjo  
8 përmbajtje e këtyre deklaratave?

9 PË. po, e pata këtë mundësi javën e shkuar.

10 PY. A përfaqësojnë saktësisht atë që ke thënë apo që do të  
11 thojë sot edhe në këtë sallë gjyqi?

12 PË. Po.

13 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, tani që janë  
14 përmbushur standardet e rregullës 154 dhe bazuar në vendimin  
15 F00687, ZPS-ja i paraqet këto tre deklarata në anglisht edhe  
16 në shqipe për t'u pranuar si prova materiale bashkë me  
17 materialet e shoqëruara sipas poshtëshënimit 6 dhe në  
18 përputhje me vendimin tuaj 154.

19 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] A ka ndonjë kundërshtim?

20 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Jo, nuk ka.

21 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Nuk shoh që të ketë  
22 kundërshtime nga pala mbrojtëse. Të tre materialet pranohet.

23 Z. Sekretare, a i keni numrat rendorë?

24 Atëherë mund të vazhdoni.

25 [Gjykatësi i Vetëm dhe Sekretarja e Gjykatës

1 këshillohen]

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar  
3 Gjykatës. Deklarata e parë në gjuhën shqipe dhe në anglishte  
4 do të ketë numrin e provës materiale P00168.

5 Deklarata e dytë, në anglishte dhe në shqipe do të ketë  
6 numrin e provës P00169.

7 Dhe deklarata e tretë, në anglishte dhe në shqipe do të  
8 ketë numrin e provës P00170.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Për të tre këto prova materiale,  
10 mund të -- numri i tyre rendor mund të diskutohet dhe në  
11 seancë të hapur dhe prandaj t'i japim edhe numrat e provës.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës,  
13 provat materiale shoqëruese me shifrën rendore 051775 deri në  
14 051780 RED2 do të ketë numrin e provës P00171.

15 Prova materiale shoqëruese e dytë që ka numrin rendor  
16 051765-051770 në variantet në anglisht dhe në shqip do të ketë  
17 numrin e provës P00172.

18 Dhe prova materiale shoqëruese e fundit me numrin rendor  
19 053191-TR-ET, në anglishte dhe në shqipe do të ketë numrin e  
20 provës materiale P00173. Faleminderit.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.  
22 PY. Dëshmitar, kam edhe disa pyetje për t'ju bërë lidhur me  
23 deklaratat tuaja, por së pari desha t'ju pyesja lidhur me disa  
24 procedura të përgjithshme të cilat janë zbatuar në rastin e  
25 gjykimit të Thaçit dhe të tjerët, e njohur ndryshe dhe si

1 Çështja gjyqësore 06.

2 Në Çështjen gjyqësore 06, a ka patur një procedurë që  
3 kishte të bënte me kontaktin e palës Mbrojtëse e dëshmitarët e  
4 ZPS-së?

5 PË. Po.

6 PY. A kanë patur ekipet e Mbrojtjes mundësinë në atë çështje  
7 gjyqësore për t'i kontaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë  
8 dëshmitarët?

9 PË. Jo.

10 PY. ZPS-ja a u ka shpjeguar dëshmitarëve se pala Mbrojtëse  
11 nuk mund t'i kontaktonte në mënyrë të drejtpërdrejtë?

12 PË. Po, ZPS-ja u ka shpjeguar dëshmitarëve se ata nuk mund të  
13 kontaktoheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë.

14 PY. Në çështjen gjyqësore 06 a ka ekzistuar një procedurë e  
15 cila kishte, drejtonte mënyrën e përgatitjes së dëshmitarëve  
16 të ZPS-së?

17 PY. Po, ka patur një procedurë të tillë në Çështjen 06.

18 PY. Si pjesë e kësaj procedure të përgatitjes të  
19 dëshmitarëve, a ju janë dhënë dëshmitarëve deklaratat e tyre e  
20 mëparshme me qëllim që ta rishikonin?

21 PË. Po, ju janë dhënë deklaratat e mëparshme.

22 PY. Në këto seanca përgatitore a kanë patur mundësi ata që të  
23 bëjnë ndryshime apo korigjime në këto deklarata të tyre?

24 PË. Po, atyre ju është dhënë mundësia për të ndryshuar apo  
25 redaktuar.

1 PY. Tani dua që të diskutojmë nja dy çështje konkrete dhe për  
2 këtë dhe për këtë mund të shfrytëzojmë deklaratën tuaj të  
3 parë.

4 Z. HALLING: [Përkthim] A mund të vendosim paragrafin 4 të  
5 provës tani P168.

6 PY. Dhe të pyesim tani, të nderuar -- Dëshmitar, që të  
7 vendoset në ekran.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. Të shohim plotësisht  
9 paragrafin 4.

10 PY. Dëshmitar, në paragrafin 4 përshkruhet se si i keni dhënë  
11 një listë të dëshmitarëve të Çështjes 06 dhe kodet e tyre dhe  
12 nëse ato kanë masa mbrojtëse. A mund të na shpjegoni se si e  
13 keni verifikuar një informacion të tillë.

14 PË. Këtë e kam vërtetuar përmes databazës së brendshme të  
15 ZPS-së për çështjen përkatëse.

16 PY. A është shfrytëzuar e njëjta metodë dhe për të verifikuar  
17 dëshmitarët dhe tabelat e tyre që paraqiten në deklaratën e  
18 dytë dhe të tretë.

19 PË. Po, e njëjtë.

20 PY. Në rastet kur një prej dëshmitarëve tregon publikisht se  
21 është dëshmitar para se të japë dëshminë e tij, ky dëshmitar e  
22 humb atë mbrojtjen që do të gëzonte përndryshe nga ZPS-ja?

23 PË. Jo, nuk humbin asnjë lloj mbrojtjeje që gëzojnë.

24 PY. Faleminderit.

25 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, dhe për këtë

1 ju referojmë tek paragrafi 524 të aktgjykimit të Gucatit dhe  
2 Haradinaj.

3 Tani të kalojmë në paragrafin 9 të deklaratës së parë.  
4 PY. Këtu keni folur për nxjerrjen e deklaratave të  
5 dëshmitarëve për palën Mbrojtëse. Si e keni verifikuar  
6 saktësinë e këtij informacioni?

7 PË. Me lejoni ta shpjegon procedurën. Nga prokurori i nivelit  
8 të lartë ne kemi marrë informacionin lidhur me deklaratat --  
9 emrat e dëshmitarëve dhe deklaratat e tyre të cilat do t'ia  
10 nxirrnin palës Mbrojtëse. Ne kemi thirrur dëshmitarët për t'ia  
11 shpjeguar këtë. Këtë informacion e kam verifikuar edhe përmes  
12 bazës së të dhënave të ZPS-së, përfshirë edhe ato që kanë të  
13 bëjnë me çështjen gjyqësore përkatëse.

14 PY. Faleminderit.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Tani të kalojmë në paragrafin 10,  
16 i cili është në mes të faqeve në gjuhën angleze.

17 PY. Dëshmitar, këtu flisni se si janë shfrytëzuar burimet e  
18 ZPS-së. A jeni duke shpjeguar këtu masat e përgjithshme që ka  
19 marrë ZPS-ja për të luftuar ndërhyrjen e dëshmitarëve në  
20 Çështjen 06?

21 PË. Po, këtu janë masat e përgjithshme të përshkruara.

22 PY. A jeni në gjendje të na tregoi se cilat burime ka  
23 shfrytëzuar posaçërisht për këtë çështje ZPS-ja?

24 PË. Jo, nuk është e mundshme thjesht vetëm për këtë çështje  
25 pasi ka patur një numër çështjesh të tilla, dhe prandaj është

1 vështirë që të përcaktohet vetëm për këtë çështje gjyqësore.

2 PY. Një nga masat që ndodhet në faqet tjetër të kësaj  
3 deklaratë, pjesë e paragrafit 10 - ju lutem të kalojmë në atë  
4 faqe - ka të bëjë me ndryshimin e rendit të paraqitjes së  
5 dëshmitarëve. Në rastin kur ndryshohej rendi i paraqitjes së  
6 dëshmitarëve, a jua ka shpjeguar ZPS-ja këtë Trupit Gjykes të  
7 Çështjes 06?

8 PË. Nuk më kujtohet.

9 PY. Ti vetë a ke patur dijeni se përse është ndryshuar rendi  
10 i paraqitjes së dëshmitarëve?

11 PË. Jo.

12 PY. Hetimi që kishte të bënte -- që ka bëjë me këtë çështje  
13 gjyqësore ishte pjesë e detyrave në kuadrin e ZPS-së?

14 PË. Jo.

15 PY. A keni dijeni lidhur me hetimet që janë marrë në kuadrin  
16 e kësaj çështjeje gjyqësore?

17 PË. Jo.

18 PY. A dini se si janë bërë audioincizimet në zyrën e  
19 paraburgimit që kanë të bëjnë, pra, me këtë çështje gjyqësore?

20 PË. Jo.

21 PY. Tani dua t'ju pyes lidhur me paragrafin 11 që e shihni në  
22 ekran.

23 Këtu po flisni për kohën në të cilën kanë dëshmi disa  
24 dëshmitarë të caktuar. Është ky informacion i cili është i  
25 verifikuar përmes bazës së të dhënave që po diskutonit në

1 paragrafët e mëhershëm?

2 PË. Po, është verifikuar përmes së njëjtit informacion.

3 PY. A keni verifikuar në të njëjtën mënyrë edhe informacionin  
4 që ka të bëjë me dëshmitarët që janë pjesë e deklaratës tuaj  
5 të dytë dhe të tretë?

6 PË. Po.

7 PY. Faleminderit.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Tani mund ta heqim nga ekrani.

9 PY. A keni dijeni se si ishin materialet e procesverbalit të  
10 udhëtimit për dëshmitarët e Çështjes gjyqësore 06?

11 PË. Po.

12 PY. Dëshmitarët që janë paraqitur -- për të dhënë dëshmi në  
13 rastin 06 sa kohë përpara vinin në Hagë?

14 PË. Ndryshon rast pas rasti, por koha nga 7 deri 10 ditë  
15 përpara dhënies së dëshmisë.

16 PY. Përse vinin kaq herët përpara dhënies së dëshmisë së  
17 dëshmitarit?

18 PË. Ata kanë nevojë për ca kohë për të lexuar deklaratat e  
19 tyre, për të bërë parapërgatitjen dhe kjo varet nga sasia e  
20 materialeve. Ky është faktori që përcakton sesa përpara  
21 dhënies së dëshmisë do të udhëtojnë për të ardhur në Hagë.

22 PY. Dhe kur përmende fjalën "përgatitore" e ke fjalën për  
23 përgatitjen e tyre për të dhënë dëshminë?

24 PË. Po.

25 PY. Po të përqendrohemi tek Rustem Mustafa në mënyrë të

1 posaçme. Në këtë paragraf të P168 thatë që ai ka dhënë dëshmi  
2 nga 11 korriku 2023.

3 Z. HALLING: [Përkthim] I lutem Sekretarisë që të vendosë  
4 në ekran materialin SPOE00408671 deri në 00408675 RED, faqen  
5 SPOE00408674. Dhe ju lutem të zbresim pak poshtë faqes.

6 PY. Dëshmitar, a mund të tregoni se çfarë është ky dokument?

7 PË. Po.

8 PY. Çfarë është?

9 PË. Kjo është bileta për udhëtimin për në Hagë. Zakonisht për  
10 dëshmitarët të cilët vinin për të dhënë dëshmi në Hagë.

11 PY. Pra, a është ky procesverbali apo dokumenti i DHSK-së për  
12 udhëtimin që po përshkruhej pak më herët?

13 PË. Po.

14 PY. Këtu shihni emrin e Rustem Mustafës dhe datën e  
15 udhëtimit 4 korrik 2023, apo një javë përpara dëshmisë së 11  
16 korrikut. Ky itinerar udhëtimi përputhet me procedurat që janë  
17 ndjekur në Çështjen gjyqësore 06 dhe që i shpjeguat ju?

18 PË. Po.

19 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ne do të  
20 kërkonim që ky material të pranohet si provë materiale.

21 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] A ka ndonjë kundërshtim?

22 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Jo, nuk ka asnjë kundërshtim.

23 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Nuk shoh që të ketë  
24 kundërshtim nga ekipet e tjera të Mbrojtjes, prandaj ky  
25 dokument pranohet si provë materiale.

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar  
2 Gjykatës. Dokumenti me numrin rendor 00408671 deri në 00408675  
3 RED do të marrë numrin e provës P00174. Faleminderit.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.  
5 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera.

7 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Menegon, ju keni  
8 parashikuar se dëshironit të kishit dy orë në dispozicion për  
9 të bërë pyetje këtij dëshmitari.

10 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Po. Dhe duke patur momentin ku  
11 kemi arritur, do të kërkoja që t'i filloja pyetjet për  
12 dëshmitarin të hënën. Ju kishit thënë në dosjen tuaj F705,  
13 paragrafi, se në qoftë se ne nuk jemi të gatshëm për të bërë  
14 pyetje mund të kërkojmë që të shtyhet ky afat.

15 Dhe do të vlerësonim nëse do të na jepni kohë pak më të  
16 gjerë për të përmirësuar këtë proces, pasi ka pasur -- që ka  
17 pasur diskutim mes palëve lidhur me faktet e dakordëzuara e  
18 cila mund të ndikojë dhe mbi pyetjet që do të bëj. Dhe unë  
19 mendoj që nuk do të cenonte asnjë palë dhe do të ishte në  
20 interes të administrimit të drejtësisë.

21 Faleminderit.

22 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Po. Në vendimin 705 unë  
23 kisha parashikuar që kërkesat do të bëheshin pak më  
24 paraprakisht sesa në momentin kur duhet të fillojë ky procesi  
25 i marrjes në pyetje.

1           ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Jo, nuk isha në -- nuk isha e  
2 sigurt sesa do të zgjaste procedura e ditës së sotme dhe duke  
3 qenë që kemi patur disa vonesa në mëngjes, kjo është arsyeja  
4 se përse po e bëj këtë kërkesë tani.

5           GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Dhe nuk besoj që ekipet e  
6 tjera të Mbrojtjes janë gati që të bëjnë pyetjet e tyre në  
7 këtë moment?

8           Z. REES: [Përkthim] Jo, dhe në fakt e mbështes kërkesën  
9 që ka bërë znj. Menegon.

10          GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Dakord. Atëherë do ta  
11 pezullojmë seancën e ditës së sotme. Megjithatë kemi disa  
12 çështje procedurale që dua t'i diskutojmë përpara se të bëjmë  
13 këtë pushim.

14          Z. Dëshmitar, këtu përfundon dëshmia juaj për ditën e  
15 sotme. Ne do të rifillojmë seancën me juve ditën e hënë.  
16 Faleminderit për praninë tuaj gjatë ditës së sotme. Më lejoni  
17 t'ju kujtoj që deri të hënë nuk duhet ta diskutosh dëshminë  
18 tënde askënd. Dhe Sekretaria do t'ju ndihmojë për të dalë nga  
19 salla e gjyqit.

20          DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

21                               [Dëshmitari përfundon dëshminë]

22          Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, përpara se të  
23 merremi me çështjet procedurale ne e kuptojmë që Mbrojtja nuk  
24 do t'i bëjë këto pyetje dhe e vlerësojmë që mund të duhen të  
25 ndryshojnë edhe materialet që kanë paraqitur në dokumentin në

1 listën e prezantimeve. Dhe në qoftë se do ta ndryshojmë këtë  
2 listë do ju kërkoja që të na tregoni përpara se të arrijmë në  
3 ditën e mëngjeshme dhe do të donim që të na tregoni lidhur me  
4 këtë çështje përpara -- në momentin që ekzistojnë.

5 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] T'i kërkoj Mbrojtjes së  
6 Thaçit se kur gjatë fundjavës që vazhdon do të jenë në gjendje  
7 që ta bëjnë publike listën e prezantimeve.

8 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] E kemi përgatitur dhe jemi të  
9 gatshëm, megjithatë do të duhet të tërheqim disa materiale, me  
10 qëllim që edhe pyetjet tona të jenë më të efektshme. Ndoshta  
11 jo, por mund ta bëjmë këtë.

12 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Atëherë, do të mendoja që  
13 do të ishte më mirë që ta bëjmë, ta publikojmë këtë listë të  
14 prezantimit të provave.

15 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Faleminderit.

16 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Përpara se të merrem me  
17 disa çështje logjistike, a ka ndonjë çështje që duan të ngrenë  
18 palët?

19 Z. YOUNG: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, një gjë shumë të  
20 shkurtër që ka të bëjë me ditën e hënë.

21 Doja të thoja që nga ajo që kemi dëgjuar nga dëshmitari,  
22 mund t'i kërkoj Trupit Gjykses që të kalojmë në seancë të  
23 shkurtër private me qëllim që me dëshmitarin të diskutojmë  
24 disa prej dëshmisë që ka thënë dhe unë do të doja që të merrja  
25 vesh se çfarë i është udhëzuar që të thotë e çfarë të mos

1 thotë, e kështu me radhë. Dhe do të doja që këtë ta bënim në  
2 seancë private pasi mund të nxjerr ndonjë gjë.

3 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Atëherë, a do të ishte e  
4 përshtatshme - dhe po pyes Mbrojtjen e Thaçit - që ta fillojmë  
5 këtë seancë të pyetjeve të hënën në mëngjes në seancë private?

6 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Unë kam disa pyetje hyrëse që do  
7 t'i bëj në seancë të hapur, por do të hyjmë rregullisht në  
8 seancë private.

9 Z. YOUNG: [Përkthim] Edhe ne po e nxjerrim, po e  
10 publikojmë listën tonë të materialeve të provës, të  
11 prezantimit.

12 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Dakord. Tani kalojmë në  
13 seancë private po të jetë e domosdoshme.

14 Z. REES: [Përkthim] Dua të ngre një çështje, dhe nuk e di  
15 nëse ky është momenti i duhur.

16 Dhe kjo ka të bëjë me mocionin që kemi dërguar për heqjen  
17 e redaktimit -- për redaktimet dhe materialet që kanë të bëjnë  
18 me datat 9 shtator dhe 7 shtator që ndodhet në F004747 -- 747.

19 Çështja që do të ngre nëse, i nderuar Gjykatës, ju jeni  
20 në gjendje që të na tregoni se kur do ta nxirrni -- kur mund  
21 të presim që të dalë vendimi juaj. Kjo mund të ketë ndikim  
22 lidhur në sasinë e pyetjeve që mund të kem për këtë dëshmitar.  
23 Dhe kundërshtoj është arsyeja se përse e ngre në këtë çështje  
24 këtë çështje -- në këtë moment këtë çështje.

25 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Unë besoj se e kemi marrë

1 kundërpërgjigjen të enjten apo të mërkurën.

2 Z. REES: [Përkthim] Po, ishte një afat i përshpejtuar që,  
3 i nderuar Gjykatës, keni parashikuar lidhur me këto -- me këto  
4 parashtrimet të protokolluara dhe në përputhje me të janë  
5 paraqitur përgjigjet dhe kundërpërgjigja.

6 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Nuk mund të premtoj që do  
7 ta kemi këtë nga fundi i të hënës. Po bëjmë të pamundurën.

8 Z. REES: [Përkthim] Jam mirënjohës, nuk dua që të ushtroj  
9 trysni. E kundërta mbi ju -- e kundërta është që unë do t'ju  
10 kërkoja që të shfrytëzoj të gjithë kohën e përshtatshme për ta  
11 bërë këtë. Dhe atëherë mund të ndodhë që të hënën unë ta  
12 rezervoj qëndrimin tim lidhur me pyetjet që kam për [REDAKTUAR]  
13 dhe në atë kohë do të kërkoja që [REDAKTUAR] që të kërkoj që të  
14 vijë ditën e martë.

15 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Rees, unë do të thoja që  
16 ju po hamendësoni që mocioni juaj nuk do të miratohet, dhe  
17 prandaj janë të pranuar edhe transkriptet e paredaktuar të  
18 cilat mund të shfrytëzoni për pyetjet tuaja.

19 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit.

20 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] A ka ndonjë gjë që dëshiron  
21 të ngrejë Prokuroria?

22 Z. HAFETZ: [Përkthim] Një çështje logjistike fare e vogël  
23 lidhur me atë që përmendët sot në mëngjes, lidhur me  
24 përfundimin e çështjes gjyqësore.

25 Ne do të dorëzojmë, jo më vonë se të hënën, një mocion

1 juridik shtesë për të shtuar dy materiale në listën tonë të  
2 provave materiale. Kjo ishte parashikuar, megjithatë po ju  
3 them që është ky një mocion që do ta dorëzojmë të hënën.

4 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit.

5 A ka ndonjë çështje tjetër nga pala Mbrojtëse.

6 Z. EDWARDS: [Përkthim] Jo çështje logjistike, i nderuar  
7 Gjykatës, or ka pasur një vonesë për fillimin e këtij procesi  
8 dhe nuk kisha mundësi që të flisja për këtë çështje. Por  
9 kishim vështirësi që kishte të bënte me transportin publik në  
10 Hagë dhe arsye përse erdhi vonë z. Kilaj, ishte se kishte një  
11 ngatërresë me tramvajet. Dhe i kërkoj -- e falënderoj Trupin  
12 Gjykses që tregoi mirëkuptim për këtë çështje. Nuk do të  
13 përsëritet sërish.

14 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit.

15 Përpara se të përfundojmë, kam një çështje të logjistike,  
16 një urdhër gojor.

17 Ju kujtoj se në Vendimin mbi Zhvillimin e Çështjes së  
18 Gjykimit, F642, e udhëzova Mbrojtjen e Kuçit që të dorëzonte  
19 një material të redaktuar publik F567 ose të kërkojë  
20 riklasifikimin publik të tij brenda 30 janarit 2026.

21 Më 4 shkurt 2026, i kujtova Mbrojtjes së Kuçit -- ja  
22 kujtova këtë me email.

23 Sot, i urdhërova -- e urdhëroj Mbrojtjen e Kuçit që të  
24 dorëzojë një version publik të redaktuar të 566, ose të  
25 kërkojë riklasifikimin e tij si publik brenda 4 marsit 2026.

1 Këtu përfundon urdhri gojor.

2 [Mikrofoni çaktivizuar].

3 --- Seanca mbyllet në orën 15.30

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25